


BIBLIOTEKA

85H-32

A 73

FATOS ARAPI

NUK SHITET SHPIRTI  
NË TETOR  
*novela*



B7H-32  
A 73

FATOS ARAPI

# Nuk shitet shpirti në tetor

*Novela*

BIBLIOTEKA E  
BANKIS QIBOKASTET  
NR. INV. 5898

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2002

Botues: Fatmir Toçi  
Recensent: Ali Podrimja  
Përkujdesja grafike: Lavdie Cenmurati  
Kopertina: Irena Toçi  
ISBN 99927 - 1 - 559 - 6  
© Autori

**BOTIMET TOENA**

Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, TIRANË

Tel.: (+355) (4) 240116; 240117

Tel./Fax: (+355) (4) 240117

E-mail: toena@icc.al.eu.org

Http://www.toena.com.al

# Hero pa gjë

## I.

**S**hefi i sektorit të shtypit u lëshua lirshëm në kolltuk, mbështeti bërrylat mbi gjunjë e duke u përkulur pakëz soditi majuckat e shndritshme të këpucëve, çorapet e zeza me fluturidhe të bardha, mëngët e pantallonave të hekurosura. Shtroi dorën e zuri kyçin e këmbës së majtë e nisi ta fërkojë duke ndërë kënaqësinë e asaj prekje të trupit të vet. Në murin karshi rrezja e diellit bëri edhe një kërcim të fundit, përndriti sapak e pastaj u shua në cepin e skajshëm të zyrës. Muzgu i mbrëmjes erdhi fundosës, i menjëhershëm.

Njezëteshtatëvjeçari Greth Bubësi e ndjeu në trup çastin e fikjes së dritës, atë thyerje që krijoi boshtinë brenda një grime kohe, lëvizi e ndryshoi qëndrim; iu bë se ra në mendime, por nuk e lëshoi veten më tutje: rrezet e diellit kanë jetën e tyre, njeriu të vetën; ai, Greth Bubësi, ka jetën e tij. Shtypi butonin e abazhurit mbi tryezën e punës e nisi të përziejë gazetën e ndryshme me një ndjenjë lodhjeje mospërfillëse. Nuk e kishte lexuar “Bujkun” e sotëm.

Mendoj, si zakonisht, t’i hidhte një sy të shpejtë dhe kaq, kur në faqen e tretë, ndën dy gjysmëkollona të ngjeshura lexoi emrin e Ilir Guralumit. U ndal. Nisi të fërkojë sytë në një gjendje të papërcaktuar. Kohëve të fundit ky kritik i ri



shfaqej shpesh nëpër gazetat e përditshme dhe duhej pranuar se nuk ishte pa gjë. Kishte tërhequr vëmendjen edhe të atyre lart, të cilët kishin kërkuar informata mbi këtë fillestar. Të dhënat thoshin se Ilir Guralumi ishte prej fshatit Skuterrë, kishte mbaruar filologjikun, ishte i papunë e kërkonte të vendosej në ndonjë redaksi.

Shefi i sektorit të shtypit mund ta lexonte edhe vetë këtë shkrim, por më tepër se sa lodhja, ishte një mpirje e vullnetit që po e pengonte. Le të pyeste më mirë ndihmësin e vet; dhe ai kërkoi zilen që e lidhte me instruktorin.

Trokiti e u çel dera. I gjatë, me kurrizin pakëz të përkulur, shpatullat e kockta ndën xhaketën e leshtë, të gjerë e të hirtë, duart lidhur përpara, instruktori i shtypit Besnik Bisha, u ndal në mesin e zyrës. Priti në heshtje duke përgjuar me shikimin e tij mbi tryezën e punës së shefit gazetën “Bujku”, krahun e hijshëm, kyçin e fuqishëm të dorës, orën “Pobieda”, mëngën e këmishës së kaltër me vijëza. Shefi ishte kremtëror dhe kjo do të thoshte se sot ai do të kishte pasur ndonjë takim me ata lart. Vetëm kur ndjeu frymëmarrjen e shtruar të instruktorit, Greth Bubësi foli:

- Ç’është ky shkrim i Guralumit në “Bujkun” e sotëm?
- Një hero pa gjë... - erdhi gati pa zë.

Instruktori i shtypit nuk vazhdoi më tutje, ai fliste me zë fare të ulët, i rrokëzonte fjalët me një tingëllim të ftohtë që e acaronte shefin, por ky më tepër neveritej prej atyre dy syve të mëdhenj, kalesh, të patronditur të instruktorit të mbështjellë përherë në një si mjegull të tymtë.

- E, si t’u duk? – pyeti Greth Bubësi, me shikimin e vet mbi gazetë.

- Diçka... si hero...

Instruktori i shtypit përsëri heshti.

- Eh, po, mirë, atëherë...

Greth Bubësi u çua prej kolltukut, nisi të mbledhë dosjet mbi tryezë dhe pa hedhur sytë nga tjetri, foli zëshëm:

- E lexojmë nesër, mund të shkosh. Natën e mirë!

Duke dalë prej zyrës së shefit, Besnik Bisha, i hodhi vjedhurazi një sy rojës, gjithçka ishte si më parë; kërciti një derë në korridorin e gjatë, e dikush foli nga brenda, por s'po dilte njeri. Instruktori shpejtoi hapat e gjatë për në dhomën nr. 9 që ishte zyra e vet.

Gazetës "Bujku" si zakonisht, edhe sot, i kishte hedhur një shikim fluturimthi; në artikullin "Diçka e vogël, e madhe" kishte kapur aty-këtu vetëm disa fjalë si "shembull pozitiv... hero pozitiv" dhe vetëm kaq. Punë shkrimtarësh e kritikësh të rinj, fillestarë të vetbërë, që bredhin redaksive më tepër për të vrarë kohën. Dreqi e mori, instruktorit të shtypit pranë KQ as që do t'i kishte shkuar ndërmend se shefi sot mund të lexonte pikërisht atë gazetë. Ndjeu një dhimbje dhe kaloi dorën mbi lukth; ishin dhimbjet e ulçerës. Përse shqetësohej? Nesër edhe ai do ta lexonte ngeshëm artikullin, pastaj shefi tha se do ta lexonte edhe ai vetë. Ta kishin kërkuar ata lart?

Fundosur në kolltuk i nguli sytë xhamave të dritares pranë, jashtë kishte rënë nata. Orari zyrtar kishte mbaruar, por ai vendosi ta shfletojë gazetën dhe të lexojë artikullin e Guralumit. Flitej për novelën e sapodalë të shkrimtarit Engjëll Cukalla, të cilën instruktori i shtypit pranë KQ e njihte mirë. Ky prozator i ri kishte hapur telashe jo një herë partisë me zhgarravinat e veta.

Në gazetën “Bujku”, organ i Ministrisë së Bujqësisë, në dy gjysmëkollona të ngjeshura, kritikoi Guralumi shkruante se në novelën e re të Engjëll Cukallës “Rabecka jetë”, personazhi Drit Bora, veteriner në fshatin Trepullazë, duke anashkaluar udhëheqjen e prapambetur të pushtetit, kishte arritur të organizonte një mbrëmje dëfrimi me të rinjtë e fshatit në shtëpinë e kulturës. Të rinjtë kishin dëfryer gjer vonë dhe pastaj kishin vendosur se këndeje e tutje ata do ta “administronin” vet (kështu shkruhej “do ta administronin”) jetën e tyre.

Instruktori mori frymë thellë, kërciti gishtërinjtë e gjatë:

- Drit Bora... - murmuriti -... mirë... - foli me vete si i çliruar. – Mirë... po mirë...

Ai largoi gazetën dhe e hodhi atë mbi tryezë.

Kërkoj me kujdes çelësat, i peshoi një çast në dorë e duke dalë nisi të mbyllë zyrën. Në korridor tutje pa edhe Greth Bubësin që po zbriste shkallët. Ky vërtiste çelësin në dorë, gjersa tjetri u zhduk. Atëherë edhe instruktori përshkoi korridorin e heshtur.

## II.

**S**ë nesërmen mbledhja për shtypin ishte nga më të zakonshmet, rutinë, kishin ardhur vetëm nja katër-pesë gazetarë, mungonin kryeredaktorët. Nuk kishte asnjë problem apo ngjarje të veçantë, asnjë udhëzim apo porosi nga lart. Greth Bubësi e çeli dhe e mbylli atë mbledhje buzagaz, i çlirshëm e gjithë humor, bile u kërkoi

pjesëmarrësve një falje të lehtë që kishin ardhur sot gjer aty. Mbledhja ishte fare e shkurtër, gjithsej pesëmbëdhjetë minuta dhe shefi i shtypit, i përpiktë, duke dalë prej salle kapi nga krahu mikun e vet, gazetarin Nik Niku, rondokop i dhjamët, njeri qyfyresh të ditës.

- Shkojmë e pimë nga një kafe.

- Konjak, - tha tjetri.

- Konjak. Tre dopio radhazi.

- Perënditë nuk kundërshtohen, - tha Nik Niku.

Sytë e gjelbër të Greth Bubësit xixuan, nëpër shkrepje të tyre ai tha:

- Oh, ne jemi ca perëndira të vockëla...

- Të vogla... të vogla... po ky ku mbahem unë tani është një krah i perëndishëm, - tha Nik Niku duke e shkundur krahun e tjetrit.

- Po ta largoj, - tha Greth Bubësi, nëpër qeshjen e tij gurgulluese.

Bufeja ishte e ftohtë dhe e zbrazët. Ajo mbushej aty nga ora dhjetë e gjysmë, kur kuadrot dilnin prej zyrave e zbrisnin për të përtypur diçka. Ato ishin orët "proletare", kur nëpunësit i drejtoheshin banakut, merrnin nga një pjatë nër duar e përhapeshin nëpër tryeza. Kur hynë në bufe, Greth Bubësi e Nik Niku, ajo ishte fare e zbrazët dhe ata shkuan e u ulën te këndi ndën dritare.

- Dy dopio konjak.

Nisën bisedën e atij mëngjesi fare të pafajshëm, të parëndësishme, u përfolën gazetatat, diçka thanë për kryeredaktorët, redaktorët, shkrimtarët... Eh, të dy ishin të një mendimi për të gjitha, por kur fjala erdhi te shkrimtarët, Greth Bubësi kundërshtoi:

- Armiq... Nuk do të thosha... ndoshta një lloj tjetër kundërshtari...

Nik Niku nuk i kushtoi vëmendje kundërshtimit të tjetrit, ai uli syrin qetshëm mbi gotën e konjakut.

- Këto unë i di më mirë se ti, i njoh mirë unë të dy kopetë, të gazetarëve dhe të shkrimtarëve. Gazetarët mendojnë se ata janë shkrimtarë të vërtetë, ndërsa shkrimtarët janë të bindur se gazetarët janë një racë e papjekur, e paarrirë dhe të patalentuar. – Ai pa se si ndërruan ngjytrë në çast sytë e shefit të shtypit, ata u bënë një gri e thellë përgjuese. Nik Niku e kapi kurrështjen tinzare të shefit, ngriti duart në ajër dhe përpoqi grushtet njeri me tjetrin.

- Janë kështu si këto dy grushte, bashkëpunojnë, por përherë goditen. Shiko, more zog fshatari, - dhe Nik Niku rrëmbeu nga duart e kamarierit dopion e dytë të konjakut. – Unë jam gazetar, - tha ai, - unë punoj ku gjej punë, i shërbej partisë ku më emëron ajo. Shkrimtarët mendojnë se janë ndryshe, edhe kur shkruajnë për ty, ata janë të bindur se janë shërbëtorë të së Ardhmes... - dhe Nik Niku i mëshoi gërmës A, sikur ajo të ishte një kryefjalë hyjnore.

Greth Bubësi e ndiqte tjetrin me një vëmendje të akullt, i heshtur, i përpirë në mendimet e Nik Nikut, ai e dëgjonte atë si nga një pritë mali. Prej andej, prej pusisë përgjonte. Ishin biseda që bëheshin ato, të përditshme e të përherëshme, i kishte dëgjuar dhe i dëgjonte shpesh, edhe shkrimtarët vetë, edhe gazetarët. Dhe përherë ndjente një acarim të brendshëm ndaj shkrimtarëve, të cilët sikur i kyçnin nofullat eshtake, kur thonin:

- Ne s'kemi punë me të përditshmen, aleatja jonë është e Ardhmja.

Shefi i shtypit buzëqeshi.

- Eh, po mirë, punë e tyre, gjersa duan të jetojnë në të ardhmen, le të jetojnë atje; unë e ti jemi e tashmja, apo jo?

- Sigurisht, - murmuriti Nik Niku me mollëzat e dhjamta të faqeve që nisën t'i buçkohen e skuqen prej konjakut. - Ne jemi e tashmja, xhanëm.

Shefi i sektorit të shtypit u shkund, sikur të kishte frenuar papritur veturën e vet. Nuk i lejohej të fliste keq për shkrimtarët, sidomos për ata, shkrimtarët. Nga takimet e bisedat që bëheshin lart ai ndjente se aty duhej të ishte tepër i vëmendshëm, nuk duhej shkelur aty. Ky Nik Niku, dreqi ta hajë, ishte djal i mirë, por si gjithë pijakët llapaqenë. Duhej ndërruar biseda.

- Engjëll Cukalla, - tha shefi i shtypit, - paska botuar përsëri një novelë.

- Ë, mo, "rabecka jetë"... phuuu... - lëshoi Nik Niku.

- Ilir Guralumi kishte shkruar për atë novelë...

- E, mo, ku merr vesh ai viç i palëpirë nga kritika... unë e lexova, phuuu...

Këtu shefi i sektorit të shtypit, nuk lëshoi. Ai drejtoi trupin e tij të hajthëm, u ftoh në shikimin dhe zërin e tij.

- Nisma të tilla janë tepër të dobishme, ata njerëz duhen përgëzuar, janë heronjtë e sotëm dhe mua më vjen mirë për shkrimtarin Engjëll Cukalla.

- Ama, e ktheve ti... - tani Nik Niku ishte gati i dehur.

Po shefi i sektorit tha:

- Më pëlqeu lajmi, po sigurisht që duhet lexuar vetë novela. Një hero pozitiv është shumë i vlefshëm tani, dhe ata lart e kërkojnë.

Dhe ata u çuan.

Shefi i shtypit hyri në zyrën e vet me ndjenjën se duhej të largohej sa më shpejt prej gazetarit të “Bashkimit”. Nuk kishte ndonjë detyrë të ngutshme për të kryer, veçse duhej të lexonte një relacion të organizatës bazë të kinostudios, ku kritikoheshin skenarët e dobët që shkruheshin. Tepër të thatë, pa lëndë frymëzuese; rinia gati i kishte boshatisur kinematë.

- S'kanë faj... ata skenarë i shkruaj dhe unë, - i shpëtoi vetiu. Greth Bubësit.

Ai e kishte një smirë dhe e shpresonte se me ndihmën e partisë edhe ai, Greth Bubësi, një ditë do të arrinte të gdhuhej edhe shkrimtar.

### III.

**N**ik Niku hodhi xhaketën mbi sup, dielli i Tiranës ishte përvëlues edhe në atë ditë të katërbëdhjetë të tetorit. Pa orën: 11. I rrumbullt e i rëndë ai shkelte ngathshëm mbi asfaltet e bulevardit, me një vetkënaqësi të plotë, si tre dopio konjakët e rrëkëllyer njëri pas tjetrit në bufenë e KQ. Në redaksi nuk i shkohej, ç'të bënte atje? Biseda me Greth Bubësin iu duk e kotë, pa duk, por hajde ma, të mos e prishte. Ai çun fshati, ose më mirë ai hajn katundi, pandeh se që kur ka ardhur ai në KQ, do të përmbysët dynjaja. I dashuri im, dynjaja nuk përmbysët dot, por ti si një brac prej Skuterre që vjen e ngulesh në kryeqytet, shkon duke nuhatur çdo kosh plehurinash të zyrtarëve. Në të vërtetë ti nuk je një kulish-qen, ti je kulish-ujk, që kapesh me dhëmbë pas kërmës që të hedhin përpara.

- Këta janë karrieristët më të egër, - Nik Niku tundë kokën e madhe e leshverdhë. – Dhe ata që i caktojnë e dinë mirë: janë fshatarë gjysmakë, qytetarë gjysmakë, të pashkollë gjysmakë, të shkolluar gjysmakë, - prandaj janë edhe karrieristët më grykës, fanatikë, këta mendojnë vetëm për veten e tyre, për kasollen e tyre, për cukallët e tyre.

Nik Niku iu përfatuan sytë e gjelbër në gri të shefit të shtypit.

- Ata sy janë dritë semaforësh, të kuq apo të gjelbër... sipas butonit që shtypet “lart” – Pfu! e çdo të më bëjë mua Greth Bubësi? Kam dhe unë ca fije peri atje lart.

Këmbët e kishin çuar në klubin e shkrimtarëve. Hyri, kërkoi një konjak “Korça” kësaj radhe (jo “Skënderbeu”) dhe me gotën në dorë u ndal në mesin e sallës. Dëgjoji një zë që e thërriste nga ana e djathtë, u kthye andej. Dy aktorë të Teatrit Popullor pinin çaj mali. E ftuan të ulej me ta. Si gjithë aktorët, ata i kërkuan që të bënte një shkrim në gazetën “Bashkimi” për premierën e tyre: “Edhe zogjtë këndojnë kur duan”. Nik Niku nxori gjuhën, lëpiu buzët dhe përqeshi:

- Ç’është ky titull kaq i gjatë? Ju pjerdhsha në të! Si mundet që një tragjedi...

Tani zëri i tij ishte fare i çjerrë.

- Është komedi, - thanë aktorët.

- Po, mirë, komedi është kjo? Ju pjerdhsha, ju i shkërdheni edhe tragjeditë, edhe komeditë. Pse tragjedi është kjo? “Edhe zogjtë... kur duan”.

- Komedi, - thanë të dy aktorët. – Është pjesë e huaj.

- U pjerdhsha me gjithë të huajt! Shikoni, - dhe Nik Niku çoi në ajër dy grushtet e tij të tultë e nisi ata t’i rrahë njëri me tjetrin. – Arti është art... - thoshte ai tani vërtetë i përkushtuar



botës krijuese. Fjalët e tij spërkateshin nga pështyma që i dilte nëpër buzët e trasha.

- Nuk është lehtë, more...

Të dy aktorët u trishtuan, u tultitën e u bënë vuvë. Nik Niku i erdhi keq tek i pa ashtu, mjeranë, të braktisur dhe të pambrojtur nga askush.

- Dëgjoni, - tha, - unë nuk shkruaj dot për ato gogësima të të huajve, bëjeni juve vetë, shkruajeni si ta doni artikullin dhe ma sillni mua. Do ta botoj me firmën time. Mirë?

Te dera e klubit u duk Engjëll Cukalla; ai hodhi i drojtur disa çape dhe po kërkonte me sy ndonjë të njohur. Me sa duket s'po gjente asnjë, sepse nuk po guxonte të lëvizte prej vendi. Kishte një qafë të gjatë që e tregonte shumë të vogël kokën e tij mbuluar me leshra të zeza të lëpirë prej krehjes. Sytë e kaltër ishin të trembur dhe ai mbante në buzë përherë një buzëqeshje të përvuajtur, sikur lypte ndihmë; lypte mëshirë prej të gjithëve dhe prej askujt. Kishte veshur një palë pantallona bezhë me mëngë të gjera, këpucë të zeza të mëdha, të zgjeruara nga ecja.

- Urime! – Nik Niku ngriti dorën për ta përshëndetur.

Engjëll Cukalla u kthye andej më tepër i habitur, ngriti supet si pafajësi e buzëqeshi drojtshëm.

- Në konferencën e shtypit... sot... në KQ... u lavdërove sot... Novela... Si?!

Fliste vetëm gazetari i "Bashkimit" nga vendi, ai tjetri s'po kuptonte asgjë. Ngriti supet dhe bëri shenjë:

- Unë?... Mua?...

- Ty... more viç i palëpirë, të lavdëruan në KQ. Urime! Natyrisht që tani e kërkojnë atë diç si heroin tënd. I dinë vet punët ata, more viç i palëpirë.

#### IV.

**N**ë 22 tetor, në gazetën “Bashkimi” botohej artikulli dykolonësh: “Një hero i ditëve tona...” Titullin, është e kuptueshme, Nik Niku e kishte përvetësuar prej veprës së Lermontovit, e cila ishte botuar ato ditë dhe po kornte një sukses të madh.

Shkrimi në gazetën “Bashkimi” lavdëronte sidomos “kritikun e ri Guralumi, i cili me një përkushtim të vërtetë për letërsinë e shkrimtarët, ndjek jetën letrare, kap fenomenet më të rëndësishme e orienton opinionin publik drejt veprave dhe talenteve të vërteta.

Shkrimtari i ri Engjëll Cukalla është një talent origjinal, njëri nga ata që përfaqësojnë të ardhmen dhe të nesërmen e letërsisë sonë; ai edhe sot, me novelën më të re “Rabecka jetë” na ka dhënë një personazh të goditur, ka skalitur një hero të kohës sonë. Ky hero, me guxim e mençuri po ndërton jetën tonë. Një lexim libri, një mbrëmje shkencore, një mbrëmje dëfrimi... Duhet lavdëruar syri social i shkrimtarit...”

- Po unë këtij nuk i thashë të shkruante, kurse ky torollak bisedën e klubit do ta ketë marrë si udhëzim... - foli me vete shefi i shtypit, duke vërtitur ndër duar gazetën, numrin e fundit të “Bashkimit”. Ec e bisedo me këta, pastaj...

Ndjenja që e mërziste më tepër tani shefin e shtypit ishte njëfarë bezdie që e mbrëthente sa herë shihte firmën e këtij shkrimtari Engjëll Cukalla, një karakter i paparashikueshëm, shumë i tërhequr në jetën e tij private, me mendime tepër të veta, pastaj ca veprime të papritura të personazheve. Prej kohe atje lart ishte formuar kjo bindje për këtë letrar të ri, prandaj ata përherë porosisnin “me kujdes...”

- Dreqi ta hajë...

Greth Bubësi lëshoi gazetën mbi tryezë dhe padashur shtypi sustën e ziles së instruktorit. Dhe përsëri u mërzi me veten: kush i duronte dot tani edhe shikimet kaleshë, përtej avushës së syve të Besnik Bishës. E ndjeu që sot ishte i acaruar, një si parandjenjë, si pafuqi për të kuptuar se ç'po ndodhte, përnjëherësh e ligështoi trurin e tij, ai nuk ishte shumë i sigurt në vete.

- Këta shkrimtarët janë problematikë, kanë të drejtë ata lart.

Trokiti dera e në zyrë hyri Besnik Bisha. Instruktori qëndroi te praku, me duart lidhur përpara dhe priti i heshtur. Greth Bubësi u përpoq të buzëqeshë, pa e fshehur mundimin që bënte për atë buzëqeshje.

- Eja ulu, nuk do të bisedojmë përherë në këmbë, - dhe ai vetë u ul në kolltukun e lëkurtë të zi. Edhe Besnik Bisha erdhi e u ul aty.

Greth Bubësi e detyroi veten dhe e pa instruktorin drejt e në sy, pastaj ai mblodhi me shikimin e vet ato shpatulla të zgjeruara e të përkulura para që i jepnin kurrizit një lakim të ndjeshëm, të dy duart përherë të lidhura instruktori i mbante midis gjunjve. Heshtën një copë herë të gjatë. Shefi i sektorit priti se mos heshtjen e prishte tjetri, por ky ishte i patrandshëm.

- A e lexove shkrimin e sotëm: "Një hero i ditëve tona" të Nik Nikut në "Bashkimi"?

- Po.

- Si t'u duk?

- Si shkrimet e Nik Nikut, ai ashtu i bën.

- Si, ashtu i bën?

Greth Bubësi kërkoi të depërtojë në mjegullnajën e shikimit të Besnik Bishës. Ishte vështirë të kapje diçka në ato bebëza të palëvizshme, të zhbëra diku. Kjo, në të vërtetë, më shumë se sa e acaronte, e tutte Greth Bubësin. Gjersa ky Bisha ka arritur këtu në KQ dhe pikërisht në sektorin e shtypit, do të thotë që ka ca fije atje lart. Sigurisht që është ky që kontrollon edhe vetë shefin e tij, Greth Bubësin. Shefi i sektorit të shtypit ndjeu një rënie të përnjëhershme diku në fundet e vetes.

- Novelën, a e lexove?

- I hodha një sy fluturimthi, një stil i lodhshëm...

- Domethënë që s'e ke lexuar, unë e kam kërkuar në bibliotekë e akoma s'ma kanë sjell.

- Ua sjell unë, po deshët.

- Mirë, Sillma. More, po u bënë nëntë muaj që punojmë bashkë e s'e kemi pirë dot një kafe.

- S'prish punë, - tha Besnik Bisha pas ndryshuar asnjë muskul të mollëzave, - do ta pimë një herë tjetër, shoku Greth. S'prish punë.

Të mërkurën më datë 25 tetor, "Ushtria Popullore" botonte artikullin e gjatë të kritikës së njohur Bardha Kuca, një faqe e tërë gazete. Në tryezën e bukës, Besnik Bisha i shpjegonte së shoqes se kjo arsimitare ishte një studiuese serioze, zotëronte katër gjuhë të huaja dhe ishte duke mësuar edhe mongolisht. Kishte një llogjikë që të mbërthente.

- Sa vjeçe është? – pyeti e shoqja, me një zë si të fyer.

- S'di gjë, po rreth tridhjetepesave.

- E martuar? – erdhi përsëri pyetja.

- Më duket se po, është arsimitar edhe ai.

- Eh, ato po, ato me asi punësh merren, ato atë punë kanë, - tha e shoqja duke larë pjatat në pjatalarësen.

- Është mendje që duhet dëgjuar.

- Serioze mund të jetë, po grua, femër.

Burri u përkul disi më tepër dhe preku me dorë mollën e Adamit që iu ngjit gjer lart gabzherit. E shoqja ishte xheloze, ç'dreqin e zuri atë bisedë tani. Ahere ndjeu pas mbi supe të dy duart e gruas që rënduan mbi të, shpatullat e shpërndara sikur u lëkundën dhe ai u kthye nga ajo. Grimasa e një fytyre të tkurrur femre u ul mbi të.

- Eh, ç'na thënka ajo... studiuesja serioze, kritikja, de?

Më tepër me nënzërin e tij instruktori i partisë, nisi t'i shpjegonte së shoqes se Bardha Kuca kishte kapur një çast të rëndësishëm të novelës "Rabecka jetë". "Të dy ata, autori dhe heroi gati i kanë zhdukur kufijtë midis letërsisë e jetës. Ata jetojnë pikërisht në shpërbërjen e atyre kufijve dhe në krijimin e vetes, si qenie të gjalla e të lira."

Gruaja afroi kryet fare pranë syve të tij kaleshë të veshur përherë me atë cipë mjegulllore që lëshonin vetullat e trasha e gardhi i qerpikëve. Duke e parë ashtu të shoqen, Besnik Bisha mendonte se ajo kokë e vogël, ajo fytyrë e zbehtë, leshrat e prerë shkurtazi, të zezë e të dendur, hunda disi provokuese, po ky ballë që nuk ndryshonte kurrë, këto buzë të holla, mendonte Besnik Bisha, ndërsa gruaja e afronte dhe e afronte vështrimin në sytë e tij, kjo grua nuk ndryshon kurrë... Ajo është e vetmja që nuk i trembet atyre syve, që mund të depërtonte edhe përtej atyre avushave.

- Unë s'dua të di fare nga gjithë ato që thotë kjo marroqe, - tha gruaja. - Burri im i dashur, unë dua të jem e qetë, çupën e kam në gjuhët e huaja dhe do ta nxjerr jashtë shtetit që të

studiojë. Të pëlçasë kush të dojë, po çupa ime do bëhet doktoreshë.

- E ç'ka këtu për t'u kuptuar, - foli lodhshëm i shoqi.

- Ka, sepse unë e di se si mbarojnë këto punë. Dje kam parë shkrimtarin Aleksandër, fëmijët veprat e tij i studiojnë në shkollë, po ai mezi mori pesë kokrra vezë nën banak te shitësja... E mua m'i sjellin në shtëpi, sepse jam gruaja e instruktorit të shtypit të KQ të partisë. Ato që thotë kjo marroqe, a u pëlqejnë atyre lart? - pyeti ftohtë gruaja.

- Pse të mos u pëlqejnë, moj Afërditë...

- Pse të mos u pëlqejnë, moj Afërditë... - Përsëriti plot ironi gruaja. - Atyre lart - dhe ajo ngrii gishtin e dorës në ajër, - a u pëlqejnë, pyes unë. Këtë më thuaj ti.

Zëri ishte zemërak, kërcënues, po gruaja që fliste kishte frikë.

Për herë të parë ai i hodhi së shoqes një shikim të ngrysur e të mërziut. Besnik Bisha e donte atë grua, por u trondit nga maja e gishtit të saj që kulmonte e godiste atje "lart".

Të nesërmen nëpër zyra pëshpëritej për novelën "Rabecka jetë". Ishte më tepër një zhaurrimë e paformët, e papërcaktuar, por që ndihej, lëvizte, herë te njëri herë tek tjetri kuadër, shfaqej dhe ishte aty. Nëpunësit lëshonin nga një fjalë, më tepër ndonjë si pyetje, shihnin tjetrin në sy, prisnin përgjigje, por dhe përgjigja vinte me zë të shuar e gjysmak. Askush nuk dëshironte të dilte mbi të tjerët, por edhe nuk mund të përmbahej pa folur. Sidomos shkrimi i kritikës Bardha Kuca i fuste në ngasje ato shpirtra gërryes nëpunësish.

Ashtu lëvizte jeta.

BIBLIOTEKA E NOVELA  
BASËKIS W'ROKASTERI  
NR INV 58983

Shkrimi i kritikës Bardha Kuca lëvizi Lidhjen e Shkrimtarëve. Sekretari i përgjithshëm për letërsinë thirri në zyrë kryeredaktorin e “Gazetës Letrare” dhe i kërkoi redaksisë të thoshte fjalën e saj.

- Përse heshtet, xhanëm? – pyeti sekretari me fytyrën e rrudhur murgashe, të hidhëruar. Flokët e zbardhur ai i mbante të gjatë dhe herë-herë tërhiqte bishtalecat poshtë me dorë. – Nuk e kuptoj dot këtë mpirje të redaksive tona.

Kryeredaktori nuk e prishi fare gjakun, ai tha shkoqur se ajo, kritikja, ishte vetëm një garibe e asgjë tjetër, por sekretari i përgjithshëm e ndërpreu rreptësisht:

- Kujdes, unë s’flas kot, atje lart ka pakënaqësira për gazetën.

Çuditërisht kryeredaktori as kësaj radhe nuk e prishi drejtpeshimin e vet, përtheu pak kryet, rrotulloi në gojë protezat e dhëmbëve e belbëzoi:

- Gjithçka mund të ndodhë.

- Mund të ndodhë, - ngulmoi kësaj here sekretari për letërsinë.

Zëri i tij ishte me të vërtetë i hidhëruar; dy sytë e vegjël të trishtë nuk donin të qëndronin mbi kryeredaktorin, ato lëviznin në ajër si insekte të trembura. Ai kapi bishtalecat e flokëve të thinjura dhe i tërhoqi poshtë me dorë idhnake, gjatë, shumë gjatë kësaj here, gjersa kryeredaktori korozi e kuptoi se ishte i tepër, tundi kryet, u çua prej karriges e doli jashtë prej zyre.

Drit Bora dhe kritikja Bardha Kuca u bënë emra të ditës. I vetmi që ndihej i hutuar ishte autori i novelës, Engjëll Cukalla, nëpunës për mbushjen e kartelave të pensionistëve

në lagjen numër shtatë të Tiranës. Në darkë e ëma i vuri përpara pjatën me fasule, por ai nuk e preku me dorë. I dhimbte kryet, piu aspirinë e psherëtimi thellë. Plaka e pyeti se ç'kishte, por ai tha vetëm:

- Më dhemb koka.

Dhe me të vërtetë i dhimbte. Sidomos shkrimi i Bardha Kucës e kishte shushatur fare; nuk po kuptonte se ç'po ndodhte, përse ajo zhurmë e papritur rreth novelës së tij. Kishte botuar edhe herë të tjera, shtypi kishte shkruar edhe atëherë, por jo kështu si tani. Vetëm ndonjë tërheqje veshi kalimthi: kujdes, ti shkel përherë nëpër tokë të parrahura. Kësaj radhe ai po e ndjente veten në mesin e një shtjelle të frikshme që po hapej dhe po e përpinte brenda. Po e lavdëronin aq shumë, po e ngrinin kaq lart, sa po ndjente marramendje.

- Oh! Përse këto lavdërime? Po më trembin, - foli me zë të lartë. – Ajo novelë nuk vlen ç'çoç, unë e di, unë e di, por e botova. Dhe kaq.

Nëna i erdhi pranë.

- Pse nuk del të bësh një shëtitje? Ndofta lehtësohesh ca.

Dhe ai doli. U krodh në muzgën e butë të Tiranës, midis turmës njerëzore dhe i erdhi mirë që askush nuk i kushtonte vëmendje, ai ishte një ndër të shumtët, si gjithë të tjerët, asgjë më shumë. Pikërisht ahëre uli sytë e pa këpucët e mëdhaja, të vjetra që shkisinin brenda atij muzgu.

- Si në një dhimbje të asfaltë, - i erdhi në kokë figura.

U ndal duke hetuar atë grimë kohe brenda vetes.

- Përse ajo figurë: dhimbje e asfaltë... - pyeti veten. – Nga më vijnë këto mendime. – E ndjeu se çuditërisht ishte pajtuar me veten. Dhe se ajo figurë shkelte mbi të, ecte, linte



gjurmët e saja, ja ashtu si këpuca e tij që shket brenda muzgut të mpiksuar mbi asfalt.

Iu kujtua novela “Rabecka jetë”, por e hodhi tutje mendimin. Nik Niku, gazetari i “Bashkimit” i kishte thënë:

- Ashtu e mendojnë ata atje lart, vet shefi i shtypit pranë KQ e kishte nisur atë fushatë. Shembulli i heroit pozitiv është jetëdhënës për shoqërinë tonë. Drit Bora, veterineri në fshatin “Trepullazë”, i duhej jetës sonë.

Engjëll Cukalla kishte dashur t’i shpjegonte diçka Nik Nikut, por ishte drojtur, ai e kishte bishtnuar mendimin e vet, gjersa ata në KQ ashtu kishin vendosur, ç’i duhej atij të ndërhynte? Ata atje lart e dinë vet se çfarë bëjnë, ia kishte prerë Nik Niku.

## V.

Shkrimin e kritikës Bardha Kuca nuk e pëlqeu aspak pedagogu i Filologjikut, studiuesi e kritiku i shumënjohur Sazan Ulku. Në katedër, tek po e leçitnin në një lexim gati kolektiv, me gazetën në dorë, Ulku thirri:

- Kjo është vetëm një llapaqene dhe pena e saj do të bëjë hatanë. Keni për të parë, prisni e do të shihni.

Askush s’u përgjigj, vetëm dikush romuzi:

- Eh, jo gjer këtu... Gjithkush ka të drejtën e fjalës së vet, - tha ai.

Vazhdoi një si heshtje e gjatë, si një respekt për të drejtën e fjalës njerëzore, ndërsa kritiku Sazan Ulku ndjeu t’i

kreshpërohen leshrat e gjata e të ashpra të llërëve, nisi të çapisë lart e poshtë, duke rënduar me tërë rëndesën e vet mbi këmbën e djathtë, të madhe e të neveritshme si ndonjë putër e vërtetë e njeriut shpellar.

- Duhet shkruar patjetër, - shfryu inatshëm. – Kjo gërmadhë ka për të bërë hatanë.

Ata që e dëgjuan e besuan premtimin e tij.

Sazan Ulku u ul në tryezën e mbledhjeve të katedrës, shënoi rrëmbyeshëm diçka në gazetë, mbi artikullin e Bardha Kucës, dhe u çua vrinkthi, duke i lënë disi të hutuar pedagogët e tjerë. Ata që e njihnin shpirtin hakmarrës të Ulkut, i druhashin dhe i largoheshin atij. Mbi artikullin e gazetës, ai hodhi shpejt e shpejt mendimin e parë që i erdhi në kokë: “Drit Bora, një hero i vetmuar”. Pastaj shtoi edhe këto fjalë: “Mos harro!”, me të cilat i kujtonte vetes se ky mendim duhej të ishte thelbi i shkrimit të tij.

Të dielën, në të përjavshmen “Gazeta Letrare” doli artikulli i gjatë, dyfaqësh, i pedagogut e studiuesit të Filologjikut, kritikut Sazan Ulku. Artikulli ishte shoqëruar nga redaksia edhe me një portret psikologjik të autorit. Shkrimi mbante po atë titull: “Drit Bora, një hero i vetmuar!” “Bardha Kuca nuk ka mundur dot as të kapë përmbajtjen sociale e historike të këtij heroi të vetmuar të ditëve tona; ajo nuk ka arritur dot gjer në thellësitë e vërteta shpirtërore të atij njeriu që i vetëm lufton, sepse ajo nuk e ka kërkuar atë në jetë, në fushat e malet tona ku vërtetë rritet e jeton ky hero, atje mes fshatarëve e punëtorëve të lirë. Bardha Kuca e ka nxjerrë heroin e vet – ashtu shkruante kritiku: “heroin e vet” – nga rreshtat e novelës (të cilët në të vërtetë janë të zbehtë e pa palcë), e ka përfutur si prodhim epruvetash, rast

i mirë për zyrat burokratike, por këta s'mund të jenë heronjtë e kohës sonë. Drit Bora i vërtetë jeton atje, në Trepullazë, ai është prej mishi e gjaku, prej balte e uji, një veteriner i thjeshtë, por që mendon për të sotmen e të nesërmen. Është i vetëm. Por, është ai heroi i vërtetë i kohës sonë. Nesër ky hero, sigurisht që do të projektojë diçka tjetër, më të rëndësishme në mendjen e vet, e jo vetëm një mbrëmje dëfrimi për rininë”.

Autorit të novelës, kritiku Ulku nuk i kushtonte ndonjë vëmendje, ai linte të kuptohet që s'është çoç ndonjë talent dhe ai njeri është tepër i parëndësishëm në jetën e vet personale, gjë që shfaqet në stilin e tij. Ndërsa Bardha Kuca na informon vetëm se autori është një nëpunës pensionesh e kaq. Gjëra fare të rëndomta.

Shkrimi i Sazan Ulkut, si një pincë, shkëputi “oh-hoonë” nga thellësitë e kraharorit të shefit të sektorit të shtypit. Greth Bubësi ndjeu një si levë që e ngriti në ajër dhe e lëkundti drejtpeshimin e tij. Problemi po zgjerohej, po hapeshin çështje të tjera, të cilat ai vet s'i kishte pandehur më parë. Futja në vorbullën e firmave të mirënjohura të kritikës, së vëndit, po i jepte tani tjetër drejtim dhe tjetër hapësirë kësaj çështjeje, të cilën ai në fillim e kishte menduar thjesht si vetveprimtari e shkollës së Trepullazit. Greth Bubësi rilexoi në krye të “Gazetës Letrare” emrin e Sazan Ulkut, valëzoi sytë pezull mbi ato shkronja dhe nuk po shqitej dot prej tyre. Shtypi zilen e instruktorit, por te pragu i derës nuk u duk njeri. Shefi i shtypit mendoi të shkonte poshtë në klub, por ishin orët e zbrazura dhe ai ndërroi mendim. Ata artikuj gazetash e bënë të ndjejë se sa i lehtë ishte vet ai Greth Bubësi, që e kishin marrë prej Skuterre dhe e kishin bërë kuadër politik të rëndësishëm. Tani, kur përpara dalin çështje të tilla,

gjithçka ngatërrohet. Ai ngriti dorezën e telefonit e formoi numrin. Që andej erdhi zëri i vet profesorit.

- Alo, - foli Greth Bubësi, - këtu KQ...

Dhe heshti. Tjetri andej tha vetëm:

- Kush është?

- Shefi i sektorit të shtypit... Greth Bubësi.

- Ah, ju njoh... ju njoh...

Fjalët e kritikut vinin të veçuara, të menduara dhe tepër të kujdesshme.

- Faleminderit, - tha shefi i sektorit të shtypit, - Profesor, - foli pastaj përnjëherësh, - lexova shkrimin tuaj.

Tjetri nuk përgjigjej, sigurisht që priste të dëgjonte mendimin gjer në fund.

- Ju përgëzoj, - i shpëtoi Greth Bubësit.

E kishte hedhur hapin, e kishte thënë mendimin, tek i cili tani duhej të mbahej. Kompleksi i inferioritetit për ta përballuar kritikun, e çoi shefin e shtypit tek ai përgëzim i përnjëhershëm, që i bënte shkrimin të gazetës.

- Më pëlqeu, - tha Greth Bubësi, - dhe ju falënderoj, sepse po na ndihmoni.

- Është detyra jonë.

- Jo, po ju profesor, e keni kapur problemin me argumente bindëse, heroi pozitiv...

- Natyrisht, heroi i sotëm nuk mund të jetë ai i djeshmi... Drit Bora është tjetër... tjetër. Ajo Bardha Kuca e gjorë përpiqet, por nuk bëhet vetëm me dëshirë, duhet edhe të mundësh...

Greth Bubësi ishte tepër i vëmendshëm aty; askush nuk përzihet në mendimet personale të njërit e të tjetrit. Dhe ai pëshpëriti si duke qeshur:

- Të gjithë i duhen partisë, profesor. S'ka gjë, të gjithë të partisë jemi.

As tjetri nuk shkoi më tutje.

Në numrin tjetër, po të "Gazetës letrare", botohej shkrimi i dytë i kritikës Bardha Kuca: "Një përgjigje që ia vlen". Kritikja leshverdhë, buçkalashe, kishte një penë nervoze, sidomos ditëve kur grindej me të shoqin, i cili sapo e shihte që ulej në tryezën e punës, ia lëshonte thumbin:

- Eh, po mendon për kombin? Si shkon kombi arbëror?  
- pyeste i shoqi.

Kaq mjaftonte që ajo femër topolake, e mishtë, të niste të djersinte.

- Këto janë punë të mia, - thoshte ajo, - ti shih të tuat.

Gjithë dufin e saj e shpërthente pastaj në ato rreshta të zeza që gërvishte mbi letren e bardhë. Kësaj here ajo u derdh e tëra: "Shkruesi i shkrimit (ajo nuk tha as profesori, as kritiku, por vetëm shkruesi) tregon jo vetëm paaftësi e inkompetencë për të trajtuar tema të tilla të lirisë e të personalitetit, siç është rasti i Drit Borës, por s'kam pse të mos e them, se nxitja e vetme që e ka shtyrë të shkruajë, është smira. Ky njeri nuk mund të pranojë që edhe dikush tjetër të mund të shprehet lirish, t'u prijë proceseve ekzistenciale. Nuk janë interesat e popullit, as të Shqipërisë dhe as të partisë, por përfitimet personale të vockla e mesquine, që e shtyjnë këtë njeri të përgojojë e të përjargë gjithçka.

- Punë e madhe, - shkruante kritikja - se merr nëpër këmbë personalitetin e një pene të kulturës sonë, por ajo që është dëshpëruese, ai fyen vet heroin Drit Bora, i cili ka nisur të frymëzojë dhjetëra të rinj, të reja, sidomos në fshatrat e largëta

të Shqipërisë (por jo vetëm në fshatra), ku jeta megjithëse është zbukuruar, përsëri është tepër e ashpër dhe, pse të mos e pranojmë, e zymtë.”

Dhe ajo bënte goditjen e drejtpërdrejtë: “Ç’ka shkruesi Sazan Ulku me Drit Borën? Ai thotë se ne nuk paskemi qenë në gjendje të zbërthejmë këtë fenomen estetik të shoqërisë sonë, por fatkeqësisht (apo fatmirësisht) është ai vet që as i afrohet dot këtij heroi të ditëve tona, sepse Drit Bora është mishërim e simbol sakrifice për popullin, ndërsa shkruesi ynë i nderuar, nuk ia njeh dot këto virtyte, besojmë as vetes.”

Ajo fërkoj duart që po i djersisnin, u kthye mos shihte të shoqin t’i kërkonte t’i ziente një çaj, por ky kishte rënë në shtrat e lexonte libër.

Bardha Kuca tundi kryet, sikur deshte të përsëriste atë që e kishte thënë aq e aq herë:

- Gabimi është i imi, gabova një herë që u martova me ty, tani nuk kam dëshirë t’i hap vetes telashe të tilla, s’jam më e re.

Në atë çast iu kujtua Agim Buxhuku, kolegu i shkollës, miku më i mirë i saj. Ajo u qetësua menjëherë, u çua vet e shkoi e vuri xhezven në furnelë. Dhe u kthye në tryezën e punës.

Lexoi ato që kishte shkruar, nuk i pëlqyen, si shumë e ashpër, e drejtpërdrejtë, pa takt. Mendoj t’i ndreqte, por pastaj ndërroi mendim, ai maskara i meriton të gjitha, i tha vetes dhe nuk preku asgjë.

## VI.

Engjëll Cukalla eci nëpër muzg të mbrëmjes pa asnjë drejtim, ku e shpinin këmbët, përshkonte rrugicat e ngushta të përdredhura të Tiranës, i largohej ndonjë hijeje të rastit, apo ndonjë qeni që lehte prapa derës së shtëpisë përdhese. Më në fund hyri në një pijetore lagjeje të humbur. Tymi i athtë i qofteve të skarës i ra në kokë, pastaj afshi i frymës së ndohtë të njeriut. Nën dritën e zbehtë, në një tryezë të lyrtë qëndronin tre pijanikë, edhe në tryezën pranë ngriheshin dy kokë të kreshpëruara me sy që lëshonin çika, pa ditur përse. Dikush i foli “mirëmbërëma”, po Engjëll Cukalla shkoi dhe u ul i vetëm në cepin tjetër, ku ishte një tryezë boshe. Dhe foli me zë të lartë:

- Një raki.

U habit prej atij zëri çjerrës e provokues, s'ishte zëri i tij i zakonshëm. Dhe përnjëherësh u tulli në vete, ndjeu dëshirë të mblidhte këmbë e gjunjë, t'i afronte ato te gjoksi, por ishte e pamundur. Zgjidhi këpucët e mëdha me shuajtë e ngrëna nga ecja. Dyqanxhiu i solli rakinë dhe pyeti nëse dëshironte meze:

- Jo, pa meze.

Tani ishte zëri i tij, ai i zakonshmi, i druajtur. Dyqanxhiu qëndroi një çast pezull mbi të, lëshoi gotën e rakisë mbi tryezë e u largua.

Shkrimtari u hodhi një shikim të heshtur e të gjatë atyre të treve që kishte përpara në tryezën e nxirë prej lyre dhjamrash e avujsh. Kokat e tyre u avitën pranë njëra-tjetrës, po nuk u dëgjua asnjë zë. Nuk bisedonin, dëshironin vetëm të ishin më afër njëra-tjetrës. Ato koka kërkonin më shumë

errësirë se dritë. Engjëll Cukalla mendoi se tani vet ai ishte një lëmsh i asaj dritë-errësire dhe ai lëvizi dhe pa në dysHEME hijen e tij të mjegulltë që deformathej e shpërbëhej. Edhe ai vet ishte i tillë, një lëmsh hutimi i tymtë që rrëshkiste e strukej larg rrapëllimës së zhurmshme të njerëzve.

Gazetat shkruanin për personazhin e ditës, Drit Borën, dhe jo vetëm gazetat, por edhe lexuesit, qytetarët e thjeshtë, zgjoheshin e kërkonin, e përfytyronin të gjallë në bisedat e tyre. Gjithnjë e më shumë zhurmë, nënzhurmë, pëshpëritje që ndihen e janë atje thellë në shpresat e varfra të qytetit.

- Po sigurisht, vet le ta ngrehin jetën e tyre të rinjtë...

- Pse vetëm të rinjtë?

- Nuk thashë gjë, po le të përpiqen, desha të them.

- More shokë, jeta është jotja dhe jo e atij kryetarit të pushtetit. Kështu më duket mua.

Për autorin flisnin fare pak, ndërsa, sipas gazetave, tanimë, nën shembullin e Drit Borës, edhe djelmosha e çupërlina të tjera, "po e merrnin veten në duart e tyre", vet po organizonin koncerte, mbremje poetike, dikush kishte dalë edhe me minifunde...

Engjëll Cukalla pa një kokë karshi që ishte drejtuar nga ai, një kokë e madhe, me flokë të zezë të përdredhur, të kreshpëruar, një kaptinë e palarë dhe ca sy pyetës, të humbur. U dëgjua dikush që foli:

- Hallexhi, flet me vete.

Engjëll Cukallës iu kujtuan formularët që mbushte në degën e pensioneve, pensionistët vdisnin e ai mbyllte kartelat e tyre. Ky përkarshi duhet të jetë murator, ka pesë fëmijë, është grindur me gruan e sot vjen të dehet këtu që të kthehet në shtëpi i dehur. Pastaj dysheku e pajton me të shoqen. Kjo



kokë mund të pritet, si një shtëllungë ajri. Si? Si një lëmsh i mjegullt, i ajrtë që mund ta presësh me shpatë. Engjëll Cukalla u habit: përse i vijnë në mendje këto figura? Ja, dy kokat e tjera, ato s'janë asgjë, prej asgjëje, dhe e dinë këtë. Dy koka si dy gjysma të një përralle të mërzitshme. E vetmja gjë që ato nuk e shkojnë në mendje është përse kanë ardhur gjer aty. Engjëll Cukalla nuk po merrte vesh asgjë: kush e kishte shpikur Drit Borën, kush e kishte krijuar heroin kryengritës të novelës së tij? Ai vet jo. Sapo guxoi të pyesë Nik Nikun, gazetarin e vjetër të gazetës "Bashkimi" që i pari i kishte folur atij personalisht, ky iu përgjigj plotfuqishëm duke shpuar me gishtin shënues të dorës së djathtë qiellin e ulët të klubit të shkrimtarëve:

- Ata lartë... ata atje i dinë punët e tyre...

Atëherë ai ndjeu frikë, ndjeu sikur po ftohej, po zhbëhej e po tretej në terrin e mpiksuar të një tuneli të errët e pa dalje.

Zgjati dorën e preku gotën e rakisë.

Shefi i sektorit të shtypit kryqëzoi shikimin me instruktorin e vet, Besnik Bisha. Përtej mjegullave të syve të tij kalesh diçka lëvizi. Në konferencën për shtyp kishte ardhur edhe i deleguari, njëri prej atyre lart, "kompetenti" si i thoshin. Një fytyrë e rrumbullaktë mbështjellë me një cipë të bardhë, me gjyslykë miopi të zeza, tepër i ftohtë e i kontrolluar dhe i pakët në lëvizjet e veta, ai murmuriste ca si gjysmafjalë me një politesë të shtirur. Por ishte korrekt, i panxituar dhe tepër i matur.

"Kompetenti" solli përshëndetjet e udhëheqjes lart, tha se gjithçka ishte mirë, populli shqiptar është i mrekullueshëm. Ata që e kishin dëgjuar edhe herë të tjera në konferencat e shtypit, e dinin se ato ishin fjalë për t'u thënë, gjuhë e

zakonshme e aparatçikëve dhe s'u kushtuan vëmendje. Po si nëpër të, i deleguari lëshoi se megjithatë “duhet patur kujdes, sepse gjendja mund të dalë e të rrëshqasë nga dora. Një hero si Drit Bora mund t'u fusë në kokë zekthin mijëra të tjerëve”. Greth Bubësi ndjeu sikur e pickoi ndonjë akrep, ai u skuq, ndjeu gjakun t'i vërshojë në fytyrë dhe pastaj djersët që i mbuluan ballin.

Në mbarim të konferencës, i deleguari nuk qëndroi siç e kishte zakon dhe nuk zbriti poshtë në bufe të bisedonte me ta. Me gjysmë buzëqeshjen e vet, ai u përfal dhe u largua prej andej. Bufeja u mbeti gazetarëve.

- Ç'ishte ajo bombë?

Nik Niku gëlltiti gotën e konjakut dhe i tha Besnik Bishës:

- Hap sytë, se do ta pish; të kam shok, - tha Nik Niku.

- Ç'hyj unë këtu?

- Si ç'hyj unë këtu? Ti je instruktori i shtypit, më i vogli, dhe, më i vogli e ha... Duhet patur kujdes, sepse “gjendja mund të dalë nga dora”, këtu udhëheq udhëheqja, i dashur. – Kësaj radhe ai lëvizi poshtë gishtin e madh të dorës, po Besnik Bishës iu kujtua e shoqja, po ai gisht tregues, po ajo fjalë akulluese “lart”, po ai qiell që shpohej prej majucës së atij gishti. Liria e shumtë është anarki...

- Ç'hyn këtu anarkia?

- Si ç'hyn këtu anarkia? Një Drit Bora... Dy Drit Bora...

Tre Drit Bora... Ju e mbushët Shqipërinë me Drit Bora. Sot një mbrëmje dëfrimi, nesër një mbledhje shkencore, pasnesër një piknik, paspasnesër... Të thashë, këtu ka kush udhëheq, kjo botë nuk është aq e ngatërruar sa duket, miku im.

Dhe Nik Niku u çua, hodhi xhaketën në sup dhe bëri të dalë nga bufeja.

- Po ti ishe i pari që shkrove, - erdhi zëri i instruktorit të shtypit.

- Oh, unë... lermë mua... I vogli e ha, i vogli është mut. I pari që shkroi është Ilir Guralumi, ai kritiku, në qoftë se nuk të ka lënë kujtesa. Kujtohu, pyete atë se ku e gjeti Drit Borën, ndofta heroi i ditëve tona i doli nga gota e konjakut, si Afërdita nga koka e Zeusit.

Ai emër i gruas e akulloi gjithë trupin e Besnik Bishës, dhe ky foli i ngrysur:

- Vetëm atë emër mos ma përmend tani.

Ishte hera e parë që gazetari i "Bashkimit" nuk po kuptonte vërtetë asgjë nga bota. Ai i nguli sytë e tij të bardhëllemtë e të budallallepsur tjetrit, e pa me ngulm, e pyeti me atë shikim të gjatë dhe si nuk mori asnjë përgjigje, ngriti supet e u largua.

## VII.

**B**a telefoni. Greth Bubësi u hepua një çast, e parandjeu se telefononin ata lart. Ngriti dorezën dhe priti gjersa prej andej erdhi zëri i "kompetentit":

- Përse të kemi ty aty?

Kërcënimi i ftohtë i atij zëri përshkroi gjithë qenien e shefit të sektorit të shtypit. Ai zë i gjithëpushtetshëm vinte përherë me frikën e së panjohurës që pushtonte gjithçka, edhe zbrazëtirat e poreve të trupit. Ishte e kotë t'i kundërshtoje.

- Ju, çfarë do t'i përgjigjeshit atij?

- Kujt? - belbëzoi shefi i shtypit.

- Atij, shkrimtarit... - zëri nga lart e gërmëzoi egër fjalën shkrimtar, duke e ndarë atë në mes, duke e grimcuar nëpër dhëmbë e duke përtypur tani çdo mirësjellje.

- Përse?

- Përse...

U shtri një hapësirë kohe pa kujtesë, e frikshme, drithëruese dhe nëpër të, si kërcëllima të formimit të akujve, Greth Bubësi, dëgjonte cingërimat e fijeve të telefonit.

- Në prokurori ai ka deklaruar se një personazh me emrin Drit Bora as që gjendet në novelën e tij, nuk ndodhet gjëkund, ai as që ka menduar ndonjëherë të shkruajë e të krijojë një hero letrar, të quajtur Drit Bora. Në novelën "Rabecka jetë" ai ka rrëfyer vetëm një ëndërr, i është bërë vetja sikur është arkeolog, ka zbuluar një statujë antike dhe gjithë natën ajo statujë është gjallëruar, në një femër... Në novelë janë vetëm këta të dy, arkeologu dhe ajo femra e statujtë, personazhe të tjera s'ka.

Greth Bubësin e mbuluan djersë të ftohta, zëri i tij u zbardh:

- Po ku e gjëtën ata kritikët, atë hero? Nuk ka Drit Bora gjëkund?

- Gjëkund, - erdhi prerë zëri nga lart. - Nesër, brenda orës 12, presim të na dërgoni një relacion të intësisshëm.

- Dhe telefoni u mbyll.

Shefi i sektorit të shtypit kishte prekur fundin e vet, ai shtriu duart e kryqëzuara mbi tryezë, nguli sytë në orën "pobieda"; tani akrepat shënonin 13<sup>15</sup>. Lëshoi kryet mbi llërë, pastaj një rënkim i thellë. Sa ndenji ashtu? Nuk përmendej dot, asgjë nuk kishte qenë e vërtetë, veç në kokë, në trup, në gjithë qenien e tij uturonte akoma zëri nga lart: "nesër presim relacionin tuaj, ora 12!". Nesër...

## VIII.

Greth Bubësi shtypi zilen e instruktorit dhe pas disa çastesh trokiti dera. Besnik Bisha u ndal si përherë atje te pragu me duart e lidhura përpara. Ndër ato duar ai mbante novelën.

- Novela? – pyeti shefi.

- “Rabecka jetë”.

- E gjete atë, heroin?

- Nuk ka.

- Nuk ka...

- S’ka Drit Bora gjëkund. Ky Engjëll Cukalla rrëfen vetëm për veten e tij, dashuri në ëndërr me një statujë antike. Këta shkrimtarët janë fare të lojtur nga fiqiri.

- Drit Bora s’ka gjëkund... - murmuriti shefi i shtypit.

Greth Bubësi nuk e fshehu rënien para instruktorit të vet. Ishte i paaftë, injorant, kishte ardhur gjer aty nga fshati Skuterrë dhe dëshironte të ngjitej më lart. Por sot e ndjente se do të shembej përfundim.

- Afrohu Besnik, afrohu... E kemi pisk shok, ata lart janë tërbuar. Sapo fola me shokun “kompetent”.

- Kanë të drejtë, - tha i qetë Besnik Bisha.

Greth Bubësi e mbështolli atë me një shikim të dëshpëruar, ato shpatulla të shkrehura të instruktorit sikur do ta lëshonin poshtë xhaketën e gjerë, ata krahë pa jetë të tij si mund të shtriheshin dhe ta ndihmonin të mos binte, atë Greth Bubësin?

- E kemi pisk, shok.

Po atëherë instruktori i shtypit foli:

- Nesër në “Bashkimi” botohet artikulli i gjatë i Nik Nikut: “Në fshatin Trepullazë gjithçka është e qetë”.

- Si e qetë?

- Qetësi fare, - tha instruktori i shtypit, dhe ai buzëqeshi lehtas. - Si në Shpikë, vazhdoi ai.

Greth Bubësi po e vëzhgonte me sy fare të çapëluar vartësin e vet. Besnik Bisha ndjeu një kënaqësi të brendshme dhe duke parë drejt ata sy të budallallepsur, nisi t'i rrëfejë atij se në luftën Ruso-Turke, në Shpikë të Bullgarisë, pas betejës nuk kishte mbetur asnjë i gjallë, të gjithë kishin vdekur.

- Artikulli botohet nesër, përfundoi instruktori i shtypit. Në Trepullazë asgjë s'pipëtin...


Greth Bubësi u çua prej karriges, u shkund për të provuar nëse e mbanin këmbët, pastaj drejtoi shtatin.

- Nesër, atje lart presin relacionin tonë, në ora 12.

- Unë e shkrova dhe e dërgova atje...

- Ah!

Erdhi zëri i habitur dhe i trimëruar i shefit të sektorit të shtypit në KQ.



# Të mëdhenjtë e katundit tonë

*“Është lehtë të durohet mjerimi,  
kur mund të dhjesësh si zotëri”*

DINO BUZZATI

## I.

**E**dhe i zgjuar, arkitekti 27-vjeçar, Redon Bruka, vazhdonte të ndodhej nën rrënojat e atij tërmeti të frikshëm, s’po dilte dot prej asaj zhgjëndre të atij mëngjesi prilli 1974. Shtrirë në shtrat bëri të lëvizë krahun e djathtë, por nuk mundi, krahu i ishte akulluar e kur ktheu kryet aty, Redon Bruka sikur pa një trup të mbuluar në çarçafë të bardhë, të vdekur. Përpiqej të përmendej e të mblidhte veten.

- Mba mendjen... i foli vetes.

Ishte akoma nën gërmadhat e Tempullit të njerëzve-zota, atje ku pati ndodhur kur kishte rënë tërmeti. Iu kujtua se ai po shkonte nëpër rrugën e Dibrës, kur i ishte afruar një nga ato gjimnazistet e viteve të fundit të “Sami Frashërit”. Fytyrën e saj nuk e shquajti dot, as tani nuk i kujtohej, por akoma i qëndronin në vesh fjalët e saj: “Redon, unë të dua ty... Dua të martohemi bashkë...” Ishte një zë i lehtë vajzëror e Redon Bruka iu bind atij zëri.



Lëvizti lart krahun e mpirë, ushtroi gishtërinjtë dhe psherëtimi i çliruar:

- Paska qenë ëndërr...

U çua prej shtratit dhe ashtu siç ishte në bizhama shkoi tek tryeza e punës. Mbi fletën e bardhë të projektit, që kishte lënë të përgatitur qysh mbrëmë, hoqi disa vijëza të lehta. Iu bë sikur pas lapsit u përndez fistoni i ndritshëm që ecte nga lëvizte dora e tij.

- Edhe Tempulli ynë do të ketë banja moderne. Mjaft më ajo nevojtoje e vjetër turke, që ke krupë t'i afroresh dhe jo më të hysh brenda. Në të tjera kohë jeton sot Tempulli i njerëzve-zota.

Ai nuk donte të thoshte i "zotave-njerëz", jo, "Tempulli i njerëzve-zota". Redon Brukës i ishte ngulur në kokë, që patjetër ta ndryshonte, ta rikonstruktonte, nevojtojen e Tempullit tonë të kulturës.

Edhe sot e kësaj dite, edhe tani që unë po hedh këto rreshta në letër, nëse juve u kap nevoja e shkoni atje, ju do të shtyni një derëz të vockël, gati të kalbur, e cila do të cijasë me një gërvimë që do t'ju ngjethë mishtë, pastaj do të shtyni një çengel të ndryshkur për ta mbyllur. Te gryka e vëcësë turke të ciflosur rrjedh vazhdimisht uji nga tubi i vjetër i lidhur në rubinetin e trunçtë të çesmës që s'mbyllet kurrë. Uji rrjedh pa ndërprerje ditë e natë. Doreza e rubinetit nuk punon dhe dritarja e vogël karshi nga hyn një fije drite është pa xhama dhe e kalbur.

Redon Bruka u largua pakëz nga projekti e frymëmori thellë. Brenda trupit të tij lëviznin dy fjalë: ajër-dritë. Edhe diçka tjetër, por ai u ndal. Nisi të merret me përlogaritjet e

projektit dhe humbi në punën e vet. Atëherë i tingëlloi përsëri në vesh zëri i ngrohtë i maturantes: “Redon, unë të dua ty...”. Cila ishte ajo?

Hyri përsëri në shtrat duke kërkuar nëpër trurin e tij atë femër. Dhe ra përsëri në ëndërr. Tani përpiquej ta shihte fytyrën e maturantes që e kishte kapur për dore, dhe prej rrugës së Dibrës po e tërhiqte drejt Bulevardit Qendror, aty ku ngrihet Galeria e Arteve dhe një lis i madh pelazgjik hijeshonte madhërishtëm. Redon Bruka dëshironte të shihte fytyrën e maturantes që e mbante fort prej dore, gishtërinjtë e saj e shtrëngonin, i ndjente çapet kur ecte dhe dëgjonte zërin e saj.

- Do pyesim Orakullin, - tha vajza.

- Cilin Orakull?

- Këtë... lisi e moçëm në zemër të Tiranës. Ti nuk e ditke? Këtu vijnë çiftet e reja dhe e pyesin Orakullin për fatin e tyre.

- Ah, diku kam dëgjuar... Në Tiranën tonë qenka Orakulli?

- Po, - tha ajo e bindur në veten e saj.

Arritën atje. Nëpër qiell fluturoi një frushurimë ere dhe gjethet e njoma të lisit nisën të lëvizin. Të heshtur ata të dy qëndronin para asaj enigme dhe urtësie të moçme të atij lisi. Redon Bruka tha:

- Kaloj këndeje përditë... vetëm tani po e zbuloj këtë pamje, si ka ardhur gjer këtu e ka qëndruar ky lis kaq i moçëm?

U ndje një lëkundje e tokës, pastaj një gjëmim i frikshëm që ecte nën dhé, uturimë. Lisi u tund në ajër, gjithçka shungulloi dhe ata të dy i përpiu humnera e atij tërmeti.

Sapo kaloi hotel Dajtin e u qas pranë kioskës që mbante emrin: “West”, Redon Bruka mbeti me të vërtetë i befasuar: lisi i moçëm i Tiranës ishte përmbysur. Gati në themelet e prapme të “West”-it, ishte hapur një gropë e madhe, rrënjët e vjetra ishin shkukur dhe gjithë hapësirën e trotuarit e kishin mbuluar degët e thyera. Tubat e ujësjellësit që e kishin gërryer atë tokë vazhdonin të rridhnin pa ndërprerje. Ishte ajo gërryerje që e kishte përmbysur gjithë atë lëndë gjigande. Orakullin e moçëm pra, e kishin vrarë kohët moderne që tashmë kishin ardhur edhe në Shqipëri. Redon Bruken e pushtoi një trishtim i thellë, tek shikonte atë gjigand të gjelbër që kishte arritur gjer aty në atë ditë, dhe më në fund edhe ai e kishte mbaruar jetën e vet. Një hyjnor i lashtë, i pafuqishëm e i vdekur shtrihet tani mu te këmbët e tij. Kjo nuk paralajmëronte fat të mirë përpara. Arkitekti i ri nuk po u besonte dot syve të vet. Më dëshpëruese ishte mospërfillja e kalimtarëve që kalonin anash e ruheshin të mos u përbalteshin këpucët. Një studente mbuloi e mbrojti me dorë kërthizën lakuriqe të barkut, që të mos i spërkatej.

Duke shtrënguar ndër duar tubin me fletët e projektit për Tempullin, Redon Bruka u afrua më pranë lisit të rrëzuar, kapërceu midis degëve të thyera dhe ndjeu se ajo vdekje po i hynte në trup. Kërkoi shtegun e doli nga pas, andej nga gropa e dheut ishte më e thellë e rrënjët kishin dalë mbi tokë. “Këtu, foli me vete, pikërisht këtu tërmeti që ra mbrëmë na zuri përsipër mua e maturanten... Paska qenë e vërtetë...” E përmendën zëra kalimtarësh, pastaj ai i gazetashitësit që ngrihej mbi të tjerët: “Gazeta Koha...”, “Shekulli...” “Gazeta Shqiptare”... “Albania...” Redon Bruka u largua prej andej me një dëshpërim të egër në shpirt.

- Barbarë... përdorët ujin të gërryente rrënjët e një monumenti të tillë... Jemi vetëm barbarë...

U drejtua nxitimthi drejt Tempullit, të paktën atje jetojnë njerëz-zota. Ata janë të mëdhenjtë tanë në tru e në shpirt. Pa kthyer kryet pas, sikur ta ndiqte njeri, kaloi para monumentit të Skënderbeut, Bankës Qendrore, përshkoi trotuarin dhe u ngjit shkallëve të Tempullit. Në korridor u ndal para zyrës së inspektores, trokiti e hyri brenda. E përshëndetën sytë e gjelbër e të vegjël të gruas, pastaj koka e saj lëvizi në një hapësirë fare të vogël.

- Ja, edhe projekti, - foli Redon Bruka, duke lëshuar mbi tryezën e saj tubin me fashikujt e projektit.

Sytë e gjelbër të inspektores u picëruan dhe ajo pyeti:

- Ç'janë këto?

- Një projekt i ri për banjat e Tempullit tonë.

Arkitekti i ri nuk donte të thoshte "për nevojtoret".

- Ju e kuptoni, banja e tanishme është neveritëse...

- Ah... - grujaja murmuriti disa fjalë që askush nuk i kuptoi, por që arkitekti i mori: "sa mirë... si të paska shkuar në mendje...".

Ishte një grua e këndshme dhe Redoni e falënderoi atë.

## II.

Kishin kaluar tre muaj e prej Tempullit nuk kishte asnjë fjalë për projektin. Arkitekti priste me ankth ndonjë lajm, përgjonte ndonjë shenjë. Asgjë. Kur një ditë iu hap kolegut të vet, poetit Korab Gruda, ky uli sytë mbi librin që po redaktonte e tha:

- Diçka kam dëgjuar... ashtu shkarazi... E kush merret te ne me asi punësh?

- Si? As ti...

Poeti buzëqeshi.

- Njëpër redaksi diçka është përfolur, por të them të drejtën, unë nuk i kam dhënë ndonjë rëndësi.

- Ti, poeti, shpirti i bukur i qiejve?

- Dëgjo, - dhe Korab Gruda shënoi mbi letër një vijëzë që shkonte drejt qiellit. - Përenditë, - tha ai, - vërtetë që hanë e pinë si njerëzit, por unë nuk kam dëgjuar gjëkund që ato të kenë nevojë edhe për nevojtoare. As Homeri s'na e ka thënë një gjë të tillë.

Një dritëz e lehtë u përndez nëpër sytë e arkitektit. Sapo i ishte shkrepur në tru që të projektonte një nevojtoare moderne për Tempullin e njerëzve-zota, atij i kishte ardhur në kokë pikërisht ai mendim. Vërtetë, zotat nuk kanë nevojë për gjëra të tilla.

- Po gjysmë-zotat? – pyeti.

- Nuku... - dhe poeti po qeshte – Nuku... - tha ai.

- Po njerëzit-zota?

- Pra, a paska të tillë?

Atëherë edhe arkitekti qeshi, veç buzën e tij të poshtme sikur e nduku ironia.

- I dashur poet, - tha ai, - unë e di mirë që ti vetë i përket racës sonë të njerëzve-zota...

Korab Gruda mori kokën ndër pëllëmbë.

- Ndofta ke të drejtë, ndofta... Unë nuk e kam menduar kështu. Por, ndofta... Duhet pyetur vajzat, sepse ato i marrin vesh punët e Tiranës më parë e më brenda se kushdo tjetër.

Ai u çua nga karrigia, shkoi në zyrën pranë dhe pas ca kohe u kthye së bashku me Afërdita Tokaj, një zeshkane e gjatë me vështrim mospërfillës. Ajo i zgjati dorën nga larg Redon Brukës, duke shushuritur nëpër dhëmbë emrin e saj. Arkitekti i ri nuk ia lëshoi dorën, iu afrua e u përpoq të maste me sy gjatësinë e supeve të tyre.

- Jo, - mendoj me vete, - nuk je ti...

Atyre të dyve që po e shihnin disi të habitur, u tha:

- Unë shoh natë për natë një ëndërr... një vajzë më vjen natë për natë në ëndërr... Po nuk jeni ju... Ajo duhet të jetë pakëz më e shkurtër nga ju.

Balli i ngushtë i Afërdita Tokaj u mbloodh më tepër, sytë e zezë iu turbulluan dhe disi e shqetësuar ajo pa nga Korab Gruda. Sikur pyeste:

- A jeni njerëz normalë?

Poeti i ri buzëqeshi. U ul në karrigen e punës e duke lidhur gishtërinjtë e duarve, tha:

- Ne jemi miqtë e tu më të mirë, ti nuk e di as vetë se çfarë miq besnik ke, moj Afërditë.

Dhe poeti shënoi me kokë arkitektin e ri.

- Diku ju kam parë, - murruriti vajza tani pakëz më e qetë.

Ajo nguli shikimin në sytë e kaltër të arkitektit, ata sy ishin të qetë e të mirë. Koka e mbuluar me flokë të shkurtra rricarica, iu duk vajzës si tepër e rrumbullt dhe ajo desh të buzëqeshë, por u përmbajt.

- Ndofta në ëndërr... - tha atëherë Korab Gruda seriozisht.

Vetëm atëherë vajza e mati shlirshëm e ftohtë me shikimin e vet arkitektin që i qëndronte përpara. Shpatullat e gjera sikur lëshoheshin poshtë, ai kishte një bel fare të hollë, por

sytë e vajzës mbetën te kordelja e bardhë që i lidhte bluzën e kuqe. Redon Bruka qëndronte para saj si në ajër, i papërcaktuar, i pandjeshëm. Diçka e krijuar si feminare. Duke e vëzhguar ashtu, vajza u trimërua e tha:

- Nuk e them dot... po ndofta... ndofta edhe në ëndërr...

Mund t'u kem takuar diku... Ju artistët jetoni nëpër ëndërra...

- Prandaj, - tha poeti, - sot ne kemi nevojë për ty.

Dhe ai e pa vajzën drejt në sy.

- Betohu, - tha, - se do të na ndihmosh.

- Përse?

- Më parë betohu.

Afërdita Tokaj bëri një lëvizje pas, ç'kërkoi ato dy "perëndi" prej saj?

- E nëse betohem, ç'kërkoni prej meje?

- Ne duam të dimë se ç'po ndodh në Tempull, ti duhet të na ndihmosh.

- Përse? Çfarë lloj të dhëne doni?...

- Arkitekti i ri ka projektuar natën, nëpër gjumë e në ëndërr, që Tempulli ynë i zotave, tani e tutje të ketë banja të reja moderne, dhe jo më atë të vjetrën që ka tani. Ka tre muaj që e ka shpënë projektin, por nga Tempulli nuk japin asnjë shenjë. Dhe ne nuk dimë se si mund të informohemi.

- Ua, për këtë paska qenë?

Vajza hapi krahët në të dy anët.

- Betohem, - tha ajo, - ju jap fjalën e nderit... Ju jeni të marrë, - tha pastaj duke qeshur.

Çeli derën e iku.

Pas tre ditësh në redaksinë e prozës së Shtëpisë Botuese "Liria s'është asgjë", bëhej kjo bisedë:

- Tempulli i njerëzve-zota do të bëhet me banja moderne, jo më ajo nevojtorja e vjetër, turke... - tha Afërdita Tokaj.

- Kush të tha? – pyeti Suzanë Miroshi, redaktorja që punonte në tryezën karshi.

- E di unë, - tha Afërdita, e sigurt në ato që thoshte.

Dy redaktorët e tjera u panë me bisht të syrit: kjo Afërdita jonë shumë gjëra di...

- Ne jemi mësuar me banjat turke, - pëshpëriti redaktorja e tretë, Mira Vogli, - kush ia nis tani nga e para edhe me nevojtoret?

Afërdita Tokaj u çua rrëmbimthi prej vendit e nisi të baresë lartë e poshtë nëpër zyrë, nervoze ajo kryqëzonte krahët e pushtonte me to krahërorin e vet. Ashtu shtatlartë, e mërzitur dhe e dëshpëruar, përsëriste hidhshëm:

- O Zot! Ç'fat i mjerë ky i popullit tonë. Kur do të bëhemi edhe ne një herë njerëz, me të vërtetë njerëz. Kur do të ecim edhe ne një herë me botën? Ti, Mira Vogli, nuk e ke fare ndjenjën e përparimit. Vetëm nëpër ekranet e televizorëve të shohësh dhe e kupton se si jetojnë të tjerët. Si jeton sot bota... Ndërsa ne... Ne kështu jemi mësuar, kështu jemi mësuar... Si qenkemi mësuar ne? Pocaqi... pisllek...

Fjala e fundit ishte e rëndë dhe Mira Vogli doli fare prej redaksisë. Ajo shkoi nëpër zyrat e tjera dhe atje dha lajmin për modernizimin e Tempullit, ndërsa Afërdita Tokaj vazhdonte ecejaket e saja nëpër zyrë duke folur e duke u grindur me vete. Kaq duhej: Mira Vogli, tani e tutje, do të bënte punën e vet, ajo do të ndizte gjithë qirinjtë për t'u informuar se ç'po ndodhte me të vërtetë në Tempull.

Suzanë Miroshi uli më shumë kryet mbi letrat që kishte përpara dhe u tulat në heshtjen e saj. Flokët e gjatë të zezë i



mbuluan gati fytyrën e ajo nuk dëshironte as të shikonte më nga shoqja e vet që shkonte e vinte nëpër dhomë.

- Pse hesht ti? – e pyeti Afërditë Tokaj.

- *Këto nuk janë punë për mua... punëra Tempulli... Unë nuk kam fuqi të matem me ta...*

Afërditë Tokaj iu afrua dhe u ndal gati mbi shoqen. Kishte të drejtë Suzana, nuk ishte e lehtë dhe pa rreziqe të ngatërroheshe në asi punësh. Brenda vetes, thellë, edhe ajo Afërditë Tokaj, ndjente një si turbullirë të frikshme, çdo të thoshte të rindërtosh banjën e tempullit të madh? Kush ta pranon ty aq lehtë këtë? Iu kujtua arkitekti i ri dhe buzëqeshi. Vetiu ngriti dorën dhe mati supin e saj, ishte pakëz më e gjatë dhe duhej të shkurttohej ca që të hynte në ëndrrën e Redon Brukës.

Sipas informatave, kur inspektorja ia kishte vënë përpara në tryezë të madhit të Tempullit projektin, ky pa ngritur kokën nga “Zëri i Popullit” kishte pyetur:

- Ç’janë këta fashikuj?

- Një projekt për rikonstruksionin e banjave.

- Çfarë?

Dhe ai e la mënjanë gazetën.

- Redon Bruka ka projektuar banjat e reja për Tempullin tonë.

- Redon Bruka... - murmuriti me vete i madhi i Tempullit. Ai bëri një shenjë që s’i kujtohej ky arkitekt i ri.

- Ai dëshiron të bëjë diçka...

I madhi i Tempullit e mori sërish gazetën në dorë e nisi të lexojë.

- Po mirë, - tha nëpër buzë, - çojani sektorit të arkitekturës... ata i dinë më mirë këto punë. Tani çështja paska

mbetur aty te sektori i arkitekturës. Prej andej nuk ka asnjë lëvizje.

Pas brerimës së shiut muzgu i mbrëmjes ishte i qulltë, po lart në qiell shkëlqenin ca yje të vegjël e të shndritshëm. Dikush sikur përgjonte mbi gjithçka. Redon Bruka ishte ulur i vetëm në bar-kafé “Galeria”. Atje tej, nga fundi i kopshtit, tre punëtorë po masakronin lisin e rrëzuar. E prisnin me sëpata të lehta, pastaj i futnin pykë dhe qëllonin gulçueshëm me varre. Me shikimin e menduar Redoni ndiqte ato hije të kimit, format e shpërformat e tyre nëpër muzg. Sikur i ndjente brenda vetes ato sopata të egra.

- O zot, - murmuriti me vete, - sa lehtësisht e vrasim jetën. Dhe askush nuk kujtohet, askush nuk i del dot në mbrojtje natyrës së lodhur.

Në tryezë qëndronte e paprekur gota me lëngun e qershisë që kishte sjellë kamarieri. Gjithë qenia e Redon Brukës tani ishte atje, tek ai copëtim që i bëhej lisit të moçëm. Në trupin e Tiranës tani ishte hapur një plagë, zbrazëtirë, bosh, të cilën askush nuk do të mund ta mbushte më dot.

Orakulli i vjetër nuk ekzistonte më, kishte pushuar së qenuri ai që do të mund t’u parathonte të ardhmen e tyre qytetarëve. Arkitekti i ri u ndal pikërisht në ato dy skajet; e kaluara dhe e ardhmja... Ku ndodhemi ne? Terri i natës po ecte mbi tokë e atje tej u ndezën ca drita që ndriçonin hapësirën. U përhapën cingërimat therrëse të sharrave elektrike që prisnin butshëm trungun e lisit. Redon Bruka e ktheu shikimin e vet mbi tarracën e barit ku ishin ulur plot klientë. Tiranasi po pinin të qetë raki e koka, çlodheshin. Ajo çlodhje ishte e frikshme, çmendurisht e frikshme. E

çfarë? Një pemë pritet, si gjithë pemët e tjera. Këtu vdesin njerëzit, e jo pemët... Po ai simbol i gjerë ka ecur nëpër shekuj që të vijë gjer këtu e t'ju takojë juve, foli me vete Redoni. Ndërsa në heshtjen e tij, klienti përpara thoshte:

- Ju të rinjtë ëndëroni shumë...

- Ah, po, ëndrra...

Tani Redoni ishte jashtë ëndrrës, me të vërtetë jashtë atij ankthi që e ndiqte kudo. Ai u dashurua me lirin më shumë se me ëndrrën e vet asaj nate kur ajo maturantja e panjohur e kapi nga dora dhe e çoi përpara Orakullit.

- Të na parathotë fatin... murmuriti ajo me një zë të drithshëm.

Tani Redon Bruka e shikonte Tiranën e tij jashtë asaj ëndrrë. Ja ku ishin ata qytetarët, nëpunësit, arsimtarët, oficerët, ata akademikët e profesorët, ja ku janë edhe vetë piktorët, pronarët e kësaj Galerie të Artit, pinë birrë e në qetësi shohin atë vrasje, atë masakër që kryet para syve të tyre mbi trupin e lisit të vjetër. Ja, ku janë këta...

- Botë e vdekur... - foli ndër dhëmbë Redon Bruka.

Njeriu më indiferent ndaj projektit ishte poeti Korab Gruda. Ziosh, ashtu si skepticizmi i tij, ai nuk besonte se zotat e Tempullit do ta pranonin ndërtimin e banjave moderne në selinë e tyre. Shoku i tij i mirë, arkitekti Redon Bruka, ishte naiv. Në kohë të moçme arkitektët vërtetë që kanë pasur fat. Ata kanë takuar një faraon, apo një mbret që u ka dhënë mundësi të ngrejne tempuj me frymëmarrje diellore. Po ku koha jonë! Tani është ndryshe... Zotat tanë nuk i trand aq mendimi i vdekjes e i përjetësisë. Ata duan vetëm të jetojnë, të jetojnë për vete e brenda kënaqësisë

grykëse të tyre. Ata i kanë prerë lidhjet e tjera dhe kjo është fatkeqësia jonë. Zotat e Tempullit tonë, ata janë të mishtë e të përjetshëm.

Redon Bruka bëri mirë që u projektoi të paktën një nevojtores për jashtëqitjet e tyre, por Tempulli s'ka për të pranuar dhe arkitekti i ri nuk është as vetë i ndërgjegjshëm për atë që kërkon. Disa herë poeti ia ka lënë mikut të vet që ta kuptojë fundin e të përgatitet, por nuk ia ka prerë çdo shpresë. Dëshpërimi ka edhe ai ligjet e veta, është më mirë kur ti e merr pak e nga pak, si me pikatore; nuk e dëmton përnjëherësh zemrën. Dhe ti je me fat nëse jeta ta jep kështu.

Korab Gruda kishte pyetur Afërdita Tokaj, por ajo i kishte thënë se Mira Vogli nuk zbërthehej.

- Ajo di shumë gjëra, se nga i merr vesh e di vetëm ajo. Por nuk zbërthehet...

- Zbërtheje, - kishte ngulmuar Korab Gruda.

- Nuk zbërthehet kurva, - kishte thënë Afërdita Tokaj.

Mira Vogli heshtte. Përgjonte çfarë thoshte Afërdita Tokaj, pyeste me shikimet zhbiruese dhe herë pas here hidhte nga një romuz mbi nevojtoreset moderne që dashkan të qytetërojnë botën tonë. Pastaj mbyllej në vete si një iriq me gjemba që s'ke nga ta kapësh. E shkurtër, e imët, ajo kishte një fytyrë të murgët dhe një shtat përherë në lëvizje që derdhte energji të pashtershme. Ishte një nyje ajo nga ato të racës sonë shqiptare, e cila trashëgohet prej kohe shumë të largëta dhe sfilit gjeneratat e reja. Thoshin se Mira Voglit ia kishte frikën edhe vetë nëndrejtoresha e Shtëpisë Botuese, që kishte burrin me pozitë të lartë. Ku i gjente ato forca ajo femër? Hajde e gjeje në xhunglën e egër të mërisë, mllëfit e urrejtjes së botës sonë.

- Eh, ç' tha arkitekti? – pyeti Mira Vogli sapo Afërdita Tokaj u ul në tryezën e punës.

- Ku e di ti, unë tani sapo u ndava prej tij?

- Po unë prandaj po të pyes, a përrallisi gjë për ëndrra?

- Çfarë ëndrrash?

Afërdita Tokaj u drodh, kjo Mira Vogli ishte me të vërtetë e pacipë, ku i di ajo këto gjëra?

- Pse nuk është ëndërr projekti i tij për nevojtoret e Tempullit?

- Përse të jetë ëndërr? Pas gjysmë ore kur ti do të ngjitesh lart në banjat tona e do të shkarkohesh, në ëndërr do të jesh?

Mira Vogli po ngazëllehej brenda saj. Lëvizti provokuese kokën e mugët dhe mbërtheu fort buzët. Afërdita Tokaj po e humbiste durimin.

- Ua, - tha, - përse kjo gjuhë e papastër “kur të shkarkohesh...”. S'të kam dëgjuar tjetër herë të flasësh kështu, me sa duket edhe ti tani rron me ëndrrat e arkitektit. Jetoni... jetoni... nuk bëni keq, por mos shpresoni që me ëndrra do të vithisni Tempujt.

- Ç'është ajo “vithisje”? Shpifje, - foli e zemëruar Afërdita.

Mira Vogli uli kokën mbi tryezën e saj të punës, u shkëput nga tjetra e nisi të punojë fare e qetë. Afërdita hodhi shikimin nga redaktorja tjetër, po Suzana Miroshi ishte kruspullosur në vete, bënte sikur punonte dhe nuk ndihej se ishte aty.

- Hihe, - mendoj me vete Afërdita Tokaj, - vetëm hihe e asgjë tjetër.

Ajo doli prej zyrës. Trokiti në redaksinë e poezisë, por ishte mbyllur. Korab Gruda nuk ishte atje. Më mirë. Afërdita Tokaj ngjiti shkallët e shkoi drejt e në banjë. Edhe aty nevojtores turke, me një kovë uji pranë vëcësë, disi më të

pastra se të Tempullit, por përsëri të kapte një pështirosje e neveritshme. Ç'të bësh?

- Këtu do të dhjeç, - i foli vetes.

I shkoi mendja te Mira Vogli, tek ëndrra që ajo i përfoli.

- Shyqyr, - tha, - nuk e kishte për ëndrrën në gjumë të Redonit... Unë mendova se po fliste për atë... Ah, moj e mjerë, jo vetëm unë, por edhe ti, edhe fëmijët e ty gjithë jetën këtu do të dhjesin...

### III.

**N**ë Tempull zhurmën më të madhe e kishte bërë shërbyesja, sapo kishte dëgjuar se do të prisheshin nevojtoret e vjetra e do të ndërtoheshin banja të reja, Shega i kishte shkuar inspektores drejt e në zyrë.

- Ç'janë këto turpe që po dëgjojmë? Pse tani do ta mësojmë ne bythën të ulemi ndryshe? Me karrike alla evropiançe... Ato punë i dinë ata, evropianët, ne dimë punët tona.

Inspektorja e kishte përzënë nga zyra sepse i kishte ardhur komisioni financiar për kontroll. Kush ia kishte tani qejfin Shegës! Po shërbyesja topolake dhe e bëshme, me një fustan gjithë ngjyra të verdha e të kuqe, llërë përveshur, shkoi në klub, u ul në një tryezë e shtroi përpara shaminë e bukës. Nisi të hante mëngjesin me bukë të zezë e domate; e kënaqur, shikonte klientët përreth e nisi të flasë me zë të lartë:

- Ç'a po na dëgjojnë veshët! Turpe... Dashkan nevojtores tjetërsoj. Unë sot kur erdha në mëngjes, e di unë se si e gjeta vëcënë. Njerëz-zota, njerëz-zota, po e di Shega se si dhjesin

ata, as vrimën nuk e gjejnë dot ku të derdhen. Mori Shega pesë kova plot me ujë e vap e vap, që e pastroi. Një zot e di, që më pa. Dhe këta më kërkokan nevojtoe tjetërsoj.

Zëvendës-redaktori i gazetës "Dielli" buzëqeshi:

- Janë kohë të tjera këto, Shegë.

- Kohë të tjera... Pse, vallahi, a ka ndryshuar gjë dynjaja? Ditë dynjaja e natë dynjaja... Ka ndryshuar gjë dita, ka ndryshuar gjë nata? Pyesni Allahun e madh... Asgjë nuk ka ndryshuar.

- Po mirë ne, se jemi mësuar, po kur të vinë njerëz të huaj nga jashtë... Ata nuk janë mësuar si ne...

- Ne kështu jemi mësuar; gjersa ata vinë te ne, le të mësohen. Oh, e dinë ata, e dinë se ku do ta ulin bythën, kur i mbërthen nevoja... Banja moderne, me pasqyra, me ujë të ngrohtë, mos doni ju që Shega të mbajë erë livando?

Shërbëtorja e Tempullit përtypte mëngjesin me bukë të zezë e domate e fliste me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë të pranishmit. Dhe ata e dëgjonin e buzëqeshnin.

- Eh, s'është ndonjë hata, edhe ti do të mësohesh me erën e livandos.

Te cepi i klubit, i vetëm me një gotë të ngrohtë çaji përpara, qëndronte njeriu-zot i regjisë, njëri nga më të mëdhenjtë e Tempullit. I përherëshëm, i përjetshëm, i pashkatërruar si hija. Në Tempull ai ishte ngado e kudo. Me një borsalinë të re, gjyslykë të bardha të lara me ujë floriri, me një shikim zhbirues të ngulur, ai dëgjonte me vëmendje bisedat që bëheshin në klub. I nguli sytë Shegës dhe ndiqte çdo lëvizje të duarve të saja, llërët e fuqishme, nofullat, kapte nëpër ajër fjalët që lëshonte shërbyesja e Tempullit.

Njeriu-zot regji ishte i menduar.

Kohë më kohë ai e kishte biseduar çështjen edhe me të madhin e Tempullit. Tashmë ai projekt dhe arkitekti i ri, nuk ishin më çështje, tani ata ishin bërë një problem. Dhe problemi kishte dalë jashtë. Bisedohej ngado për banjat e Tempullit. Të dy kishin rënë në një mendje: nuk duhet shpejtuar, të presim e të dëgjojmë një herë se cili është mendimi i njerëzve, pastaj shohim e bëjmë. Të presim. Tani njeriu-zot regji ishte i menduar: edhe sa mund të pritej? Gjer ku mund të shkohet kështu? Kush hynte mirë në thelbin e fjalëve të asaj shërbëtoreje, e kuptonte se problemi nuk ishte aq i nevojtores, sa i gjithë Tempullit. Kërkohej një ripërtëritje e përgjithshme e Tempullit të vetëm të kulturës sonë. Përtej banjave, ishin vetë redaksitë, seksionet, kryesia, vetë njerëzit-zota, që tashmë janë stërplakur, janë rëgjuar dhe duhet të ndryshohen. Dhe kjo do të ishte e tmerrshme. Në zemrën e Tiranës do të ngrihej një tjetër Tempull, të tjera muza e pegasë do të hynin e dëlnin aty. Kush i kishte thënë këto mendime? Njeriu-zot regji qiti nga xhepi fletoren e vogël të shënimeve ku mbante ç'ishin thënë e ç'kishte dëgjuar.

- Kush i kishte folur ato mendime? Ah, poeti Korab Gruda... Ai... Kjo do të ishte e tmerrshme, vdekja e njerëzve-zota të Tempullit.

Megjithëse nuk besonte në asgjë, megjithëse thellë vetes ishte i bindur se zotat e Tempullit nuk do të lejonin kurrë rikonstruksionin e selisë së tyre, kohëve të fundit, Korab Gruda ishte bërë ithtari më i ndezur i projektit për banja moderne. Në kolektivin e Shtëpisë Botuese, kur Mira Vogli kishte hedhur romuze mbi ëndrrën e arkitektit, Korab Gruda i ishte përgjigjur cinik e fyes:



- Pse, a nuk nis gjithçka nga një ëndërr? Ty, jot ëmë a nuk të ka ëndërruar përpara se të të lindë? Domsdo që më parë jemi ëndrra, sigurisht që edhe lindjet edhe vdekjet e zotave prej ëndrrash janë. Të pyes ty, Mira Vogli, përse paske kaq frikë nga ëndrrat? Po, me të vërtetë raca e njerëzve si ti janë anti-ëndrra, ju jetoni duke vrarë e masakruar ëndrrat.

- Jo gjer këtu, - kishte thirrur zëvendës-drejtoresha e Shtëpisë Botuese, - mbylleni këtë bisedë.

- Ne mund ta mbyllim, por lufta është aty e gjallë dhe e egër, ai Tempull i shpirtrave të vdekur nuk duhet të ekzistojë më. Prej ëndrrave kanë ardhur tani të tjera kohë dhe ato nuk duan ta ulin më bythën mbi nevojtoret osmane.

E urtë dhe e përvuajtur nëndrejtoresha i kishte buzëqeshur Korab Grudës.

- Sot qenka dita e poetëve, - tha dikush nga dëgjuesit, - mos u dilni përpara sot, sepse pegasët u shtypin me thundrrat e tyre.

- Hyjnore! – klithi Korab Gruda dhe ai përplasi duart për fitoren. - Mos u dilni përpara pegasëve, - tha, - se u shtypin me thundrat e tyre hyjnore...

Kur kolektivi ishte shpërndarë, Korab Gruda e tërhoqi Afërdita Tokaj prej krahu:

- Unë jam betuar, nuk shkoj më në nevojtoret tona lart, do vete në Hotel Dajti, ti a do të vish? Atje, në banjat e Dajtit, njeriu e ndjen veten njeri.

Në bar të Hotel Dajtit e gjetën Redon Brukën të vetëm para filxhanit të kafesë, me cigaren e ndezur në dorë.

- Ç'paska ndodhur që sot na paske ndezur edhe një cigare? Ti nuk e pi, me sa di unë.

- Ah, ashtu kot...

Në të vërtetë, Redon Bruka bleu dy paketa cigare që t'ia jepte plakut të burgosur që punonte në kantierin e ndërtimeve të Shallvareve, por ai nuk dëshironte të bisedonte për këtë. U hap fjala për projektin e banjave të Tempullit dhe arkitekti i ri tha se ai kishte biseduar me njeriun-zot të pikturës dhe ky i kishte dhënë zemër.

- Duhet banja të tjera, - kishte thënë njeriu-zot i pikturës. Është e domosdoshme, madje jemi tepër vonë.

Pra, muza e muzikës dhe e pikturës ishin pro, veç, për fat të keq, kundërshtonte arkitektura vetë.

- Është e natyrshme, - foli Korab Gruda, - ju jeni specie të të njëjtit lloj dhe ju ndan vetëm kuptimi i gjërave. I dashuri im, është lufta brenda llojit. Ne i përdorim shpesh këto fjalë, duke anashkaluar me ndërgjegje thelbin e tyre, e ky thelb është tmerrësisht i pamëshirshëm.

Në këtë kohë, pranë tyre kaloi njeriu-zot regji, përshëndeti duke u përkulur pakëz e duke prekur me dorë borsalinën. Meqenëse këta nuk e ftuan në tryezën e tyre, ai shkoi më tutje e kërkoi një vend bosh, diku nga fundi i barit.

Korab Gruda ngriti flokët që i mbulonin ballin dhe vuri buzën në gaz:

- Përse më bëhet sikur së bashku me të lëviz edhe Tempulli ynë i shenjtë? Ku është ky njeri, është vetë Tempulli, ose hija e tij, apo më mirë e më drejtë, pushteti i fshehtë i Tempullit. Shpirti hije i regjisë është kudo e asgjekundi, si ajri, ai ndodhet edhe tek unë e më përthyen majën e penës kur shkruaj.

- Ky njeri? – pyeti Redon Bruka.

- Po, ja ky njeri... I frikshëm, i kudondodhshëm, ç'është, xhanëm, pushteti i tij?

Njeriu-regji lëmoi me dorë flokët e thinjur, pastaj nisi të fshijë me shami gjyslykët e veshura me avuj në atë ambient me dritë të pakët. Ai bëri porosinë dhe kur kamarieri u largua, mori në pëllëmbë fytyrën e tëholluar nga mosha, mbështeti bërrylat mbi tryezë dhe e nguli shikimin e vet mbi tre të rinjtë që po bisedonin. Tani ai nuk bënte asgjë. E dinte se ç'mendonin të rinjtë, çfarë bisedonin ata. Por, e kanë kot... Thundrat e pegasëve mund të trokonin nëpër ëndrrat e ca djaloshëve naivë, por jo mbi rrënojat e Tempullit tonë.

Mira Vogli, me sa duket, ia kishte çuar menjëherë bisedën që ishte zhvilluar në Shtëpinë Botuese. Njeriu Zot-regji e njihnte mirë poetin Korab Gruda.

#### IV.

Ështe përhapur fjala se të mëdhenjtë e Tempullit do të mblidheshin të martën në orën nëntë. Dikush pyeti përse të martën që është ditë ters, por dikush u përgjigj se në Tempull nuk shkojnë bestytnitë, e rëndësishme ishte që mbledhja të mbahej dhe më në fund të vendosej fati i nevojtoreve të Tempullit të zotave.

I pari arriti i madhi i Tempullit, zbriti nga vetura bojëshurrë, pa pritur që derën t'ia hapte shoferi. Kishte veshur një xhakëtë të re, që shkonte nga e kaltra, por fatkeqësisht ajo setër i rrinte si një rrobë e kthyer, e përdorur prej kohe dhe që rrobaqepësi plak ia kishte përshtatur trupit të tij të bëshëm e të rëndë. Shega, shërbëtorja vërejtë se sot ai kishte lidhur gravatë të re, të kuqe me vijëza të bardha. Edhe

këmisha e re, e bardhë. Kaloi para klubit pa hedhur sytë të shohë se kush ishte brenda dhe u ngjit ngadalë shkallëve.

I dyti ia behu njeriu-zot regji. Eci shpejt duke baritur ndën pardesynë e gjatë dhe duke shkuar përherë ndanë mureve, me çantën në dorë kaloi para derës së klubit, përshëndeti me borsalinë. Nuk i erdhi mirë që kishte aq tepër klientë brenda. Te shkallët ndaloj hapin dhe u nis të ngjitet i menduar e i fundosur në vete. Sa më tepër i afrohej zyrës së kryetarit, aq më shumë e ndjente rëndesën e vetes.

I treti arriti njeriu-zot i valleve. Me një kokë që i lëkundej sa andej-këndej, flokëkuq, i padrojtshëm e i pafrikshëm, ai hyri në klub me duart në xhepat e pantallonave e tha:

- Paskeni ardhur? - dhe u përgjigj vet – mirë keni bërë... Detyra juaj kjo është, të vini e të mësoni se çfarë do të vendoset... Qeshi përsëri e me duart në xhepa u ngjit lartë. Ky njeri nuk besonte kurrë se shkallët ku shkelte tani mund të rrëzoheshin ndonjëherë e ai mund të binte. Ai e dinte se vetëm kjo nuk mund të ndodhte asnjëherë.

Pastaj erdhën me radhë anëtarët e tjerë të kryesisë, gjithsej nëntë, një numër i vjetër i shenjtë. Dikush që i kishte numëruar, tha se mungonte e vetmja femër, muza e elegjisë, por kjo nuk kishte ndonjë rëndësi.

Mbledhja mbahej përreth një tryeze të madhe të rrumbullakët. Në krye qëndronte i madhi i Tempullit e në të dy anët kishin zënë vend, në të djathtë zoti i regjisë e në të majtë ai i pikurës. Të gjithë i dinin vetë vendet e tyre. I madhi i Tempullit e hapi mbledhjen:

- Siç e dini, - tha ai, - jemi mbledhur për të vendosur nëse edhe Tempulli ynë do të bëhet me banja evropiane, si thonë, apo do të mbajmë këto që kemi. Në fillim ne nuk i dhamë

ndonjë rëndësi kësaj çështjeje, por problemi doli se nuk paska qenë aq i thjeshtë. Ju e dini se jashtë të gjithë janë bërë sy e veshë dhe duan të dinë se ç'do të vendoset sot këtu. Unë mendova që ta shkruaj fjalën time, por pastaj vendosa se nuk është e nevojshme. Për të botuar vendimin tonë në gazetë kemi kohë, por më parë të dëgjojmë një herë se ç'mendojnë njerëzit-zota. Mos harroni se ata atje poshtë në klub kanë ardhur qysh herët, por gjithë natën kanë ndenjur pa gjumë dhe presin se ç'do të vendoset këtu.

Sapo i madhi i Tempullit e mbaroi fjalën e hapjes, dikush shpejtoi të korrektojë:

- Ata atje poshtë presin jo vendimin tonë, por verdiktin tonë...

- Është e vërtetë, - tha i madhi i Tempullit, tani me zë të lodhur, - ata njerëz presin prej nesh verdiktin, sepse nëpërmjet nesh ata flasin me perënditë e tyre.

Njeriu-zot i pikturës, i shkurtër e me sy të lëvizshëm e të përvuajtur, si të një kulishi të rrahur, lëshoi një zë të shndritshëm:

- Nuk duhet të humbasim sensin, - tha ai, - kohët kanë ndryshuar shumë.

- Edhe kjo është e vërtetë...

Dhe i madhi i Tempullit u shtriq fundosës në kolltuk, ai u krodh në vete dhe ua la fjalën të tjerëve. Ashtu e kishte zakon përherë, tani të gjithë ishin të lirë të thonin mendimin e tyre. Në Tempull ka demokraci të plotë.

Piktura tha prapë:

- Unë përherë jam ngazëlyer përpara arkitekturës së një bulkthi. Çfarë linja elegante e delikate, çfarë durim prej krijuesi është dashur dhe çfarë rrezëllime dritash ka në arkitekturën

e asaj krande. Ne duhet ta përshëndesim arkitektin e ri që na tha se edhe ne duhet të ndryshojmë. Ai guxoi... dhe ne duhet të guxojmë e të lëvizim përpara... Ç'të keqe ka këtu?

Ra një heshtje e gjatë, e menduar dhe fundosëse. E mori fjalën njeriu-zot i arkitekturës:

- Ne nuk jemi bulkthe, - tha ai, - që këndojnë natën. Ne jemi ata që jemi, - dhe ai vëzhgoi të tjerët me një vështrim të rëndë e kërcënues. - Hyjnorët jemi ne, - tha ai.

Dhe e ndërpreu fjalën e tij. Priti mos fliste ndonjë tjetër, por askush nuk guxoi. Ahere ai mvrenjti shikimin e vet mbi ata dhe zëri i tij u bë i ftohtë dhe i trunçtë.

- Ky popull nuk ka ardhur gjer këtu vetë, gjer në kohën tonë atë e kemi sjellë ne. Dhe ne do ta çojmë më tej. As nevojtoret tona dhe as banjat e Evropës, nuk janë shpikur sot. Por ne me këto tonat kemi jetuar, kështu jemi mësuar, dhe kështu duam të jetojmë. Të tjerat, pavarësisht se ç'thonë, janë vdekja e Tempullit tonë.

Fjala "vdekje" i akulloi të gjithë, shumëkush u drodh sikur vdekja t'i ishte afruar vërtetë pranë dhe t'i kishte drejtuar kthetrat e veta drejt tij. Askush nuk guxonte më të fliste. Dikush hodhi sytë nga regjia, por ky qëndronte i heshtur dhe i patrandshëm në vendin e vet. Qëndrimi i tij sikur thoshte: unë këtu jam, por me ju nuk kam punë, ju bëni punën tuaj.

Atëherë e mori fjalën njeriu-zot poezia.

- Si është e mundur arkitektura të mos e pranojë... Pse të mos e themi? Vetë Tempulli ynë duhet të ndryshojë. More, po cilët jemi ne, kush na ka sjellë këtu dhe kush na mban të lidhur pas këtyre shkëmbinjve? Dhe ai goditi me grush poltronin ku ishte ulur. Kush më ka lidhur mua pas këtij shkëmbi?

Sytë e poetit vërviteshin nëpër sallë, kërkonte të shihte më tej, por shikimi i tij ndërpritej nga muret.

- Jemi të verbër, - klithi poeti.

- Nga gjithë juve këtu, unë kam ardhur në Tempull duke vallëzuar... Ky që foli tani ishte njeriu-zot i valles. Sytë e tij të kaftë kalonin nga njëri tek tjetri me një dritë të lehtë ironie. Po të jetë për valle, vallet di t'i heq unë... Por ju mos i dridhni vithet, sepse të dredhësh vithet tani është shumë e rrezikshme. Asgjë nuk duhet të ndryshojë në Tempullin tonë të shenjtë.

Dhe shikimi i tij erdhi e u shua te zoti regji. Por ky vazhdonte të qëndronte i ftohtë dhe i largët, i pazbërthyeshem për të tjerët.

- E keni gabim, e keni gabim, e keni gabim... - ishte zëri i ëmbël, njerëzor i muzikës. Ai sikur në çast po sajonte një melodi flurore, të panjohur gjer atëherë. Ç'i jepni kaq rëndësi vetes, o njerëz-zota? Koha rrjedh edhe brenda jush, kot e keni, nuk jeni më ata të parët. Është e vërtetë që njerëzit u kanë akoma frikë, por nuk është më droja e dikurshme. Është një diçka tjetër. Ata kanë frikë, sepse akoma nuk kanë vendosur ta përmbysin Tempullin tonë. Bëjini ndryshimet sa më shpejt, sepse kur të vendosin ata, do të jetë vonë.

U ndje një si shpërthim në ajër, shumëkush u lëkund në kolltukun e vet dhe dy zëra njëherësh klithën:

- E shihni, e shihni? Duan të shembin vetë Tempullin!

Atëherë njeriu-zot regji u dëgjua të flasë me një zë si të përtejdhëu:

- Mos harroni se Shqipëria pjell përherë në pleqëri... dhe për fat të keq pjell dështakë.

Më shumë të hutuar se të frikësuar, ata po shikonin me sy të çakërdisur njëri-tjetrin.

- Ju të gjithë jeni të ndërgjegjshëm për atë që kërkohet, por të gjithë bëni sikur nuk dini gjë... erdhi përsëri zëri si përtejdeu.

Atëherë i madhi i Tempullit, me kokën të këputur mbi gjoks, foli sikur t'i drejtohej më shumë zemrës së vet.

- Çfarë ishte për t'u thënë, u tha. Ta hedhim në votë.

E hodhën në votë: tre pro e gjashtë kundër. Shumica ishte që nevojtoret e Tempullit hyjnor të mos prisheshin. Projekti për rikonstruksionin e tyre u hodh poshtë.

- Vullneti i shumicës fiton, - tha i madhi i Tempullit. – Mbledhja mbyllet.

Në korridor, njeriu-zot i arkitekturës i hodhi dorën në sup Shegës duke e përqaftuar:

- Vazhdo punën tënde dhe nxirre bukën e përditshme të gojës.

Në klub kur dëgjuan për vendimin, dikush thirri me zë të lartë:

- Punë muti!

Çuditërisht Redon Bruka nuk dha asnjë shenjë tronditjeje. Sapo e takoi në rrugë Afërdita Tokaj i dha e para lajmin, por arkitekti mbeti i ftohtë e mospërfillës. Vetëm kur ajo nisi t'i rrëfente fill e për pe se ç'ishte thënë e ç'ishte folur në mbledhjen e njerëzve-zota, Redon Bruka kishte qeshur me të madhe, kishte përplasur shuplakat siç e kishte zakon dhe i gëzuar e kishte përqaftuar Afërditën në sytë e kalimtarëve.

- Po pse? – kishte pyetur vajza e hutuar.

- Sepse ti je e mirë, - kishte thënë arkitekti i ri dhe e kishte lënë të vetme e të hutuar atje në mes të bulevardit.



Kur kishte mbaruar mbledhja, i madhi i Tempullit kishte zbritur në klub së bashku me njeriun-zot të pikturës. Qëllimisht kishin shkuar andej nga fundi, si në një gjysmëerrësirë dhe kishin nisur të pinë verë. Atëherë, në bisedë e sipër, i madhi i Tempullit i kishte thënë njeriut-zot të pikturës:

- Unë e di që ju kishit të drejtë, por si t'ua bëj atyre të tjerëve? Ju e patë që regjia vetëm përgjonte, ai pret vetëm një gabimin tim, kurse ai buthëtulja, valltari, është gati të më përpijë në çdo çast. Ju keni të drejtë, por unë s'mund të isha me ju.

Dhe i madhi i Tempullit kishte qarë me lotë të vërtetë, duke i rënë kokës me shuplakat e tij të voçkëla e të brumta. Atëherë kishte nisur të qajë edhe njeriu-zot i pikturës.

- S'di nga t'ia mbajë i Biri i Njeriut! Jo në dy degë ulliri, në udhëkryqin e madh të jetës është kryqëzuar i Biri i Njeriut.

Nga sytë e tij, si nga sytë e një kulishi të rrahur, rridhnin lotë të vërtetë.


Redon Bruka pa orën e dorës, ishte nëntë e gjysmë e mbrëmjes. Ngado ishte shtruar nata dhe ai u nis për në kantierin e Shallvareve ku punonte. Atje, anës një zjarri të ndezur me dërrasa të skelave, plaku i burgosur po ngrohej. Edhe polici që bënte roje kishte ardhur aty ndanë zjarrit. Redon Bruka u përfal: "Mirëmbërëma!", u ul ndanë zjarrit dhe i dha të burgosurit paketën e cigareve. Plaku e falënderoi, i dha një cigare policit dhe ata e ndezën. Të heshtur të gjithë. Gjithëkush përcillte me sy në qiell ecjen e asaj nate tiranase. Pikërisht në çastin kur një yll shkëputës kaloi nëpër qiell, Redon Bruka ndjeu maturanten e tij ta kapi prej krahu. Ai

shkundi kryet, lëvizi prej vendi, por nuk po i shpëtonte dot asaj dore. Maturantja i thoshte përsëri se ajo vazhdonte ta dashuronte dhe dëshironte të martohej me të. Por Redoni nuk dëshironte të kalonte më para Galerisë së Arteve. Jo, thoshte ai, atje nuk është më Orakulli ynë, lirin e moçëm që na përshëndeste çdo mëngjes e kanë vrrarë. Redon Bruka nuk donte të kalonte më as nga Tempulli i njerëzve-zota.

- Arkitekt, çfarë, nuk ndiheni mirë? – pyeti polici që dëgjonte përçartjen e Redon Brukës.

- Është i lodhur, - tha i burgosuri plak. – Fli, se gjumi të bën mirë. Babai im i gjorë thoshte që gjumi është shok i vdekjes.

*19 shtator 2000*



# Aksinja e Holtës

**D**etëm kur këmba shkeli mbi gurin e parë të kalldrëmit, unë frymëmora i lehtësuar; më në fund po hyja në fshatin Holtë.

Të parin që takova ishte një plakë që duke murmuritur me vete po ndizte kandilin te dera e shtëpisë. E përshëndeta si një i huaj dhe e pyeta për shkollën.

- Shko më tutje, - tha plaka.

E përpjeta e malit mbaronte aty dhe një kthesë më nxori në lëndinën ku nëpër muzg nisën të ndizeshin ca dritëza të zbehta. Nga larg dëgjova një lehje qeni, që më solli shpirtin në vend. Hija e një kalimtari më përshëndeti mikpritëse. E pyeta për shkollën. Fshatari i padukshëm tha:

- Shko më tutje...

Këmba më rrëshkiti mbi shtufin shkëmbor dhe unë bëra kujdes, sepse aty buzë udhës së panjohur, mund të ishte ndonjë greminë e rrezikshme. Tani ecja nëpër errësirë kur dëgjova ca kukurisje grash që po afroheshin, po qeshnin duke folur me zëra të ulët e të ngrohtë. Sapo ndjenë praninë time gratë heshtën. I pyeta për shkollën dhe njëra prej tyre tha:

- Ja, se po ju çoj unë.

Hija e gruas u shkëput nga të tjerat e u nis përpara.

Çapitesha i heshtur prapa asaj hijeje duke ndjerë në fytyrë errësirën që aty ishte më e mpiksuar dhe e lagësht. Fola me zë që të dëgjohesha: “Ç’gomar që jam, ç’m’u desh mua kjo histori...”, por gruaja që dëgjoi nuk u përgjigj. Fatmirësisht shkolla nuk kishte qenë shumë larg, fshatarja u ndal te dera e oborrit me tela dhe pasi foli “natën e mirë” u largua. Në mes të oborrit unë thirra. Zërit që pyeti nga brenda iu përgjigja se kërkoja mësuesin Zamir Milori. Te pragu i derës së shkollës, me llambën në dorë, u duk njeriu, ngriti lart dritën e tha:

- Mësues Zamiri nuk është këtu, ka rënë poshtë në qytet.  
- Kur e pa që nuk po luaja vendit, tha: - Eja brenda.

Ishte roja i shkollës, Ago Arëza, vendas nga Holta. Duke kaluar nëpër korridorin e ngushtë shihja shpërbërjen e hijes së tij dhe atë dritë të luhatshme që ecte. Numërova tre dyer të mbyllura, padyshim klasat e nxënësve. Në fund të korridorit përballë ishte dera e katërt. Roja e çeli dhe shkoi e la llambën mbi tryezë pranë një shtrati, pastaj u kthye te soba prej teneqeje në mes të dhomës. Duke i futur dru ai pyeti:

- Do fleç sonte këtu?

- Shpresoja të gjeja Zamirin, por ai nuk qenka. Në Holtë nuk kam qenë herë tjetër.

- Mësues Zamiri është në qytet, - përsëriti roja, tani duke u kthyer nga unë. - Kanë një mbledhje. Po ulu, - dhe më tregoi me gisht një karrige pranë shtratit.

Unë shkova e u ula te shtrati. Edhe roja i shkollës u ul në karrigen e tij pranë sobës.

- Nga ju kemi? - pyeti tani si zot shtëpie, hijerëndë duke hapur anash të dy këmbët.

- Nga Tirana.

- Ah, nga Tirana.

Po vështroja me kujdes atë krijesë fshatare, një burrë nja 42-vjeçar, një qafë muskuloze e gjatë, një kokë inatçore dhe e mishtë nga ato që ndihen mirë nën qylafin e bardhë. Ago Arëza kishte një shikim të mbyllur e të rrëzuar, tinzar, një palë mustaqe tashmë të hirta. Më peshoi me shikimin e tij e pyeti përsëri:

- Domethënë, qenke shoku i mësuesit.

- Po, - fola unë.

- Kush të sollli gjer këtu?

- Një fshatare.

- Një fshatare nga tonat? – pyeti vrulltas, por në çast e përmbajti veten. – Një fshatare... - foli pastaj me veten, - janë të forta këto tonat.

Nuk e kuptova se çfarë donte të thoshte ashtu. Isha i lodhur e i shushatuar prej atij udhëtimit të gjatë dhe të frikshëm që kisha bërë, me një vendim si prej të marri. Isha nisur pa e lajmëruar Zamirin dhe pastaj në stacionin e fundit të autobuzit, në Shënepremte, u nisa vetëm pa një shoqërues nëpër atë udhë të panjohur e të frikshme malore. Ishte një fat që kisha shpëtuar pa rënë në ndonjë greminë apo që s'kisha takuar ujgër në atë zemër dimri.

- Nuk udhëtohet vetëm nëpër këto anë, - tha Ago Arëza.

- Po, përse na paske urdhëruar gjer këtu?

- Ndofta mund të shkruaj diçka, ndonjë dokumentar për fshatin tuaj. Me sa di unë, gjer më sot, asgjë nuk është filmuar këtu.

- Cëc... – ia bëri Ago Arëza me qiellzë, - cëc... cëc... – dhe akrepi i mustaqeve i lëvizi. – Gazetar domethënë... shoku i mësuesit tonë... domethënë...

- Po, - thashë unë.

- Ja ku është dollapi, - ai tregoi me gisht te cepi i odës. - Ke ca bukë e ca djathë. Unë po shkoj ta mbush me ujë të freskët kotruven.

Erdhi pranë e mori nën krevat një kotruve të vogël. Me të në dorë, me një hap të përtuar doli jashtë. Unë mbeta i vetëm në atë dhomë të zhveshur, fare të varfër të mësuesve të fshatit. Një shtrat i druritë dërrasash me këmbale të larta, një dyshek, dy përkresa dhe dy velenxa leshi. Të paktën paskam me se të mbulohem sonte. Te kryet e krevatit një tryezë e vogël, pjata, një gotë uji, tre pirunj, tre lugë, tre thika. Në të dy anët, pirgje me libra. Një qiri gati përgjysmë i djegur. Nuk e di përse e mora qiririn ndër duar, preka fitilin sikur t'i falesha e t'i lutesha dritës së tij.

Ago Arëza u kthye duke shkelur me atë çapin e ngathët e të ngeshëm të malësorëve. Kotruven e la gati te këmbët e mia. Qëndroi edhe vetë në këmbë.

- Domethënë ajo fshatarja të sollti natën gjer këtu, - pyeti tani më shumë i rënduar në vete.

- Po, - u përgjigja pa e fshehur bezdinë për ato pyetje.

Në erë u tund qylafi i Ago Arëzës dhe ai shkoi e u ul te karrikja pranë sobës, tani e nxehur mirë. Dëgjoheshin kërcitjet e kuckave në zjarr dhe unë sikur ndjeva edhe erën e shajakeve të fshatarit që avullonin në dhomë; apo ndofta ashtu m'u bë.

Një heshtje e gjatë, fundosëse. Ago Arëza u mendua një copë herë, u përthye përpara në karrige dhe foli ngadalë:

- Të shkruhet edhe për fshatin tonë... Nuk e ke menduar keq, edhe këtu rrojnë njerëz... pse jo?

- Sa shtëpi ka Holta?

- Nja 50 dyer.

- Me se merren?

- Bagëti, kemi bagëti... kemi mullirin e blojës, hidrocentralin e fshatit mbi lum, baxhon, shesim në shtet lëkurët e bagëtive... - Ndenji pak... - Është kafeneja... dega e policisë. - Po përshkruante fshatin kur e ndërpreu bisedën, u çua në këmbë dhe tha: - Ja përse ta presin hundën në Holtë...

Në fillim nuk e kapa, po m'u bë një si kërcëllim dhëmballësh që xifloi ajrin. Pashë fytyrën e ngrysur të Ago Arëzës.

- Si ta presin hundën? – pyeta me zë të hutuar e të frikur.

Ai tha:

- Sonte që erdhe ti, unë po shkoj nga fëmija, në shtëpi. Nesër takohemi. Hajt, natën e mirë...

U nis të dilte, kur u kthye:

- Në dollap ke bukë, mos fli pa ngrënë...

U largua duke marrë nëpër këmbë terrin e hutuar të asaj nate të ngatërruar me dritën e drojtur të llambës së vajgurit.

Zamiri më fliste shpesh i trishtuar për Holtën. Ishim njohur rastësisht në ditëlindjen e një shokut tonë dhe gjithçka midis nesh tani rridhte e rastësishme: takimet, miqësia, ndonjë grimcë jete. Një fytyrë e bardhë e hequr, vetullzi me një zgjatje të dhëmbit katrosh në nofullën e sipërme. Një herë ai më tha:

- Holta është vetdënuar në vet'harrimin e saj.

Dëshpërimi i një mësuesi fshati, i zënë si një zog në grackën e vet. Këta mësues janë më të keqtrajtuarit, më të braktisurit, pa të ardhme. Ndoshta prandaj më lindi mendimi të shkruaja e të filmoja diçka për Holtën, por jo për jetën e mësuesit të fshatit. Kushedi ndonjë temë tjetër... Tani unë jam në dhomën e mësues Zamirit. Këtu e kalon kohën ai,



mësuesi i fshatit tonë. Ky shtrat i drurtë, kotruvja te këmbët e mia, ajo sobë teneqeje, ajo tryezë e vogël pranë shtratit... Zgjata dorën e mora një libër: "Ditari i Ana Frankut". Një libër i vogël, i botuar keq si shumë libra tek ne. E kisha lexuar dhe zëri i Anës sikur zgjoi diçka të dhimbshme, të pandarë prej meje. Një dhimbje e vjetër që më trishtonte më tepër në atë dhomë të vetmuar. E lashë librin me kujdes në vendin e vet e mora një tjetër: "Jul Qezari". Biblioteka e vogël e një mësuesi fshati "Antologjia e poezisë shqipe". Nuk vazhdova më tej, isha i lodhur e i hutuar; ç'mund të bëjë një mësues i varfër në këto malet tona... Më pushtoi një dëshpërim prej të cilit dëshiroja të shkëputesha, të mendoja diçka tjetër, të lehtë e të hareshme, por nuk mundesha dot. Më iku edhe Ago Arëza, roja përfitoi nga ardhja ime dhe u largua për në shtëpinë e vet. S'ke ç'i bën, duhet ta kaloj natën i vetëm sonte këtu e nesër të çohem herët e të mendoj se çfarë mund të bëj.

Të nesërmen u habita kur pashë se shkolla ishte ngritur në një shesh të vogël, të qetë e të mbrojtur nga era e maleve. Udha kryesore kalonte pranë dhe qendra e fshatit nuk duhej të ishte larg. I lodhur e i trembur mbrëmë, me sa duket, i kisha zmadhuar largësitë, ndërsa në të vërtetë ato ishin më të vogla e lehtësisht më të përshkrueshme. Fshati ngrihej përreth një kodre dhe shtëpitë nisën të zbardhin njëra pranë tjetrës, përtej atyre shtriheshin vargmalet e kaltër në gri të errët.

Ajo xhade e po ajo kthesë që unë kisha përshkuar mbrëmë; ja edhe vendi ku takova ato gratë që bisedonin nëpër terrin e natës. Në mendjen time e shkunda perden e asaj nate e i

dëgjova sërish me vëmendje ato zëra: ishin të dashuruar? Mundet, pse jo? Veç sa hapësirë mund të ketë dashuria këtu, kafsha apo njeriu? Ulkonja është pjella e rropatur e kësaj bote të largët e të pikëlluar malore, ndërsa njeriu... U kujtova se sot është e dielë dhe u ndala në mesin e udhës. Mbrëmë ato gra ishin të ngrohta e gurgulluese, sepse sot do të ishte një ditë e diel, një ditë kremtërore. Njeriu kishte krijuar edhe aty të dielën e vet.

Shumica e këtyre fshatrave ngrihen përreth një burimi e përreth një rrapit shekullor; pikërisht ashtu përreth çezmës e rrapit të gjelbër është ndërtuar edhe Holta. Kalova ndërtesën e vogël të postës, pastaj një shtëpi fshati e rrethuar me gardh guri brenda të cilit shihej koçeku i misrit dhe një mullar lëpushkash. Të tjera shtëpi, dhe gati prapa çdo dere nga një qen i lidhur. Ja, edhe kafeneja e fshatit, brenda kishte klientë. U ktheva aty. Përshëndeta e u drejtova për te një tryezë e veçuar, kur dëgjova:

- Eja këtu...

Ishte Ago Arëza, ai me atë shikimin e tij të ftohtë e përgjues, me ato mustaqe si një akrep i hirtë. Dukej që mustaqet i mbante për qejfin e burrit. Kishte veshur një këmishë të bardhë me kopsa të bardha të mëdha, dhe një xhaketë të zezë të shajaktë të re. Pranë tij dy malësorë të tjerë.

- Si fjete mbrëmë? – pyeti, sapo zura karrigen time.

- Mirë, mirë...

- Ishe i lodhur mbrëmë, - tha prapë ai.

- Shumë i lodhur.

Dy të tjerëve u erdhi mirë që shkova e u ula në tryezën e tyre. Më qortuan që mbrëmë isha nisur i vetëm nëpër ato

vende të largëta e të rrezikshme; pse nuk e kisha paralajmëruar edhe mësues Zamirin. E pranova gabimin tim e fshatarëve u erdhi mirë.

- Holta është tjetërsoj, - thanë gati të dy me një zë.

Porositën një kafe për mua dhe kafexhiu e solli sakaq. Lokali po mbushej me klientët e vet të përherëshëm, fshatarë që e njihnin sho-shoqin. Shikimet e tyre binin mbi mua:

· - Ah, paskemi edhe një mik të ri nga qyteti.

Flisnin me zë të lartë që të dëgjoheshin. Në tryezën tonë, fatmirësisht, ishin njerëz të heshtur. Unë vëzhgoja Ago Arëzën, më tërhiqte sidomos ajo qafë e gjatë e muskuloze burri të fuqishëm, ajo cipëz e bardhë e fytyrës që unë e lidhja më tepër me ushqimin e bulmetit, si ushqim të parë të tyre. Kishte një trup mesatar e të lidhur, këmbët të përthyera nga hipjet e zbritjet e përherëshme malore. Një krijesë e stërralltë e këtyre anëve. Shikimi i tij ishte i ftohtë dhe i pingultë, këtij njeriu s'mund t'i besojë, duhej kujdes kur i afroheshe kësaj genieje. Sytë e zes e shikimi gati i mbyllur, të kërcënonin e të detyronin të ruheshe prej tij.

- Ç'kemi andej nga kryeqyteti? – pyeti njëri.

Ishte Velo Shtërgu. E dëgjova dhe heshta. Ç'mund të flisja për kryeqytetin aty? Ata e ndjenë shkëputjen time dhe atëherë ai tjetri, që quhej Vezir Alushi, tha:

- Politika, ç'bën politika?

- Politika?

Përsëri: ç'mund të thosha për politikën aty? Pastaj, se mos në Tiranë merrte gjë vesh njeriu nga politika. Mbyllja ime nuk u pëlqeu fare fshatarëve, prandaj Velo Shtërgu tha:

- Pardje në "Zërin e Popullit" kishin kritikuar Shollohovin "Donin e qetë".

E uli zërin dhe u afrua nga unë:

- Ti, si mendon ti?

- Ah, po...

- E paskan kritikuar edhe atë!

- Po... po...

Këta mjeranë ç'merren me këto gjëra, mendova unë, ç'u duhet këtyre Revolucioni Kulturor Kinez, kur rrojnë në një revolucion të përhershëm mjerimi këtu në një uri si të ulkonjës së dimrit? Pse nuk shohin hallet e tyre këta njerëz, po enden tani me mendje gjer në Pekin? O zot, edhe mjerimet e kinezëve na duhen për hise...

- Miku nuk do të flasë, - tha Velo Shtërgu fare shlrshëm dhe vazhdoi bisedën me Ago Arëzën: a i prure lëkurët e deleve?

- I pruri dje, - u përgjigj Vezir Alushi.

Zëri i Vezir Alushit ishte disi i habitshëm, një tingull që më tepër kërkonte të fshihej, ai vinte gjer tek ty, po pikërisht atëherë humbte nga pesha e vet. Vezir Alushi nuk duhej të kishte më tepër se 35 vjet, një trup i vogël, i pakët, me një kokë të madhe në dukje, por po ta vëzhgoje mirë dilte se në të vërtetë ajo kokë ishte normale, veç e zmadhonte së tepërmi flokët e zezë, kaçurrela, ngritur lart. Kishte sy të mëdhenj e një fytyrë që mbaronte në një mjekër të imët, të mbledhur. Kokën e mbante përherë lart dhe shpatullat drejt duke rrëfyer kështu një njeri me peshë e me vlerë. Vezir Alushi dhe Velo Shtërgu punonin të dy në qendrën e grumbullimit të lëkurëve. Tani ata po flisnin pikërisht për grumbullimin e lëkurëve të deleve.

Më erdhi mirë që biseda mori atë drejtim.

Mendova të shkoj andej nga mulliri i fshatit për të dëgjuar zërat e ujrave, të cilët më joshin shumë, humbas e çlodhem në to. Përplasja shkumbuese e valëve nëpër shkëmbenj më bën shpesh të harroj vetveten. Tani, ne qytetarët të përcëlluar nëpër asfaltet afshëmbytës të rrugëve tona, vetëm në ndonjë varg popullor të vjetër i takojmë dashuritë e fshatareve të bukura me mullixhinjtë e përhitur me miell të bardhë, ndën trokun e përherëshëm gjumëndjellës të fletëve të mullirit. Diku një qen duke lehur vinte prapa meje dhe më kërcënonte, isha njeri i huaj aty. Kërciti një dritare e brenda saj nxori kokën një grua. Qëndroi aty gjersa unë u largova tutje, andej nga po më ndillte tanimë zhaurima e lumit.

Papritur u gjenda i mbështjellë nga mjegulla e lagësht, e dendur, varur në atë rrëzë mali e breg lumi. Ndjeva fytyrës bulëzat e ujit dhe më erdhi mirë, por s'mund të rrija dot aty, përshkova më tutje, andej nga buçitja e valëve vinte më kumbuese. Disa degë të shkurtra rrepesh më fshikën nëpër këmbë, pastaj u hap bregu i lumit, tashmë gjendesha nën një diell të shndritshëm, por të ftohtë të atij janari. Poshtë u duk mulliri dhe unë eca drejt tij duke kërkuar një vend shullë ku të prehesh. Më në fund një shtroherë dhe një shkëmb i verdhë shtufi ku mbështeta shpatullat.

I vetëm në atë qetësi çlodhëse të asaj natyre të ashpër, por të bukur malore, nisa të përgjoj zërat e ujit, furfullimën e erës që bridhte bregut, pastaj këngën e çoçrës nëpër ferra. Gjithçka imja nisi të zbërthehet, sikur të hidhje tej një nga një pjesët përbërëse të vetes, asgjë prej barrës së asaj krijese që e quajmë njeri s'më duhesh më, larg shoqërisë njerëzore, ç'më duhen mua këta Vezir Alushë e Ago Arëza, ç'mund të bëj unë tani për fatet e "Donit të qetë...", e ç'i duhen

Shqipërisë këto? Shqipëria do të bënte mirë sikur të shikonte pak veten, të shpinte ngërçin e saj. Mulliri punonte i lodhur e monoton, një fshatare kaloi në udhë me mushkën ngarkuar me drithë. Fshatarja me një thupër në dorë shkonte pas mushkës e ngutur; tek zbritja u ndal ca kohë e menduar, ndërsa kafsha shkoi e qëndroi vetë te dera e mullirit. Mullixhiu doli dhe hodhi shikimin përçark, priste fshataren, pastaj nisi të shkarkojë mushkën vetë. Atëherë zbriti poshtë edhe femra. Të dy hynë brenda në mulli.

Dashuria, mendova unë... Këtu malet e vendosin njerinë në një ngastër tokë, në një grimcë qielli, por shpirti i tij i burgosur ëndërron hapësira të tjera. Nuk ka më të trishtuar se sa malësori i burgosur brenda maleve të ashpra. E ndjen veten edhe të lirë, edhe brenda kafazit të ndërtuar nga zoti vetë.

M'u kujtua "hunda e prerë", për të cilën më foli Ago Arëza mbrëmë në shkollë. Tek ai njeri kishte një mllef të egër që i ziente përbrenda, por sigurisht që kishte përrallisur gjëra të paqena. Nuk kisha dëgjuar kurrë, asnjëherë, se në Shqipëri njerëzit mund të gjymtoheshin ashtu. Ndoshta në vendet e tjera të mesdheut po, por kurrë tek ne. Shqiptarët e kanë zakon "të mos e shëmtojnë njeriun" edhe në vdekje. Kaq herë, kur vrasësi u merr jetën, shqiptarët lutën: "mos më shëmto...". Ago Arëza kishte shpikur gjëra të paqena mbrëmë. Prita gjatë aty në breg të lumit me shpresën se fshatarja do të dilte më në fund prej mullirit dhe unë do të mund ta shikoja, a ishte e re dhe e bukur, apo aty vazhdonte një dashuri e pjekur dhe e vjetër... Kisha dëshirë të përgjoja sytë e saj, dhe nëse bebëza ishte plot dritë, atëherë gruaja ishte me të vërtetë e dashuruar.

Ago Arëza, pra, e kishte një armik vërtetë për vdekje në Holtë... Por, femrën e mbante të mbyllur asaj të diele të qetë në mulli dashuria, ndërsa mua më duhej të largohesha, unë kisha ardhur gjer aty për të njohur fshatin Holtë. Më duhej të largohesha patjetër prej andej.

Kafeneja gëlonte nga klientët, ishte me të vërtetë e dielë edhe në Holtë. Moti ishte i vranët, prej maleve vinte era e ftohtë dhe vetëm midis reve shndritte herë pas here dielli i janarit. Nga jashtë e kërkova me sy Ago Arëzën, por ai nuk ishte më në kafene. Diçka më largonte prej atij njeriu, por tashti ai më ishte më i njohuri në Holtë. Ballë kafenesë punonte berberana, më tepër një barakë e llamarintë ngritur ndënë degët e rrapit ndanë udhe. Hyra aty si më nge, hajt ma, po rruhem sot në fshat.

- Mirë (dita)... – fjala ime u thye e u këput në buzë.

Berberi e kishte hundën e prerë. Unë u tmerrova, ngriva atje te pragu i derës dhe s'po lëvizja dot më. Sikur po më mbylleshin sytë, të mos shihja asgjë. Në vend të hundës berberi kishte ngjitur një fashëz të bardhë. Ago Arëza mbrëmë më paskësh folur të vërtetën.

- Urdhëroni...

Dikush ulur në karrige pranë murit lëvizi e më dha shenjë: mund të ulesha atje.

Kërkova karrigen bosh dhe u ula me një tronditje fundosëse. Ishte e tmerrshme. Berberit të fshatit ia kishin prerë hundën dhe unë tani e kisha para syve të mi. Gërshërët punonin mbi kokën e një djaloshi flokëverdhtë, fytyrën e të cilit e shihja në pjesën e poshtme të pasqyrës së vendosur pranë murit përballë. Një pasqyrë e madhe për një qethore

të vogël fshati. Sigurisht e kishte blerë në qytet nga ndonjë familje borgjeze e vjetër. Brenda asaj pasqyre lëvizte edhe fytyra, më mirë koka me hundë të gjymtuar e berberit. Në një çast shikimet tona u poqën atje, po unë hodha sytë nëpër tavanin e llamarintë, soditja trarët sepse nuk dëshiroja të shikoja përsëri në pasqyrë, por ajo qëndronte para meje dhe djaloshi flokëverdhë, ngriti duart e me to shpupuloi flokët e qethur dhe u çua prej karriges. Ishte një fshatar i gjatë, sykaltër, me një qëndrim të rendë si gjithë meshkujt e kësaj ane. Përgjithësisht këta flasin pak, të peshojnë gjatë me sy dhe vetëm kur të qasin për mik, hapen me ty. Djaloshi lëshoi monedhën në dorë të berberit, tha “mirupafshim”, dhe doli.

Atëherë berberi m'u drejtua mua:

- Shoku gazetar?

Holta e kishte marrë vesh se unë, i huaji, kisha ardhur mbrëmë në fshat. Ago Arëza e kishte bërë detyrën e vet: “Ka ardhur gazetari nga Tirana, do të bëjnë një film edhe për fshatin tonë, pse të mos bëjnë? Edhe këtu njerëz rrojnë...”

- Mbrëmë erdhët? – pyeti përsëri berberi me mirësjellje, - Mbrëmë?

- Ah, po... mbrëmë...

Kapa nga larg, tepër larg, zërin e tij të lodhur e të fikur, por të qetë e të ngrohtë. Dhe guxova: e ngula shikimin mbi fytyrën e tij. Ai nuk u trondit, nisi të qethë fshatarin tjetër që u ul në karrigen para pasqyrës. Ky ishte një burrë i thyer në moshë, me flokë të thinjura të gjata gjer poshtë. “Shkurtomi”, foli me zë të kreshpëruar brenda gurmazit. Dhe ia nguli shikimin fytyrës së vet, aty në cepin e poshtëm të pasqyrës. Një fytyrë e prerë nga rrudhat, nga era e maleve, nga dielli



por edhe nga ushqimi i pakët. Kishte po ata sy gati të mbyllur e zhbirues të Ago Arëzës, dinak e të fshehur, ngulitës si një gozhdë. Edhe unë ia ngula shikimin tim, provokues e mospërfillës.

Fytyra e berberit kishte një bardhësi të zbehtë, të tejkyrshme si të një njeriu që ka lënguar gjatë. Fasha që i mbulonte hundën e prerë ishte e neveritshme dhe i arrinte gati tek dy sytë e mëdhenj, të rrethuar si prej avushe të errët qirinjsh të ikonave. Diku thellë ata sy ishin të qetë dhe lëshonin një dritë mirësie të përvuajtur. Ai buzëqeshi, edhe unë tani buzëqesha atje në pasqyrë, takoheshim aty në atë copë qelqi, të dy të mundur e të lodhur. Ai e kuptoi gjendjen time dhe përsëri buzëqeshi, edhe pse pakëz më çiltas, përsëri me drojtje e përlulësi. Për të bërë diçka unë u çova prej karriges dhe u afrova te pasqyra. Nisa të kundroj me vëmendje fotografitë e dy artisteve të prera, me sa duket, nga revista të huaja kinematografish. Si kishin arritur gjer aty në Holtë ato revista, një zot e di. Por karshi meje tani qëndronte një leshverdhë, me një lëvizje provokuese të kokës, ndofta për t'i shpëtuar cenit të lehtë të mjekrrës majuckë, tepër kockore. Ishte me të vërtetë një profil joshës femëror.

- Kush është kjo? - pyeta unë.

Berberi foli emrin e një artisteje spanjolle, që nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë. Megjithëse i afërt me kinemanë, unë vuaj nga mungesa e kulturës së emrave. Femra tjetër ishte një irlandeze, e ftohtë në shikimin e saj, por epshore e tunduese. Kërkoja të lexoja diçka nëpër sytë e ballin e asaj femre, që më qëndronte tani aq pranë.

- Po kjo këtu, kush është?

Berberi ngriti supet.

- Nuk e di, - tha.

- E bukur, ëh, qenia...

Ishte Ago Arëza. Kur ai kishte hyrë në qethore, unë s'e kisha vënë re. Tani ishte ulur pikërisht te karrigia pranë times, së bashku me Vezir Alushin. Qeshi e tregoi dhëmbët e tij të bardhë rruazë.

- E bukur, - thashë unë, dhe u ula tani në karrige.

- Mërgimin e kemi qejfli, - shpejtoi të flasë Ago Arëza, por fjalën e tij e ndërpreu Velo Shtërgu që sapo u duk te pragu i derës. - Nga u vonove? - e pyeti atë Ago Arëza.

- Juve u kërkoja, - tha Velo Shtërgu, - nga më humbët?

Sigurisht që më kishin ndjekur mua pas dhe kur kishin parë se kisha hyrë në berberanë, kishin vendosur të hynin edhe ata. M'u ngulit në kokë emri i berberit: Mërgim. Pikë e zezë, mendova me vete, nganjëherë me të vërtetë emri tregon edhe njeriun, fatin e tij. Nuk e kishin kot të vjetrit që nëpërmjet emrit kërkonin të parathonin edhe të ardhmen e njeriut. Mërgim... në vendin tënd, i mërguar... M'u dhimbs njeriu...

Romuzet e Ago Arëzës nuk e tronditën berberin, fytyra e tij mori një përskuqje të lehtë, por pastaj zbehtësia e bardhë përsëri sundoi tek ai njeri. Tashmë kishte kaluar nëpër ato prova, nëpër ato spica e thumba, të bashkëfshatarëve të vet, veçse gjersa unë isha aty, ishte diçka tjetër, sidoqoftë, isha një i huaj. Dhe ai foli qetë:

- Arti po e pëson, ëh? "Donin e qetë" e kritikuan...

E kishte fjalën te Revolucioni Kulturor që po zhvillohej atëherë në Shqipëri. Edhe ky si holtasit e tjerë. Unë ngrita supet, nuk dëshiroja ta ngisja atë bisedë, aq më tepër që aty nuk ishim vetëm. Veç, ishte e habitshme se si berberi i Holtës e gjeti atë shprehje: "Arti po e pëson...".

- Vështirë e kanë sot artistët...

Mërgim Berberi donte të bisedonte patjetër. Atëherë unë thashë:

- Arti vet e ka të vështirë... përherë e ka pasur të vështirë arti.

Ago Arëza me shokët e vet po dëgjonte me veshët pipëz. Nuk e di se sa kuptonin ata nga ajo bisedë e grimcuar, e koduar, që po zhvillohej tani në qethoren e Holtës.

- Arti e ka të vështirë, - thashë unë.

Mërgimi uli kryet e psherëtit.

- Po kjo është ndryshe, - tha i dëshpëruar.

- Është e vërtetë... ndryshe...

Mërgimi tha:

- Nuk është bukur...

- Çfarë nuk është bukur? – pyeta unë.

Tufa flokësh të hirtë të fshatarit që po qethej binin në dyshemenë e dërrastë, sikur të ishin bashka leshi dhie. Doli në pah një kokëz fare e vogël, e pambrojtur njerëzore; vetullat e trasha dhe mustaqet e kreshpëruara, që më parë i jepnin një hije të rëndë, tani e tregonin atë krijesë të dobët e qesharake. Dhe vërtetë dikush qeshi.

- Dreq, - tha ai, - ne e kishim frikë atë kokë, po na dilka që qenkemi trembur nga leshrat.

Fshatari që po qethej u prish në fytyrë, por nuk e dha veten.

- Këta jemi... – foli me zë gurmazi të mbytur nga pështyma.

U çua nga karrigia, pagoi berberin dhe duke dalë e përsëriti mendimin e tij.

- Më mirë që jemi këta që jemi...

Erdhi radha ime. U ula në karrige para pasqyrës dhe më tepër me shenjë e dorës, murmurita:

- Rruani... mjekrën...

Mbi hapësirën, ndën pasqyrë, gjithçka ishte vendosur me një përkujdesje prekëse: brisqet, dy makina qethëse (atëherë ishte e vështirë t'i gjeje), dy vazo të vogla me alkool, kutitë e pudrës, pecetat e bardha stivosur në kamaren përballë, gjithçka ishte në një rregull e pastërti që të bënte të heshtje, sidomos kur shihje pocaqinë e atyre fshatarëve. Holta ishte më e papastër nga fshatrat e tjerë, ngado baltë e bajga. Hetova me kujdes Mërgim Berberin, përparësen e gjatë gati gjer te këmbët, të bardhë e të hekurosur, këmishën bezh të kopsitur me kujdes, i gjatë, flokëzi, me boshtin kurrizor të lakuar përpara, imcak e të brishtë, si gjithë qenia e tij. I ngjante atyre drurëve të pyllit, të cilët të rritur ndën hijen e drurëve të fuqishëm e të lartë, mbeten përherë të pafuqishëm, të sëmurë, gjersa thahen e kalben. Ky njeri të tjerëve u ngjallte mëshirë, por çuditërisht për veten e vet ai nuk e kishte atë ndjenjë. Në qetësinë e tij ngulmuese, sikur u thoshte të gjithëve: unë jam këtu... Nisi të shkumbëzojë furçën e rojes në sapllakun e sapunit, gishtërinjtë e hollë punonin me një ritmikë të qetë, gjumëndjellëse. Mbylla sytë e dëgjoja atë trokimë të ëmbël, që më çonte s'di se ku, por përsëri gjendesha atje te bregu i atij lumi malor, të rrëmbyeshëm, ku fletët e valëve të mullirit më bënë të ëndërroja një dashuri të nderur fshatarake, nga ato që kishim dëgjuar kur ishim fëmijë. Përse zemrat njerëzore të jetojnë të ndara, kur ato janë krijuar që të takohen? Ndjeva pas meje dikë që foli:

- Vetëm huqin s'e harron dot, nuk e mund dot nepsin që ka...

- Është njeriu, - tha tjetri. - Është soji...

Po dëgjoja ata të dy që po flisnin tani për njeriun. Velo Shtërgu e Vezir Alushi, ata dy nëpunësit e Grumbullimit, ashtu siç mbanin nëpër duar lëkurët e thara të kafshëve, u vinin çmimin atyre dhe i blinin, tani peshonin nëpër gishtërinjtë e tyre të trashë lëkurën e vet berberit. Dhe me të vërtetë, ç'është njeriu më tepër se një lëkurë e tharë dhie?

Ngrita sytë nga berberi, po sytë e tij u mbyllën. Edhe ai po dëgjonte në heshtje bisedën e atyre njerëzve dhe nuk dëshironte të fliste. Për njeriun bisedohej...

- Gjë e ngatërruar njeriu, - tha rëndshëm Vezir Alushi, që ta dëgjonin të gjithë. Fliste me atë zërin e tij të rëndë, autoritar, por që sapo përhapej në ajër, humbte tingullin e vet.

- Si ta ketë bërë nëna, - tha Ago Arëza.

- Njeriu është shumë i ngatërruar, - tha tani urdhërues Velo Shtërgu.

Askush nuk u ndie më. Ky Velo Shtërgu duhej të ishte më shumë se sa dukej në Holtë, sepse këta nëpunësa shteti këndeje mbahen shumë pas lidhjeve të tyre të nëndheshme, vëllai oficer, vjehri kryetar këshilli, kushëriri i parë në aparatën e partisë. Nga këto lidhje këta shtrihen mbi fshatin si ai trangu gjithë gunga e rrënjë që i mbulon e i than të tjerët. Në pasqyrë vështrova me kujdes fytyrën e sheshtë të Velo Shtërgut, sytë e zezë tepër të hapur dukeshin si dy pulla të ngjitura në atë ballë të gjerë e të rrëpirtë. Këpucët në këmbë i kishte fare të reja dhe herë pas here dridhte në dorë një tufë me çelësa. Duke parë në pasqyrë qylafin e bardhë, ulur gjer mbi vetulla, atë shikim të mbyllur e të rrëzuar të syve të Ago Arëzës, unë e kuptova se roja i shkollës ishte një qenie e bindur ndaj nëpunësit të qendrës

së grumbullimit të lëkurëve. Ndoshta ishte Velo Shtërgu, dora vetë, ai që ia kishte dhënë atë punë roje në shkollën e fshatit.

Nepsi e putanat për të cilat fliste Vezir Alushi, sigurisht që i drejtoheshin berberit me hundën e prerë. Ky nisi të punojë mbi faqen time briskun. Fytyra e tij e zbehtë e ata sy të mëdhenj të mveshur si në avusha qirinjsh më erdhën fare pranë. U mundua të buzëqeshë.

- Ç'f'i bësh... - murmuriti.
- E pagove? – fola unë.
- Po, - tha ai lirshëm. – Kur të zë...
- E dashuroje?

Berberi nuk u përgjigj menjëherë. Ata në pasqyrë lëvizën dhe kokat e tyre sikur u afruan më pranë nesh, natyrisht të dëgjonin bisedën tonë.

- Shumë... – erdhi përgjigja e vonuar e Mërgimit.
- Domethënë... e dashuroje? – erdhi nga pas pyetja e Velo Shtërgut.

- Shumë... – u përgjigj përsëri i qetë Mërgim Berberi.

Ishte si një heshtje fundosëse ku ndjemë se po zhyteshim të gjithë. E doja shumë... Të dyja fjalët: e doja... dhe shumë... Zot, mendova unë me vete, si bashkohen buzët e këtij mjerani këtu, mes këtyre maleve vrasëse, këto fjalë që nëpër qytete të mëdha njerëzit i lëshojnë shpesh si bishtra cigaresh të djegur? Unë fola që të dëgjonin të gjithë, edhe ata që ishin pas meje, edhe ato koka që tani më përgjonin atje nga pasqyra e ftohtë:

- Nuk ke frikë nga këta?
- Berberi drejtoi trupin, ngriti kryet e tha:
- Hije... janë hije... vetëm hije...

Në pasqyrë djajtë u lëkundën, kokat e tyre lëvizën dhe ata nisën t'i skërmiteshin.

- Të pata thënë, - i tha Velo Shtërğu Ago Arëzës, - ai e donte shumë, këtë nuk e ka mohuar kurrë... Po ti nuk besoje... Ti s'më besove mua...

- Cëc... - ia bëri me qiellzë Ago Arëza - cëc... cëc... po të mos e kisha dëgjuar me veshët e mi, prapë nuk do ta kisha besuar.

- Nuk e mohon, - tha Velo Shtërğu, - dhe të them të drejtën më vjen mirë. Burri është burrë... Po tani, tani po të pyes, a e do më?

- Jo, - tha berberi i dëshpëruar, - jo...

Bebëzat e tij u mbyllën, nëpër gurras gëlltiti një lemzë të gjatë. Kishte një dhimbje të vërtetë tek ai njeri. Askush nga ata të tjerët nuk foli, veç shikimi im e pyeti:

- Pse... nuk e do?

- Nuk ia vlen më, - tha ai fare i qetë.

- Si nuk ia vlen?

- Nuk dashurohet dy herë, - më foli tani në intimitet. - Nuk dashurohet dy herë.

Unë ia ngula sytë në pasqyrë irlandezes epshore dhe provokuese. Ç'kërkonte gjer në Holtën e egër ajo femër? Si kishte ardhur ajo gjer aty?

- S'është e vërtetë... dashurohet.

- Nuk është ajo dashuria, është tjetër...

- Është e vërtetë që është tjetër, por sidoqoftë... - thashë unë, - dashuri është.

- Ah, sidoqoftë... ajo dashuri nuk është art, - foli ai.

Ç'dëshironte të thoshte ashtu? "Nuk është art..." ky njeri e mban veten për artist, në këto male të egra të Holtës! Sytë

e mi akoma kërkonin nëpër fotografitë e vendosura në kornizë të pasqyrës. Unë ia tregova me gisht Velo Shtërgut:

- E bukur, ë? – fola unë.

Tani Velo Shtërgu u çua prej karriges dhe erdhi pranë pasqyrës që të kundronte fare nga afër ato dy artiste.

- Ku i gjen Mërgimi ynë këto... si me dorë i zgjedh, putanat.

- Qejfli i madh, usta, - erdhi zëri i Ago Arëzës, dhe ai e shkundi qylafin e bardhë mbi gjunjë. – Me këto e tërbon dynjanë, ky...

Ago Arëza ishte me të vërtetë i zemëruar.

- Ky i tërbon edhe këto tonat... - ishte Vezir Alushi që deri atëherë kishte heshtur.

- Këta ta prenë hundën? – pyeta unë me zë që ta dëgjonin të gjithë.

Ata në pasqyrë u tulatën dhe Velo Shtërgu shkoi e u ul në karrige. Askush nuk fliste më. Velo Shtërgu nxori përpara gjoksin e vet, ndërsa Ago Arëza i rrëzoi përdhe sytë gjysmë të mbyllur. Berberi nuk u përgjigj dhe unë u pendova për pyetjen time provokuese. Ai njeri nuk dëshironte të fliste.

Atëherë ago Arëza tha:

- Në Holtë ka burra nderi...

- Tamam, - erdhi një zë.

- Bota për një gisht erz rrojnë...

- Po, përse tjetër?

- Sos jemi soj qeni, që të ngjitemi faqe botës, e nuk shqitemi më dot.

Ata pas meje po bisedonin lirshëm, edhe në pasqyrë. Bisedonin burrat e ndershëm të Holtës. Qeshnin, gajaseshin. Përse rronte Holta, në mos për ata dy gisht nder në ballë. Unë e pyeta berberin:



- Kush ishte ajo?

Ai tundi kokën, nuk dëshironte të përgjigjej.

- A ishte e bukur?

- E bukur pyet zotrote? Peri... – erdhi përgjigja e Velo Shtërgut.

- Ashtu?

Berberi më pa drejt në sy, buzëqeshi e me një frymëmarrje të prerë tha:

- Si Aksinja.

Ah, prandaj ky qenka hidhëruar që kinezët shajnë tani “Donin e qetë” të Shollohovit? Ky e paska hallin tek Aksinja, ajo fshatarja e bukur, frelëshuar e brigjeve të Donit.

- A ka Aksinja në Holtë? - pyeta unë.

Berberi qeshi lirshëm, zëri i tij i plagosur e i lodhur, mbushi tërë berberanën.

- Ka, - tha ai, - ka Aksinja edhe këtu...

Djajtë në pasqyrë u shastisën, kokat e tyre gati u bashkuan, përgjonin bisedën tonë, por dukej që s’kuptonin asgjë. Berberi dhe unë vazhdonim të qeshnim dhe unë e pranova se Aksinja ishte art, ishte një femër që ia vlente dhe se dy herë dashuria e saj nuk përjetohet dot.

# Nuk shitet shpirti në tetor...

*"Kurrkush mos të njoftë, të njëh vetja"*

**A**i ishte një vendim i përnjëhershëm, i egër, disi nëpër gjumë, unë thash: do ta shes shpirtin, nuk mundem më dhe, as jam i pari e as i fundit. Qëndrova sa munda, po ja ku dorëzohem, po e shes edhe unë shpirtin tim.

Në çast, në karrigen pranë shtratit, ndjeva shpirtin kulish që dridhej e kuiste.

- Do të jesh më mirë, - i thashë unë, - ke për ta parë. Bëra gabim që nuk të shita më parë, si shumë e shumë të tjerë. Të sfilita pa të drejtë. Të më falësh. Të dënova duke të mbajtur kaq vjet në veten time; duhej të të kisha shitur më parë, por edhe tani s'është vonë. Atje do të jesh më mirë, ke për të parë do të plotësohen gjithë dëshirat. Shpirt njeriu je edhe ti.

Kështu i fola edhe vetes edhe shpirtit. U çova nga shtrati, u rrojta shpejt e shpejt, përtypa në këmbë diçka si një kothere të thatë dhe e mbërtheva kulishin nga qafa.

- Shkojmë tani, s'ke ç'bën.

Të dera e shtëpisë qëndrova një çast në mëdyshje: nga t'ia mbaja?

## *Faraoni i madh*

**A**i është më i madhi i të gjithëve. Përse është Faraon e përse është më i madhi i të gjithëve, unë nuk e di. Dhe as që më duhet gjë mua, përse ai vetëm është Faraoni. Do të ishte mirë që ai ta blinte shpirtin tim, sepse kuptohet që në pallatin faraonik jetohet mirë. Dhe mendja më shkoi te kuzhina magjepse, te vajzat e kuzhinës. Të gjithë, kur tregojnë për Faraonin, flasin për vajzat e tij të kuzhinës.

Shpirtit nuk i fola gjë. E ndieja se si lëkurça e qafës së tij dridhej në grushtin tim, po vetë ecja i qetë e gjithë kujdes rrugëve plot trafik të çrregullt e të rrezikshëm të Tiranës. Nuk i fola gjë shpirtit për ngrënie, sepse gjatë gjithë jetës i kisha përrallisur të gjorit, se njeriu nuk rroka vetëm për bukën e gojës, njeriu nuk frymon, kisha thënë, për ngrënie. Madje, pjesën më të madhe të jetës, shpirti im e ka shkuar i uritur, dhe unë i thosha atij se ashtu ishte më mirë, kjo e bënte shpirtin të durueshëm e të pathyeshëm. Tani si ta ktheja fletën e t'i predikoj që te Faraoni i madh do të nginjë e nuk do të ndjente më pickimet e mullës së uritur?

- Do të mësohesh.

- Ndofta, - tha ai, po nuk i ndërpreu dënesjet e veta.

Më në fund, kujdesshëm, unë kapërceva urën e u hodha në anën tjetër të bulevardit. Çështja ishte se duhej të mendohesha pak, ku do të shkoja e si do të shkoja. Te këndi i rrugës punonte një bar i qetë, luksoz. Hyra aty e porosita një xhin. Kamarieri, një djalosh i njomë, me sy të kaltër e të gëzuar, buzagaz përkëdheli me dorë shpirtin-kulish.

- Juaji? – pyeti gëzueshëm.

- Imi.

Ai tundi kryet.

- Nuk kisha parë shpirt-kulish kështu ngjyrë dlirtë...

Dhe i buzëqeshi përsëri shpirtit.

- Ngjyrë dlirtë? – pyeta unë i befasuar. – Pse, të tjerët si janë?

- Shumëngjyrësh, - tha kamerieri i ri, - por shumica janë të murrmë, murrashë.

- Ah!

- Po, - tha ai, - ky qenka i bukur e i pastër.

Përkëdheli përsëri me dorë shpirtin dhe u largua. Atëherë unë ngula shikimin mbi atë kulish me turinj të sheshtë, noçkat mbuluar me një blanë të zezë, qafën të veshur me qime të gjata, këmbë të shkurtra pitoshe. Këta qenushë tani janë në modë në Tiranë, sidomos që kur neve kemi zënë të hapemi drejt Europës. Zonjushet e reja i mbajnë me nga një zinxhir në dorë kur shëtisin, të tjerat i mbajnë drejt e në gjoksin e tyre, ku ata ndihen ngrohtë e mirë. Çfarë ngjyrë e dlirtë? murmurita me vete, edhe ky murrash është, si gjithë të tjerët, veçse aty-këtu mbi lëkurë paska disa pikëla gri. Pse? As unë nuk e di, por pikëlat janë.

E kapa shpirtin nga qafa leshtore dhe me çap të rënduar kapërceva lulishten e trëndafilave, kalova udhën e blirave e dola te pallati i Faraonit. Ngado roje të heshtura e të frikshme, por tanimë ne jemi mësuar me këta. Një turmë njerëzish prisnin përjashta, dikush edhe me shpirtin në dorë, sigurisht për ta shitur. Njëri shiste të vetin, tjetri të gruas apo të babait. Një shpirt kishte një turiçkë të gjatë si të një kulishi dhelpre. Pyeta zonjën e shkurtër e të bëshme që e mbante në dorë. Ajo më tha se e kishte të kumatës dhe kishte ardhur ta shiste.

- Blejnë? – pyeta unë.

- Oh, dhe me çmim të mirë, - tha zonja.

Njerëzit renditeshin te dera e hekurt e lyer me varak të verdhë; prapa kangjellave oficeri i shërbimit regjistronte emrat e vizitorëve dhe të nëpunësit që do të takonin. Unë dhashë emrin tim dhe kërkova të takoj Faraonin e madh. Fytyra e zgjatur kockore e oficerit u skalit si në një monedhë të vjetër, ai më nguli një shikim depërtues e të akullt, po kur unë fola emrin tim, oficeri i vuri në përdorim të tre aparatët telefonikë që kishte mbi tryezë.

Nuk zgjati shumë e oficeri i pallatit erdhi drejt hyrjes.

- Poeti Shkëlzen Holta? – pyeti nga larg.

Unë dola përpara.

- Urdhëroni.

Në Tiranë faraonët nuk lindin faraonë, ata bëhen faraonë. Ne jemi republikanë parlamentarë dhe vendi drejtohet sipas kushtetutës. Europa thotë se së shpejti ne do të hyjmë edhe në vëllazërinë e popujve demokratë të saj. Faraoni i madh më priti buzagaz te hyrja e sallës së gjerë dhe me një shenjë të kokës më ftoi të ulesha pranë kreut të tryezës, ku erdhi e u ul edhe ai vetë. Unë e falenderova dhe vendosa plot kujdes shpirtin në kolltukun pranë. Njiheshim prej kohe, qyshkur të dy studionim në sallën e bibliotekës kombëtare. Ndodhte ndonjëherë të ngjiteshim lart në bufe e të merrnim së bashku nga një çaj. Atëherë ishin kohë fukarenjsh, por gjë që dihet, kohët ndryshojnë. Tani ai është Faraoni i Madh e siç ju thashë blen edhe shpirtra.

- Ëh, - më tha mirëdashës e duke treguar me krye shpirtin tim që dridhej, e solle?

- E solla, - fola unë me zërin gjysmëfajtor.

Faraoni i Madh ishte një mesoburrë me një kokë të madhe në mes të dy shpatullave të gjera, leshra e mustaqe të kuqe, sy të ëmbël të zezë dhe një buzëqeshje të lehtë, të përhershme mikluese. Ai e dinte mirë hirin e pamjes së tij. Shqiptarëve këta prijësa u pëlqejnë dhe unë nuk do të guxoja kurrë të flisja keq për të. Jeta është një aventurë, pastaj mendoni një aventurë shqiptare. Një aventurë shqiptare ka përherë brenda bërthamën e një tragjedie, nga ato që të bën të qeshësh e të qash njëherësh.

- Po si vendose? – më pyeti ai duke më zgjatur kutinë e cigareve, unë kam pyetur aq e aq herë dhe gjithnjë më vinin informacionet: “vetëm ai që nuk e shet e nuk e shet shpirtin e vet”. Ti nuk doje...

Ngrita supet.

- Ç'të bësh, Faraon i Madh... - pastaj thashë prerë: - vendosa...

Sytë e tij të zezë u turbulluan sinqerisht, balli iu rrudh dhe ai preku lehtas me dorë mustaqet e kuqeza. Ishte vërtetë i dëshpëruar.

- Është vonë, - tha dhimbshëm. - Kur po vije këtu, këta... - dhe Faraoni i Madh shënoi me krye tre këshilltarët që qëndronin prapa meje. Kur paskam hyrë në sallë, unë nuk i paskam vërejtur, nuk pashë njeri, ndërsa tani kthej kryet dhe i shoh të tre në këmbë, të palëvizshëm, me kostumet e zezë të ceremonive të pritjes dhe duart të lidhura përpara. Të heshtur. Njëri, si duket ai i pari, kishte një fije mjekër të hollë të hollë, që i gardhonte si akrep mjekrën.

- Këta më thonë se është vonë, - foli Faraoni i Madh.

Ai nguli shikimin mbi shpirtin tim. Ashtu ata të dy u panë një copë herë, Faraoni i madh dhe kulishi. Dhe të dy përnjëherësh u ftohën, u larguan e pulitën sytë.

- Tani, a mund të bëhet gjë? – pyeti me zë të lodhur Faraoni. Ngriti kryet leshatake e pa diku prapa meje. Si mund të ndihmohet poeti? – iu drejtua këshilltarëve të vet.

Foli mjekër-akrepi:

- Në pallatin tonë mbajmë disa shpirtra poetësh, po ata janë të tjerë...

- Pse? – ngulmoi Faraoni i Madh, i cili me të vërtetë dëshironte të më ndihmonte.

- Ne e gjykuam çështjen me kujdes Faraoni im, dhe thellë; ky kulish-shpirti nuk është në bashkësinë tonë, fliste këshilltari ngadalë e me një zë kërcitës si të akujve të rrugës kur thyen prej kalimtarëve.

Faraoni i Madh u kthye nga unë.

- Je shans i humbur, poeti im... Duhej vrapuar me kohë... dhe ai më preku miqësisht në sup.

Ishte e kotë të vazhdoje më gjatë. E pyeta Faraonin e Madh, për mirësjellje, se si i kishte fëmijët dhe se si po ia çonte me punët e rëndomta të shtetit tonë. Ai psherëtitu gjatë e thellë.

- Ku kanë fund hallet e shtetit, - tha.

Shtriu duart përpara mbi qelqin e trashë të tavolinës, kryqëzoi gishtërinjtë dhe foli:

- Zoti më dhëntë forcë, pa do të më njohin se kush jam.

Fjalët e fundit, natyrisht, që ia thoshte vetes. Mua m'u duk sikur u shkëputa nga poltroni ku isha ulur e fluturova prapa, diku, por nuk u përplasa te këshilltarët. Aty niste kuptimi mistik dhe i frikshëm i shtetit. Zgjata dorën dhe e mbërtheva nga mesi i kurrizit kulishin. U dëgjua një kuisje e shëmtuar dhimbjeje e shpirtit. Ashtu unë u rrokullisa korridoreve të pallatit faraonik dhe dola në rrugë.

Më kishte mbetur në trup ajo hungërimë e brendshme e shpirtit, si një llahtarë që vjen papritur, pastaj ajo ulje e njëhershme e dy palë syve të Faraonit dhe të shpirtit tim. Ç'ishte ajo? Mendova ta pyes shpirtin, por u pendova. Duhet ta marr një herë me të mirë, mendova, ta mikloj pak, sepse ai është tepër nopran dhe nuk më bindet. Unë i thashë të kalojmë e të pushojmë ca andej nga parku i liqenit, të çlodhemi pakëz. Ai pranoi.

Anës liqenit vetëm ca pleq rrinin e shullëheshin nëpër stola. Unë u shtyva mbi bar në breg. Dhe e lashë kulishin të baresë nga të dëshironte. Ai nuk donte. Futi turçkat midis të dy putrave të njoma, vërejti ballin dhe më hodhi një shikim të mërziut.

- Ç'më shikon ashtu?

Ai nuk foli.

- Pse nuk shëtit ca, të të shpihen këmbët...

Përsëri shpirti nuk lëvizi as bishtin.

- Të thashë: mos u dëshpëro kështu, do të jesh më mirë se në kufomën time. Pa kokëçarje, jeto për vete shpirt! Bëj jetën tëndel! Dhe mos u dëshpëro, unë nuk do të të shes ty për hiçgjë...

Ai picërronte sytë dhe nuk lëvizte asnjë qime të lëkurës së vet. Atëherë unë u ngrita dhe nisa të largohesha prej andej.

- Po të lë këtu, - thashë, - dili zot vetes.

Dhe u largova. Atëherë dëgjova një kuisje dhe e pashë kulishin që po rendte pas meje.

- Pse nuk qëndron vetëm?

- Kam frikë, - tha ai. - Mos më braktis, kam shumë frikë.

- Çfarë frike ke, ti je shpirt, kush merret me ty?

Ai më erdhi shumë pranë dhe unë pashë disi i habitur këmbët e tij pitoshe, të vockla që shkelnin tokës. Pa thonj.



Shpirti im nuk kishte thonj, atë e plagoste çdo guriçkë, e gjakoste çdo guralec. E ngrita ndër duar dhe nisa ta përkëdhelja. Shpirt është, de... Edhe ai ka nevojë për pak ngrohtësi.

Në ato çaste unë e pyeta atë:

- Tani më trego, çfarë ndodhi atje në sallën e pritjes së Faraonit, çfarë ndodhi atje midis jush? Ju e patë njëri-tjetrin gjatë në sy, diçka zhbiruat, ti pse u trembe?

Kulishi nisi sërish të dridhet në duart e mia, sikur të ishte një masë e vogël, e lëvizshme xhelatinoze. Dhe shpërndante ca hungërima të prera, të thekshme, që nuk kuptohej se nga vinin. Ai tha vetëm:

- Kam frikë... shumë frikë...

- Pse ke frikë?

- Ti je naiv, i papërgjegjshëm, ti nuk e di...

- Po çfarë nuk di unë?

- Ku ta dish ti se ç'është shpirti i një Faraoni! – klithi kulishi, ku i ke parë ti humnerat e frikshme të tij. Ti je një poet i mjerë, ja ç'je ti. Një poet shkretan, që sot ke nxjerrë në treg të shesësh edhe shpirtin tënd. Ku i kupton dot ti shpirtat e tjerë...

Kjo nuk më kishte shkuar vërtet në mendje. Kur ishte brenda meje e kisha ndjerë se si vuante shpirti im, por kështu të gjallë, të ngrohtë që dridhej nga frika e shpirttrave të tjerë ndër duart e mia, nuk e kisha menduar ndonjëherë. M'u dhimbs, me të vërtetë që m'u dhimbs.

Sa pashë ndanë udhe një kabinë telefonike, e lashë kulishin të rrezitej nën rrezet e diellit dhe shkova t'i telefonoj Gentianës. Prej andej erdhi zëri i saj. Unë i shpjegova se ç'kishte ndodhur.

- Vendosa ta shes, - thashë unë.

Gentiana heshtte.

- Shkova te Faraoni i Madh, por nuk e blenë, nuk e donin në pallatin e tyre.

Gentiana heshtte dhe vetëm kur unë kërkova arsye për heshtjen e saj, ajo u përgjigj fare qetë:

- Mos ke gabuar?

- Jo, pse kam gabuar? Nuk mundem dot më... Në fund të fundit nuk jam as i pari e as i fundit... Kur do të takohemi?

Gentiana më shpjegoi se ato dy-tre ditë kishte për të qenë shumë e zënë, ka ardhur një delegacion shumë i rëndësishëm nga Europa e Bashkuar.

- E, ç'na qenka ky delegacion?

- Ti kërkon shumë, - tha Gentiana dhe e mbylli telefonin.

## *Kopili i Madh*

*N*ga larg në rrugë po vinte zjush Zina, mësuesja e viteve të para të shkollës foshnjore. E gjatë e thatime si dikur nën fustanin gri me pikëla të bardha, tani flokët e thinjura i kishte futur në kapelen e zezë, ulur gjer mbi vetulla. Zjusha u ndal para meje disi e hutuar.

- Ç'po bën? – më pyeti me shikimin ngulur te kulishi që mbaja në duar. Nuk dija si t'i përgjigjesha mësueses së fëmijërisë. Më erdhi turp nga vetja, mbylla sytë e i fola:

- Dua ta shes... Dua ta shes, po nuk po ma blejnë...

Zjush Zina heshti një copëherë.

- Është vështirë, - i thashë unë duke i kujtuar mësimet e saj të fëmijërisë, kur na mësonte se duhet ta ruajmë të pastër, të bukur e të dliërë shpirtin. Në këtë katrahurë që është sot, një shpirt poeti e paska të vështirë, ai shkon vetëm drejt rrënimit tim.

- Pse, ç'bën ky?

Sytë e zjushës të dëshpëruar ndiqnin dridhjet e kulishit që unë e kisha mbërthyer për qafe.

- Çfarë kërkon ky?

- Zjush, ky... - dhe unë nisa ta shkund fort në ajër kulishin që tani hungëronte nga dhimbja, ky kërkon ca gjëra që nuk kërkohe. Edhe në gjumë qan e grindet si një drej i mbrapshtë, pse drejtësi është kjo, pse liria kjo na qenka, njeriu, thotë, duhet të jetë prej ëndrrash... Dhe unë nisa t'i flas si mesues i vjetër vargjet poetikë: "Dashurinë po kërkoj që më është kaq e shtrenjtë"<sup>1</sup> "Se madhështia e vërtetë është / të mos lëvizësh pa argument të madh, / po madhërisht të kapesh pas një kashte / kur nderi është në balancë."<sup>2</sup>

Zjusha mbylli sytë e rrudhosur gjer në dëshpërim.

- Po është shpirt poeti, - murmuriti më tepër për veten, - prandaj është shpirt poeti, që të kërkojë...

- Po prandaj, - klitha unë, - prandaj... Pikërisht sepse është i tillë. Ndërsa unë, në fund të fundit, jam njeri dhe si gjithë të tjerët dua edhe unë të bëj një gjumë të thellë e të qetë pa makthet me emra Faraoni i Madh, Kopili i Madh... Këtu unë u ndala. Pse më erdhi në buzë Kopili i Madh?

<sup>1</sup>. Ugo Foscolo.

<sup>2</sup>. Uilliam Shekspir.

Zjusha m'u afrua fare pranë.

- Po, - tha... dhe nuk vazhdoi më tutje.

- Po... – murmurita edhe unë.

- Të paktën, - tha zjusha, - ta kishe vendosur në një kutizë, në një shportë të vogël me kordelëza, të kujdeseshe pak, jo kështu... Kush të sheh me të nëpër rrugë... pastaj do të dënojnë ata të Europës që merren me mbrojtjen e kafshëve.

Po ndaheshim kur Zjush Zina më tha:

- Shko te Kopili i Madh, mos u qell shumë nëpër rrugë se ky po më dhimbset. Unë sapo të arrij në shtëpi do t'i telefonoj të të presë. Ndofta ai e mban mend se dikur keni qenë nxënës të një klase, kur ishit fëmijë.

Zjusha gabonte, unë nuk kisha qenë kurrë në një klasë me Kopilin e Madh. Unë atëherë isha në klasën e tretë të foshnjores e ai në të dytën, ishte një klasë më poshtë. Ai ishte një fëmijë shumë i lig, sepse e mbaj mend kur hodhi në mangallin e ndezur me prush një bashkënxënësin e tij, që të provonte se si mund të digjej. Qysh atëherë e mbaj mend atë.

U nisa për në selinë e Kopilit të Madh. Kaloja midis qytetarëve të Tiranës, por askush nuk i kushtonte vëmendje shpirtit tim. Njerëzit bënin jetën e tyre të përditshme, shportat plot zarzavate ndër duar, qepë, domate e patëllxhanë. Njëri, si gjysmë i lojtur që fliste me vete, zuri të thërrasë: “Tre herë e shitët Shqipërinë, por mua nuk më shitët dot!”

- E sheh?! – shpirti im lëvriu ndër grushtet e mi. – E dëgjon?... – por, pranë meje kaloi një vajzë që po përtypte çamçakiz, elegante, e dalë si prej ekraneve të televizorëve. Vërtetë mahnitëse dhe mua më mbetën sytë tek ajo, por dikush më pëshpëriti në vesh:

- Është nga ato të Putanës së Madhe... - dhe u largua. U përpoqa ta shquaja mirë, veç silueta e tij rrëshqiti dhe më humbi mes turmës. Më mbetën në sy vetëm flokët e dendur krela-krela si të një afrikani. Bri meje kalonte një shenjt, nga ata të ardhur në këto kohët e fundit prej Europës, model i ardhur nga jashtë, shkelte zbathur mbi plloçat e ftohta të trotuarit, mëngët e pantallonave mbi kyçet e këmbëve, të vjetra e të palara, pa brez, me një mjekër ngjyrë të verdhë në të kuqe, si mjekrra e një kalliri misri të pjekur, të gjatë e të lidhur gërsheta-gërsheta poshtë. Kishte kryqëzuar të dy krahët në gjoksin e palarë. Binte erë e kundërmonte shurrë e thartirë e fliste udhës me vete. Me sa duket falej e përsëriste litanira. Kur mbërrita te dera e Kopilit të Madh, më prisnin dy bodigardë. Ata ma rrëmbyen menjëherë nga duart shpirtin-kulish.

- Kemi urdhër që këtë ta mbajmë neve, më urdhëruan.

Mua më kaluan nëpër një si kornizë deriçke me aparate që kontrollonte, me sa duket për armë. Dhe përtej saj, një roje nisi të kontrollojë me aparat përgjues nëpër gjithë shtatin tim. Unë ngrita duart lart e fola:

- Jam vetëm një poet i mjerë, ç'i duen poetit armët?

Po ata thanë:

- Bëjmë detyrën.

Edhe Kopili i Madh më priti në këmbë te dera, ai shkelte gjithë dhimbje dhe mezi u ul në kolltuk.

- Më ka mbërthyer kryqet shiatiku, - tha.

Kjo fjalë "kryqet" gjithnjë mua më ka bërë shumë përshtypje, më ka dhënë ndjesinë se të gjithë, edhe pushtetarët më të egër, mbajnë me vete një kryq. Kopili i Madh kishte ndryshuar shumë. Duke e vëzhguar me kujdes

mua më erdhën në kokë mendime nga më të ndryshmet, por sidomos që politikanët tanë shëmbëlajnë me ca reklama të vjetra, afishe nga ato të rrugëve ku duar manjakësh zhgarravitin lloj-lloj parrullash, emrash, figurash. Kopili i Madh nuk kishte qafë, sikur e kishte të prerë dhe e kishte hedhur tutje. Kokën e kishte ngulur drejt e mbi supet e gjerë e kockorë. Sytë e kaftë i lëviznin ethshëm duke xixuar në çdo çast. Nuk e kuptoja përse prania e këtij burri ishte fisnike dhe buzëqeshja e tij të bënte për vete. Unë buzëqesha. Edhe ai tha:

- Sapo më lajmëroi Zjush Zina...

- Ah, po... e takova në rrugë...

Unë desha t'i ankohesha se shpirtin tim ma rrëmbyen bodigardët te hyrja, po ai e bleu shqetësimin tim e tha:

- Do ta kthejnë... a ke shkruar poezi? – më pyeti pastaj.

U habita me pyetjen e Kopilit të Madh dhe munda vetëm të murmuris:

- Nuk është kohë poezie, kjo...

- Popullit i duhen të gjitha, - tha ai.

Ia ngula shikimin tim mu në mesin e ballit ku i thellohej një rrudhë, e thellë si një shtrat lumi, mos po gaboja, mos unë e paragjykoja këtë njeri që vuante kaq tepër; ndofta Kopili i Madh ishte vëllai tjetër, binjaku i atij shenjti të palarë që shkelte baltrave të Tiranës duke kënduar me vete litanirat e tij. Përse unë tani, si në një fletore të vogël e të vjetër, shfletoja faqe pas faqeje reklama e parrulla në emër të popullit, prej popullit dhe nga populli? Unë i kujtova prapë Kopilit të Madh se shpirtin tim ma kishin ndaluar tek hyrja bodigardët dhe se ai nuk ishte aq i rrezikshëm, sa mund të duket apo sa mund t'i ketë dalë nami. Ai më tha se rojet bënë detyrën e

vet dhe ai nuk mund të ndërhynte në kompetencat e tyre.  
Por përsëriti:

- Sapo të dalësh prej këndeje do ta kthejnë, nuk e mbajnë.

- E solla që ta shes, - shpejtova unë, - do të më ndihmonit tepër nëse do ta blinit.

I dhashë të kuptonte se isha me të vërtetë ngushtë. Kopili i Madh puliti tërë bezdi sytë dhe mu ankua sinqerisht:

- Nuk është çështja aty, - tha. - Nuk vuajmë për dy groshë. Çështja është se shpirtat që kemi blerë dhe që blejmë ne janë ndryshe, tjetër racë, ata janë një soj i zbutur, ndërsa kulishi yt rrjedh prej gjaku pirati...

Kështu tha Kopili i Madh "shpirti yt ka gjak pirati", gjë që unë nuk e dija. Me sa duket ata ndërkohë e kishin analizuar gjakun e shpirtit tim dhe ai nisi të më flasë po ato fjalë që m'i pat thënë edhe Faraoni i Madh: shpirti im ishte i një soji tjetër, i pazbutshëm...

- Po... provojeni një herë... - ngulmova unë.

Kopili i Madh lëkundti gjithë trupin e tij.

- Ai shpirt edhe në gjumë klith: "dritë! dritë! dritë!", a të kujtohet kjo thirrje?

Pohova me një lëvizje të kokës.

- Më vjen me të vërtetë keq, besomë... Është vonë, jeta është vetëm një shans dhe ti e humbe atë. Të tjerët fituan, s'ke ç'i bën... kjo është demokracia...

Unë u çova nga vendi ku isha ulur. Edhe Kopili i Madh u çua.

- Mos u dëshpëro, - më këshilloi, - merre jetën si të vijë. - Dhe buzëqeshi me përzemërsi. - Sidoqoftë, ne këtu jemi, këtu na ke.

Dola prej selisë së Kopilit të Madh.

Tek dera çeta e sejmeneve ishte shumë mirësjellëse, ata ma lëshuan kulishin ndër duar duke e përgëzuar e përkëdhelur.

Ndoshta askush nuk ka ndjerë kënaqësinë që ndjej unë kur shëtis në rrugën e manjolare, në atë copë udhe ku pema e gjelbër mban nëpër degë lulet plot dritë, dritë e vesë, që përhapin në ajër një qetësi e paqe të përjetshme. Qëndroj e sodis në një hutim të bardhë ato lule, ato gjethe gjithmonë të gjelbra, atë dru të durueshëm, të bekuar paqësor. Aty në rrugën e manjolare, te dera e Bibliotekës Kombëtare, dikush po thërriste: “Unë jam spiun, pse nuk më blejnë?”. Njerëzia kalonte në punën e vet të rëndomtë, por ai atje te shkallaret e mermerta thërriste: “jam spiun, pse nuk më blejnë...” Ashtu më pyeti edhe mua. Unë ngrita supet, e pashë në sy me dhimbje: “Sot, nuk blejnë asgjë, - i thashë, - i kanë të gjitha me bollëk...” Është me të vërtetë nga ata spiunë që shiten pa u blerë dhe unë ashtu i fola:

- Nuk të blejnë, sepse ata të sojit tënd shiten pa u blerë.

Ai u hutua disi dhe nëpër hutim më pyeti me zë të ulët:

- Ashtu mendon ti?

- Ashtu.

Tutje, në një shesh të vogël midis ndërtesave të larta, atje te pirgu i plehrave, po mbante fjalim një nga ishët, domethënë një nga ish-ministrat. U fliste militantëve të vet. Këtë ministër unë e dallova përnjëherësh, sepse është rrënxak, i varen topet poshtë e formojnë një qeskë të fryrë te kaloçi i pantallonave. Thonë që bën edhe sot e kësaj dite pllojë nëpër sekretaret e ministrive. Ish-ministri i tranzicionit po thërriste:

- Unë luftoj korrupsionin!



Militantët e brohorisin dhe thërrisin:

- Poshtë korrupsioni!

Një grua ulte edhe gishtin e madh poshtë, sikur të kishte marrë mësim nga vetë Qezari i Romës.

Aty unë nxorra nga xhepi blloknotin e gazetarit dhe nisa të mbaja ca shënime të shpejta. Këta militantë janë vetë kulishët e dreqit, gjëkund qoftëlargu nuk ka pjellë zogj kaq afër zanafillës së vet, si këta të Tiranës sime. Të dalë nga veza e parë ata janë dëshmia e pakundërshtueshme se kanë për baba vetë të parin e fisit të dreqve. Dallohen menjëherë nga sytë që u xixojnë ca xixa të verdha në të gjelbra. Projektojnë në të dy anët: prapa në thellësi, ku takohen me pikëlindjen e tyre dhe përpara në të ardhmen, ku nuk dinë se ku duhet arritur. Një art i vërtetë janë filigramat e mjekrës që përshkojnë nga rrëza e veshit dhe u mbushin tërë faqen. Është aty zodiaku i vërtetë i këtyre zogjve të dreqit. Ish-ministri më dalloi mes turmës ku po mbaja shënimet, më dha një shenjë me dorë dhe më urdhëroi të shkoja pranë tij. Kur iu afrova më pyeti se ç'po bëja.

- Po mbaj ca shënime, - fola unë. - Mund t'i botojmë në gazetë.

- Atë e shoh, po pse ke dalë këndej?

I tregova shpirtin që mbaja mbërthyer nga qafa.

- Nuk e blen njeri, - i thashë unë.

- Nëndorë, shite nëndorë, - foli ethshëm ish-ministri.

Ndërsa fliste me mua ai shikonte nga turma dhe vazhdonte fjalimin e vet.

- Si nëndorë? - e pyeta i hutuar.

- Ti mbete një budalla i pandreqshëm, i paaftë për veten, për gruan e fëmijët. Mjerë ata me ty, I more më qafë të gjorët.

Shumë mirë që më në fund u binde e vendose ta shesësh atë gjëmë... - dhe ai pa me neveri shpirtin tim që po dridhej... - por ç'më shkon drejt e te Faraoni i Madh, - tha pastaj gjithë qesëndi.

U tmerrova! Ish-ministri i dinte të gjitha dhe ai nuk e fshehte se të gjitha i dinte. E kuptova se të gjithë donin të më ndihmonin, por edhe ata nuk dinin se si.

- E kush e blen nëndorë këtë? – pyeta i dëshpëruar.

Ministri tha shkoqur:

- Unë.

- Ku t'u kërkoj?

- Eja nesër aty, te kioska ime, - dhe tregoi me dorë barrakën e tij. – Mos harro: kioska “Dashuria është zgjuar”, rruga “Sofra e vjetër” – 59.

Në darkë e vendosa shpirtin në shportëz, i shtrova poshtë lesh të pastër të butë dhe rashë edhe vet të fle. Isha i lodhur e i këputur. Edhe shpirti më tha se edhe ai ishte i kapitur e donte të flinte. Fika dritën e u përpoqa të fle, po gjumi s'po më zinte; pas ca kohe ndjeva se edhe shpirti lëvizi në shportëz, edhe ai nuk po flinte dot.

- Nuk po fle? – e pyeta unë.

- Jo, - tha ai, - jam zgjuar.

- Dëgjo, - i fola unë, ne të dy duhet ta kuptojmë se ku kemi gabuar. Ku? A ke menduar ti ndonjëherë?

- Jo, - tha shpirti, - përse duhet unë të mendoja? Unë jam vetëm shpirt.

- Ke të drejtë, ti je vetëm shpirt, kurse unë që jam edhe trup, pra unë që jam njeri, unë duhej të kisha menduar se ku kemi gabuar.

- Përpiqu, - tha shpirti, - çfarë të mungon ty, çfarë dëshiron ti?

- Asgjë e gjithçka... - më shpëtoi mendimi i pakontrolluar, i përnjëhershëm që vinte s'e di nga çfarë thellësisht të vetes sime. Ashtu si në kohë të harruara këputej një pjesë e malit, ashtu dëgjoja brenda vetes kumbimin e turbullt të mendimit tim. Asgjë e gjithçka... erdhi nëpër natë zëri im, mbushte odën, kumbonte nëpër ajër përreth meje... Asgjë e gjithçka...

Atëherë unë pashë në karrike një copë hije si një gjysmë trupi lakuriq, një nga ata zogjtë e dreqit që brohoritnin atje në rrugë së bashku me ish-ministrin: "Shkërdhatat! Shkërdhatat!" Ishte një shëmtirë e vërtetë. Nga shtrati ku isha shtrirë iu afrova pranë asaj monstre të skalitur në errësirë. Shpirti im, ky zog dreqi? fola me zë. Në çast gjithçka m'u kthjellua dhe unë e pashë kulishin e butë me turriçkat në putrat e tij, i qetë e i menduar.

- Unë e di, - tha ai, - se ku ke gabuar ti.

- Ëh, si?

- Ti ke gabuar para filxanit tënd të përhershëm të kafesë.

- Si kështu?

- Ashtu... Gjithë jetën tënde ti ke gjykuar njerëzit me një filxhan kafeje në dorë, ashtu ke gjykuar nga larg të mëdhenjtë e dynjasë e të vegjlit e botës.

- E ç'ka këtu të gabueshme e të dënueshme?

- Ka, si nuk ka...

- Poetët nëpër të gjitha kohët i kanë gjykuar edhe perënditë nga një vrimë në ajër.

- E sheh, - tha shpirti i përvuajtur e i dërmuar që nuk po më bindte dot, - e sheh? Ata prandaj nuk ta falin ty, as Faraoni i Madh, as Kopili i Madh. Ata e dinë që unë e ti lexojmë fatet

e tyre nga prangat që ata na mbërthejnë në duar, apo në zemra... Dhe nuk na duan. Unë, edhe tani në këto çaste që po flas me ty, ndjej nëpër ajër kundërmimin e padrejtësisë. Se si më kundërmon...

- Edhe unë po e ndjej...

- E sheh, - tha shpirti, - ti vetë je fajtor, më mësove e më dënove edhe mua, e tani kërkon të më shesësh.

Një copëherë ndjenjëm të dy në errësirë pa folur. Shpirti kishte të drejtë, fajtori isha unë. Naiv e i pandreqshëm, kisha besuar se jeta mund të bëhej më e lehtë për dykëmbëshit frymorë, mjaftonte që atë ta dëshiroja unë. Prej vetes do ta krijoja heroin më të dliurë. Prandaj përpara më prisnin zhgënjim pas zhgënjimi. Tani unë ndodhesha pikërisht në atë xhungël të egër zhgënjimesh, ecja mes saj si një shtegtar i mjerë që i ka humbur të gjitha drejtimit dhe nga tmerri thërrisja me zë të lartë në pyllin e zhgënjimeve të mia. Askush nuk më përgjigjej.

- Shumë besim në veten, - fola unë.

- Shumë, - pohoi edhe shpirti, po zëri i tij ishte fare i ftohtë, sikur të ishte dikush tjetër.

- Ti, mos më shih tani mua, nga para një filxhani kafeje në mëngjesin e kthjellët të Tiranës.

- Po si të të shoh? Unë ashtu jam mësuar. E sheh sa e vështirë është të qeverisësh... - ai heshti gjatë, pastaj rrokëzoi ngadalë: veten... të qeverisësh veten.

U çova nga shtrati, pashë orën, ishte gati dy pas mesnate. U veshja rrëmbimthi, mendova ta marr me vete edhe shpirtin, por pastaj u pendova.

- Jo, ti rri këtu, fli.

Dhe dola prej dhome.

- Ku do të shkosh nëpër natë, - dëgjova pas të pyeste ai.

## *Hiçi i madh*

**S**irana natën është një grua e lodhur, që gjithë ditën është robtuar nëpër voçkëlimat e saj të rëndomta, të mendojë për bukën e gojës, të mendojë për trupin e palarë, të mendojë për fëmijët qurrashë e të pashkollë. Ndonjë polic në rrugë e ndonjë mace që më prisnin udhën. Nga jashtështetit shoqatat qeveritare kishin dërguar një makinë që tani mblidhte plehrat e qytetit. Unë isha i mbushur me mendimet për Hiçin e Madh. Përse ai është Hiçi i Madh, mua nuk më duhet gjë. E kisha parë jo rrallë se si shtriqej nëpër kolltuqet e vjetër të klubit të politikanëve, në të vërtetë nuk pinte asnjë alkool të fortë, por vetiu ishte si në dehje e në delir të përhershëm e lëshonte ca fjalë të zgjatura e të pashkëputura, sikur të ishin suxhukë të llokumtë me arra, nga ata që tiranasve u shijojnë tepër. Ajo fytyrë e bardhë e lëmuar si lëvozhga e një veze, ata sy gjysmëpulitur prapa xhamave të tejdukshëm të syzeve, ai shikim disi i drojtur që hidhte mbi ata që e rrethonin dhe, pastaj, ajo gërvimë e vështirë e zërit të tij të ngjirur, nuk më lejonin t'i afrohesha shumë pranë. Madje unë as që isha kujdesur të mësoja se nga kishte dalë ky gatip aty në klub, si kishte ardhur dhe në ishte me të vërtetë idhtar i ndonjë ideali. Veç një ditë, pikërisht ky hipi mbi tavolinën e klubit të shkrimtarëve e thirri: “Shkel mbi të tjerët dhe ec përpara! Shkel mbi të tjerët!” Klubi shpërtheu në brohoritje klithëse. Njeriu që do të bëhej Hiçi i Madh thoshte:

- Mjerë ai popull që dëgjon demagogët e vegjël, shpirti i madh i këtyre kohëve të reja që jetojmë na urdhëron të shkelim mbi të tjerët e të ecim përpara!

Një natë, në shpërthim të delirit të tij të sinqertë, ai më tha:

- Unë jam një horr.

- Oh, jo gjer këtu...

Ai ngulmonte:

- E njoh mirë veten: jam një horr i vërtetë.

Para vilës ishin parkuar makina të shumta luksoze, shumica të vjedhura nëpër Europë. As policët e as bodigardët nuk të ndalonin. Dera ishte e hapur dhe unë sapo ngjita shkallët, takova të zonjën e shtëpisë. Ajo u hutua, por nuk e dha veten.

- Urdhëroni, - tha shpejt e shpejt, - duke më zgjatur miqësisht dorën. Unë ia putha e zonjës Hiçkëla i erdhi shumë mirë. Ajo më priu në paradhomën e pritjes gjithë drita qelqore të kristalta. Mbi tryezë pije nga më të ndryshmet. Zonja Hiçkëla më mbushi një gotë liker të bardhë si qumështi me një aromë tepër të këndshme. Tjetrën gotë e mbushi për vete.

- Më vjen mirë që u takuam, - tha.

Zonja Hiçkëla është një femër e ngrohtë, tërheqëse me sy të kaltër kërkues që të ndjellin e të luten: me mua bëhu i mirë... Aroma e këndshme e likerit më ngriti ca zemrën, por u kujtova që tani shpirtin s'e kisha me vete dhe sado të përpiquej zemra që të ishte e mirë, prapë unë isha një njeri i pashpirt. Për herë të parë e gjeta veten në atë gjendje.

- Jam adhuresë e poezisë suaj, - tha ajo.

Unë e falenderova.

- Im shoq, - tha zonja e shtëpisë, - nuk para lexon, kurse unë lexoj dhe e dua shumë poezinë.

I bëra asaj një kompliment banal nga ata që bëjnë poetët:

- Ju qenkeni vet një poezi, zonjë.

Nga gjoksi i ngrohtë i gruas u shkëput një e qeshur e gëzueshme, tingëlluese që mbushi ajrin. Zonja Hiçkëla u gëzua me të vërtetë. Tek po qeshte ashtu, vëreja se gjoksi i saj mbulohej nga një varëse e shtrenjë floriri. Në atë çast dëgjova zërin e burrit që pyeti:

- Çfarë ka ngjarë?

Te pragu i derës qëndronte Hiçi i Madh.

- Ah, paskeni ardhur... më në fund.

Pastaj tha:

- Eja me ne, mos rri këtu.

Ndoqa pas Hiçin e Madh. Ai shkelte me çap të ngadaltë mbi tapetet e purpurt, shtyti me dorë dy kanatet e qelqta të derës dhe ne u gjendëm në një sallë të gjerë, të ndritshme ku rreth një tryeze të rrumbullakët po loznin kumar. Hiçi i Madh shkoi drejt atje dhe zuri vendin e vet. Unë qëndrova në këmbë, u ndala në mes të sallës. Disa nga kumarxhinjtë çuan kokën, më panë e pastaj vazhduan mospërfillës lojën e tyre. Edhe Hiçi i Madh u përpi nga loja që e kishte ndërpretë kur kishte dëgjuar të qeshurën e pazakontë të së shoqes.

Aty përreth tryezës së lojës ishin edhe Faraoni i Madh, edhe Kopili i Madh. Kishte edhe të tjerë, të cilët unë nuk i njihja. Qëndroja ashtu i ngulur në mesin e asaj salle luksoze gjithë frymëmarrje e dritë Europe. Dhe përsëri unë u gjenda përpara një vrime në ajër, apo përpara një drite të zbehtë qiriri, apo përpara atij filxhani kafeje të përjetshme e të bekuar. Tashmë i vetëm, trupi im pa shpirtin, nisi po atë zakon të vjetër, të përditshëm, që të vëzhgoj e të gjykoj gjithçka nga larg, imtësisht gjithçka, duart, nofullat, lëvizjet e syve, të kap nëpër ajër zërat e tyre porozë. Mbi tryezë lëviznin sa andej-

këndeji pirgje dollarësh, nga njëri krah në tjetrin, fati ikte prej njerit e shkonte tek tjetri e përsëri qëndronte pezull në frymën e atyre njerëzve. Ishin ata që nesër sërish do të vinin në lëvizje zyrat e shtetit, mekanizmin e brejtur të qeverisjes, krijimin e ligjeve, do të popullonin përsëri parlamentin. Në Shqipëri, të gjitha këto bëhen edhe nëpërmjet shitjes së shpirttrave. Ishte zbulimi më i beftë e tronditës që kisha bërë, nga ajo dritare e vockël ajrore, e vetmuar, që i kam krijuar vetes.

Kryqëzuar krahët në kraharor po fundosesh nëpër fundet humbellë të vetvetes, pa hasur kund tokë të fortë ku të qëndroja. Një bërryl i lehtë më ciku brinjën. Ktheva kryet aty, zonja Hiçkëla po më buzëqeshte.

- Ju nuk lozni? – pyeti ajo.

- Jo, asnjëherë. Nuk e përballoj dot fatin tim ashtu. Fati im është i varfër, zonjë.

- Ah, po është zbavitëse... pse rrini në këmbë, uluni.

- Këndeji shihet gjithçka më këndshëm.

Kopili i Madh ngriti kokën e na mikloi me shikimin e tij nga tryeza e kumatit, me sa dukej fati po e ndihmonte. Edhe zonja e shtëpisë ashtu tha:

- Ai ka përherë fat.

Paspak unë dola nga solla. Te dera e vilës zonja e shtëpisë më pyeti:

- Pse s'më treguat se ç'hall ju solli sonte këtu? Përnatë dëgjoj të flitet për ju dhe e di se çfarë mendojnë ata; si mund t'ju ndihmoj?

Ahere i tregova të zonjës së shtëpisë që kisha vendosur ta shisja shpirtin tim të poetit të lirë e të marrë. Tani e tutje do të kthehesha edhe unë në një poet të urtë e të bindur, të padëmshëm nga ata që i përgjérohen popullit dhe u falen tiranëve. Por nuk më besojnë.



- Hiçi i Madh e shiti aherë shpirtin e vet për asgjë, - tha zonja, - dhe fitoi; unë e di, edhe Kopili i Madh e ka shitur vetëm për ca groshë shpirtin e tij, veç ahere dy groshë vlenin shumë, ndërsa tani ka rënë disi vlera e dollarit.

Hiçëla ndenji një copë herë e menduar, më kapi nga të dy duart e më foli ethshëm:

- Ndofta nuk je fare pa fat, pardje ka ardhur nga jashtë shtetit Putana e Madhe. Ti e di që ajo ka pasur dobësi për ty. Shko tek ajo.

Zonja u drodh e pastaj psherëtimi:

- Për mua do të ishte gëzim, por s'kam si ta bind Hiçin e Madh... Ai, as veten nuk e merr seriozisht.

M'u afrua fare pranë e duke shushuritur më tha:

- Hiçi i Madh ia ka me të pabesë edhe vetes... Shko te Putana e Madhe, do të ishte një gëzim sikur ajo ta blinte tani shpirtin tënd.

Lajmi se në Tiranë qenka kthyer përsëri Putana e Madhe më trullosoi. I dhashë dorën të zonjës së shtëpisë e humba nëpër terr.

## *Putana e Madhe*

**G**kam njohur kur ishte plot 21 vjeçe në fakultetin e Gjuhë-Letërsisë. Nuk më kujtohet se si. Vet atëherë nuk mund të kisha më tepër se 25 vjet, ndihmës asistent i gjuhës.

Shpesh nëpër korridoret e institutit kalonte para meje një vajzë e panjohur, tepër e imtë për moshën, me një trup të formuar si prej lënde hijeje, sikur nuk ekzistonte, por kur ecte i bëhej një lakini i ajthmë tundues prej vitheve gjer poshtë te kofshët e derdhura. Pikërisht kofshët e gjata i jepnin atij shtati një duf të brendshëm, që kërkonte patjetër diku të shpërthente. Çdo mashkull do të kishte dëshirë të zotëronte dhe të fundosej midis kofshëve të asaj femre, si midis dy rrjedhave të një lumi që porsa kishte shpërthyer nga dheu. E pikërisht kjo mua më shtynte e më mbante larg saj, si ndonjë rrezik kërcënues që është përherë aty dhe patjetër do të të vijë. I ikja shikimit tinzar duke mbajtur në vete atë kokë të vogël të asaj studenteje, ata sy të zesë shkrepëtitës, që si nëpër hutim zhbironin botën e meshkujve me një mençuri sunduese e qesëndisëse.

Ah, ja cilët më jeni ju meshkujt, burrat... Isha i bindur se ajo vajzë nuk ndalej atje ku qëndronin të tjerat, jo, ajo i thyente ata kufinj. Ku mendonte të arrinte ajo? Flokët e zesë të shtruar i mbante gjer poshtë supeve, por shikimi im rrëshkiste përherë atje te rrethi i zi i gushës i kopsitur me një fluturidhë të bardhë. Aty e ngulja shikimin, pa i dhënë kurrë kënaqësinë e lojës së syve të saj. Pse? As unë nuk e di, por ndoshta do ta shpjegoj më vonë.

Ishte gati në të aguar kur u ktheva në shtëpi nga vila e Hiçit të Madh. Shpirti më priste i zgjuar në shportën e vet. Isha më tepër se i rraskapitur. Shpejt e shpejt i tregova se ç'më kishte ndodhur, i përmenda edhe Putanën e Madhe.

- Paska ardhur? – pyeti ai.
- Po, paska ardhur.
- Ahere punët nuk i kemi mirë.

E kuptova se çfarë dëshironte të thoshte, shpirti im ishte mësuar gjithmonë të mendonte për fukaranë e mjerë, kështu fliste përherë në rehtorikën e tij të pavlertë: ah, fukaraja i gjorë... Një zot e di se si do ta nxjerrë edhe këtë dimër.”

- Nuk dua të mendoj më për asgjë, jam kaq i lodhur... Pastaj ç'fitova? Na, shikojë veten tënde, nuk e sheh se si po fle në atë shportë zhukash, si një kulish dreqi? Ti, shpirti plot dritë i poetit...

Ai nuk u ndje, e çfarë mund të më thoshte?

- Jo unë, këtu u mund shpresa ime dhe ajo e pranon disfatën e vet... Më kupton? As ty kurrkush nuk të blen.

- Të kuptoj, - tha i dëshpëruar vërtetë shpirti, - e kuptoj... as përfillin të ma blejnë.

Në dhomë ra një heshtje e gjatë e akulltë dhe unë fjeta një gjumë të rëndë plot ëndrra të këqija.

Më zgjoi telefoni që binte pa pushim. Ishte Gentiana. Edhe ajo e mërzhitur dhe e acaruar që s'po gjente dot kohë të takoheshim. Edhe sot e nesër jam shumë e zënë, më lajmëroi. Prita mos zinte gjë në gojë çështjen e shpirtit. Asnjë fjalë, heshtje e asgjë. E mbylla telefonin. Në shtrat po mendoja se sot duhej të shkoja të takoja Putanën e Madhe, nëse ajo do të pranonte të më takonte. Ajo femër ishte e paparashikueshme, por mua kjo nuk më trondiste, sepse tani unë isha humbësi dhe duhej të pranoja gjithçka. Ka mundësi që ajo të akullohet sapo të dëgjojë emrin tim, apo sapo ta mësojë përse jam duke shkuar atje. E dija se ajo femër kishte pasur dhe ka nëpër duar aq e aq shpirtra të tjerë poetësh, ku e ku më të mëdhenj e më të lavdishëm se unë; ç'do t'i hynte në punë ky mjerani, relike e vjetër e imja?

Veç duhej ta takoja, si dihej fatit. Ndofta atje në duart e asaj femre shpirti im nuk do të ndihej njëlloj si në duart e pashplara të Hiçit të Madh. Pashë orën, mbarova ca punëra të vockëla të mëngjesit, e mbërtheva shpirtin prej zvetku dhe u nisa.

Shkelja mbi tokë me dufin e njeriut të dëshpëruar, isha vetëm zemërin ndaj vetes. Udhëtarët që më njihnin më përshëndetnin duke përkulur pak kryet, si çdo ditë tjetër, megjithëse e shihnin që unë kisha mbërthyer në grushtin tim atë gjë të dridhshme që e thërrasim shpirt. Jo, tiranasit më përshëndesnin mua, kufomën, për shpirtin as që donin t'ia dinin. Mora një taksì, sepse Putana e Madhe e kishte ndërtuar vilën në kodrat e Tiranës, siç thoshin me dollarët që u vodhën nga firmat piramidale: të tjerë thoshin jo, i ndërtuan nga floriri i vjedhur i thesarit të shtetit. Në Tiranë ka shumë thashetheme, tmerrësisht të vërteta.

Dera e hyrjes u çel automatikisht dhe unë u gjenda në një kopsht me trëndafila të lulëzuar të tetorit, nga ata që çelin në këtë muaj në tokën tonë të bekuar. Dy bodigardë, djem të rinj, më ndoqën me bishtin e syrit pa më folur. Ngjita shkallaret e bardha dhe i rashë ziles. Dera u hap. Para meje qëndronte vetë ajo, Putana e Madhe.

- Po të prisja, - tha paksa e çelur.

Ishte zgjatur ca, ndofta dukej ashtu nga pantoflat me taka të gjata. Vetiu sytë e mi shkuan në qafën e saj të gjatë e kërkuan atë rrethin e zi që ajo mbante përherë. Nuk ishte fluturridha e bardhë, por një kopsë e vogël ari. Kishte veshur një polkë të xinxiftë, me një gajtan të zi, nga ato që punohen këtu në vend. Poshtë, në mesin e saj dallova një risk të

hollë beli lakuriq dhe kërthizën. U ndala aty. Ajo e ndjeu e priu përpara, kaluam sallonin, një koridor të ngushtë dhe hymë në odën e pritjes. U ulëm nëpër polthrona, ball njëri-tjetrit.

- Ju prisja, tha duke u përpjekur të ishte e shlrshme, mbrëmë vonë Hiçkëla më telefonoi për juve.

Kisha mbërthyer shikimin tek ajo kokrrizë e bukur e kërthizës së saj, por mendimi im i keq më yshte:

- Ja, si katandisemi ne, provincat e Europës...

Femra e ndjeu e foli fare shkarazi:

- Punë femrash, dhe me një lëvizje të lehtë të dorës më dha të kuptoja se nuk ia vlente të bisedohej për ato gjëra. Po si je? pyeti. Dhe pa pritur përgjegjen time, tha:

- Sa më merr malli për Tiranën! Nuk mund ta besosh...

Gjatë gjithë këtyre ditëve këtë kam biseduar me miqt e mi, ata mendojnë se ne jashtë shtetit bëjmë vetëm qejf, vetëm gëzohemi. Nuk mund ta kuptojnë dot dhëmbjen e mallit tonë për Shqipërinë.

E ndjeu se unë nuk po mundja të ndiqnja bisedën e saj.

- Po ç'kemi, pyeti. Si ja shpie?

Femra që kisha përpara nuk ishte studentja e dikurshme, ishte një grua e pjekur, beli, edhe pse akoma i ajthëm, kishte nisur paksa të dhjamej, kofshët edhe ato sikur kishin lëshuar diçka prej dufit tundues të njëhershëm. Gjoksi i asaj femre nuk qe më ai i brishti, imcaku, ishte ntrashur dhe kishe kapur ca hapësirë të gjerë. Veç, qëndronte ajo gushorja e zesë lidhur në atë qafë të gjatë e të bukur, si të një mjellme.

Unë e largova shikimin tim nga gushorja e gruas e duke hedhur sytë nëpër dhomë, fola me zë të ulët:

- Përse më tremb kjo qetësi?

Putana e Madhe zgjati dorën e kapi e përkëdheli shpirtin tim, që si një kulish i vockël rrëshkiti në ngrohtësinë e duarve të saja.

- Unë e di se çfarë mendon ti tani, tha ajo duke nënqeshur lehtas.

Desha ta kundërshtoj, por ajo zgjati dorën drejt meje:

- Pusho. Ti mendon se këtu jetojnë shpirta të këqinj, se këtu thurren intriga kundër teje, kundër të gjithëve, kurthe kundër lirisë... këtu ngrihen gjithë pusirat... Dhe është e vërtetë, tha ajo.

Zëri i asaj gruaje ishte i kthjellët i bindur në vete. Përherë të parë ia ngula shikimin syve të saj. Gjithmonë u kisha ikur atyre syve krenarë e qesëndisës, por të mënçëm e provokues, të asaj femre që donte të jetonte, ashtu si dëshëronte ajo. Nuk kisha pranuar, nuk isha dorëzuar në ata sy. Veç ja vjen çasti e ti dorëzohesh. Putana e Madhe e kapi, ajo shliroi trupin e vet në polthronë duke më treguar thimthin e kërthizës.

- Ah, më në fund... tha trimfuese.

Shpirti im ishte tulatur nën dorën e asaj femre. Ndihej mirë atje. Putana e Madhe ishte një nga gratë më të fuqishme, ajo ishte një mister si të gjitha gratë që kanë një pushtet të tillë. Ishte e pamëshirshme, por ishte femër dhe njihte dobësinë e shpirtit mjeran të një poeti. Unë i isha dorëzuar. Dhe unë i fola tani me zërin tim të mundur:

- T'u dorëzova... Nuk thashë: "u dorëzova...", jo, i fola asaj: "t'u dorëzova...".

Kjo e bëri të ndieshme. U çua e ngadalë e menduar shkoi nga dritarja e mbuluar me një tyl të hollë. Jashtë shkrepri dhe pikëla të mëdha shiu ranë nëpër xhama. Paspak nisi të ndihej

ecja e brerimës së shiut të Tiranës. Prej andej Putana e Madhe më foli:

- Bisedova me Faraonin e Madh dhe e binda atë. Shpirti yt edhe mund të na nevojitet ndonjëherë, po të duash mund të na i shesësh, e blej unë.

U bë një heshtje e gjatë, dëgjohej vetëm shiu i tetorit nëpër strehët e ullukët e vilës. Unë ndjeva një si gjëmim, sikur dikush më ra në kokë. Pra, vetëm ajo, pikërisht ajo, Putana e Madhe, pranoka ta blejë këtë kulish, shpirtin tim. Kur të gjithë të tjerët e shkellmuan.

- Po pse e shet tani, erdhi prej andej zëri i saj.

- Nuk mundem më, iu përgjigja. Jam tepër tepër i lodhur, më kanë braktisur të gjithë, shumë shokë më kanë zhgënjyer, jam i tradhtuar. Nuk ia vlen. Më la edhe besimi se një ditë do të fitojmë, shpresa se një ditë do t'ju mundim juve, mu fik.

Putana e Madhe më dëgjonte me fytyrë të kthyer nga unë. Po i vinte mirë që unë flisja ashtu. Erdhi e mu ulë në kolltuk tepër tepër pranë.

- Kështu ndodh përherë, tha, këtë ia shpjegova edhe Kopilit të Madh. Po ti nuk duhet të dëshpërohesh, mos u dorëzo, sepse një ditë edhe ju do të fitoni. Ndali një çast dhe më nguli ata sytë e saj të mënçëm e tinzarë: - Një ditë, tha, edhe juve duhet të fitoni...

U çova, mora shpirtin tim dhe e falënderova Putanën e Madhe. Ajo më shoqëroi në oborr nëpër shi. Tek dera, duke u ndarë unë i tash:

- Faleminderit, do mendohem e do t'ju telefonoj.

Aherë femra mu afrua pranë dhe duke murmuritur më tha:

- Dëgjo, nuk shitet shpirti në tetor.

- Si? pyeta i hutuar.

- Po ashtu, tha, nuk shitet shpirti në tetor dhe mua po më vjen mirë që ti s'po e shet atë.

\* \* \*

Në rrugë zura një taksi dhe qëndrova para sheshit ku vazhdonin tubimin, e zakonshëm zogjt e dreqit. Nëpër shi, zhelanë, të papunë, të pangrënë, të zhveshur gjer në drithërimë, më tepër të shëmtuar nga vërfëria e injoranca, të dalë si prej dheu, si nga mjegullat, kafshonin e hanin njëri tjetrin në atë mbretëri ferri. Ulurinin: “Kokë poshtë! Kokë poshtë! “Jemi këta që s’jemi! Jemi këta që s’jemi”. U afrova atje. Në tribunë nuk po fliste më ishi i tranzicionit, kishte vënë një çirakun e vet dhe ky po përsëritte fjalimin që ia kishte mësuar përmendësh. Fjalët prostitucion, drogë, kontrabandë, korrupsion, i përziente në një pekmez të trashë e të ëmbël që e gëlltünin të gjithë.

Nxorra fletoren e vogël të shënimeve e pyeta njeriun aty pranë:

- Si të quajnë?

- E kam harruar emrin, mu përgjigj.

- Nga vjen?

- As kjo nuk më kujtohet.

- Je i martuar?

- Kush e di...

- A ke fëmijë?

- Nuk mbaj mend.

- Pse je këtu?

- Pse të mos jem?

- Çfarë kërkon?



- As unë nuk e di, tha ai me një grimasë bezdie në buzë. Pastaj i shkëlqyen sytë: unë? pyeti, unë çfarë kërkoj? Asgjë... dhe gjithçka, tha pastaj ngadalë e rëndë.

U tmerrova. Ky shpirt dreqi më përsëritte mua po ato fjalë që unë vetë ia kisha thënë dikur shpirtit tim, po ato kërkesa si unë. Qenkemi të gjithë të një soji, të një gjaku me djallushët.

Në këtë çast një bodigard më zuri për krahu dhe më tërhoqi nga vetja.

- Ju kërkon shefi, tha, dhe priu përpara nëpër turmën hunguruese që shkallohej. I rashë pas tribunës dhe u gjenda para një kioske të vogël prej llamarinash. Pas derës, në këmbë më priste ministri i tranzicionit.

- Shpejt, më tha, nën-dorë merre zarfin.

- Sa? pyeta unë.

- Merre, tha ai dhe ma futi në xhep, se s'kam kohë. Dhe të mos na shohë njeri. Ajo ngordhësirë që ke nëpër duar nuk i hyn në punë askujt, lëre aty... dhe më tregoi një këndth të barakës. Tani nëm blloknotin e shënimeve.

- Ç'të duhet? pyeta fare i hutuar.

- More, po qënke vërtetë tuaf, tha ishi i tranzicionit, më jep fletorzën, sepse unë e di që aty ti ke thashethemet e vërteta të Tiranës. Përse ta blejë unë këtë? dhe ai tregoi me përçmim shpirtin tim tani të hedhur atje, te cepi i barakës. Mua më duhet kjo fletorëz e voçkël, nuk duhet botuar asgjë...

S'kisha ç'të bëja, ia dhashë ministrit fletoren, vendosa zarfin e bardhë në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe u përfala me shpirtin tim. Duke e përkëdhelur i thashë:

- Shpirt, nuk kemi s'e ç'bëjmë, na duhet të ndahemi... Më në fund, tani edhe ti ke jetën tënde, paç fat.

Ai më pa gjithë trishtim, puliti sytë e nuk foli asgjë. U largova prej andej, më në fund e kisha shitur nëndorë shpirtin tim.

\* \* \*

Asaj mbrëmje mora në telefon të vetmin mik që më ka mbetur, kritikun letrar Bukëmira. E ftova të darkonim bashkë. Zëri im ishte i lehtë e tingëllues, tanimë unë isha pa shpirt. Isha tjetërkush. Asnjëherë nuk kisha jetuar pa shpirtin tim, përherë me të, skllav të njëri-tjetrit. Ai kulish i butë pushatak më pengonte në çdo çap: “Mos... a do të dëshëronje ti që të tjerë ta bënin të keqen ty?... Si nuk ke pikë mëshire... Nuk është bukur kështu, nëna jote e gjorë do të fyej nga kjo sjellja e jote...”. Këtë të fundit ma thoshte kur unë kisha të bënja me ndonjë kurvë të vogël tiranase, nga ato të sojit nga i cili doli edhe Putana e Madhe.

Mikun tim e prita para hotelit “E vërteta është e bukur”, i hodha krahun gëzueshëm e i thashë se do të kalonim një darkë të mirë. Ai u habit, sepse unë kurrë nuk kam patur në xhep më shumë se dy kacidhe, për një kafë e një gotë konjaku. Ngjitem shkallët, kaluam sallonin dhe hymë në “Dinner room”. Në nja dy tryeza kishin zënë vend ca klientë, nga ata politikanët e rangut të dytë. Shikimet e tyre më pritën më tepër me bezdi, zakonisht kjo arradhë e burokracisë nuk i ka qejf njerëzit që i njohin. Unë e miku im i njihnim ata dhe nuk e çamë kryet fortë nga shikimet e lengëshme të tyre, shkuam andej nga këndi dhe zumë tryezën tonë.

- Porosit çfarë të dëshërosh.

Bukëmira më pa në sy gjysëmhabitshëm, nuk guxoi të më pyesë. Më tha vetëm se vëllimi im i fundit me poezi mund të

botohet së shpejti. Unë as që po i dëgjoja lajmet e mira të tij, nuk e kisha mëndjen atje. Mendoja se si nuk e kisha kuptuar që më parë, se sa mirë qenkësh të shesësh shpirtin tënd. Njeri pa shpirt, domethënë kurkush. Pikërisht aherë kritikun im lëshoi fjalët që ndofta i kishte menduar prej kohe dhe tani gjeti çastin e volitshëm që t'i thoshte:

- Më vjen mirë që edhe në këtë vëllim buis po ai shpirti yt i dliirë.

Qesha. Mu kujtua djaloshi kamarier që më kishte thënë:

- Ah, nuk kisha parë shpirt kështu ngjyrë dliirë... Mikut tim i thashë:

- Unë sot e shita edhe shpirtin tim. Prandaj po darkojmë. Dhe heshta me shikimin ngulur në sytë e tij të mëdhenj e të zinj. Ata sy nuk dhanë asnjë shenjë turbullire, veç guxuan edhe ata të më shihnin ngultas e të më pyesnin:

- Çfarë thua ashtu? Të jetë vërtetë?

- Sot, përsërita unë, e shita shpirtin tim.

Në çast ai kuptoi gjithçka. Nisi të hajë i qetë e të pijë gotën e verës. U dëgjuan fjalë që vinin nga tryezat pranë. Politikanët e rangut të dytë bisedonin për emërimet e reja të zëvendës ministrave. Sapo ishte emëruar edhe ambasadori i ri për në Romë. Emërimi i atij ambasadori ngjalli përnjëherësh bisedën e nxehtë. Dikush thoshte se Roma është e vështirë, por dikush tjetër pohonte se Roma nuk është edhe çoç e vështirë. Unë i fola kritikut një mendim që sapo më erdhi në kokë:

- Këta nuk janë gjë tjetër veçse ca bythë të gatshme për kalltuqet që u fal Putana e Madhe.

U ndamë përnjëherësh nga bisedat e politikanëve tanë të rangut të dytë, po s'kishim as ne se çfarë të bisedonim më. E

kuptova se miku im u dëshpërua shumë e mezi po kapërdinte atë që i zinte maja e pirunit në pjatë. Për ta ngushëlluar recitova vargjet e Shelit: "Where light is, chameleons change: Where love is not, poets do..." (Ku ka dritë kameleonët e ndryshojnë lëkurën, ku dashuri nuk ka, ahërë e ndryshojnë poetët...) Për ta bindur Bukëmiren, i tregova se askush nuk pranonte të ma blinte shpirtin tim dhe u detyrova që ta shesë nëndorë. Pashë se si i lëvizën nofullat dhe goja e tij mbeti e hapur.

- Nuk është e mundur, murmuriti me një zë që po vdiste.

- Të më besosh, thashë unë. Çohemi...

Duke u ngritur, që të më dëgjonin gjithë të pranishmit dhe për inat të tyre, recitova me zë të lartë vargun e shkëlqyer: "Lé mal est sans espoir, aussi j'ai du le taire..." (E keqja është e pashpresë dhe mua më duhet të hesht...). Në "dinner room" rá heshtja. Politikanët e rangut të dytë po na përcillnin me shikimet e tyre të mërzitura. Duke u kredhur në terrin e Tiranës Bukëmira më mori për krahu dhe mu rrëfye:

- Këtu është terr, askush nuk më shikon... e unë po qaj.

Nuk e kundërshtova gjë.

Në mëngjes aty nga ora dhjetë ra zilja e telefonit. Ishte Gentiana.

- Eh, more garib, a u zgjove?

- Më zgjove ti.

- Si ndihesh?

- Një farë soj.

- A do të vish tani tek unë? Jam pushim dhe akoma s'jam çuar nga shtrati.

- Më në fund, kam patur kaq nevojë për ty.

- Po të pres, tha ajo dhe e mbylli telefonin.

Gentiana jetonte në një apartament të vogël, nga ata që ndërtohen tani nëpër godinat e larta shumëkatëshe. Unë ngjita në këmbë katin e katërt e pastaj të pestin, nuk trokita. Çela derën e hyra brenda. Sapo ndjeu praninë time Gentiana bëzajti pa u çuar nga shtrati. Po më priste.

Kur hyra në dhomën e fjetjes, shtanga. Në një kutizë, nga ato të çokollatave, të bukur e të praruar, në karriken pranë kokës së saj, po tulatej vetë shpirti im. Kulishi ishte aty. Sytë e mi mbetën mbi të dhe unë nuk po i besoja më vetes.

- Po ky? pyeta me një zë që nuk ishte imi. Ku e gjete?

Gentiana zgjati dorën dhe e përkëdheli. Ai më shihte me sy gjysmë të mbyllur.

- Erdhi vetë, tha ajo

- Si erdhi vetë?

- Natën nëpër errësirë dëgjoja grithjen dhe pastaj një kujisje të thekshme, të vazhdueshme te dera. Kur e hapa, ç'të shihja? Ky, shpirti yt...

U ula tek buza e shtratit të Gentianës dhe po shihja me vëmendje shpirtin tim. Ishte apo nuk ishte ai? Ajo turriçkë e shtypur, ajo blanë e voçkël midis asaj turriçke, ata sy, ai i tëri...

- Ç'ka ngjarë, e pyeta, po ai nuk përgjigjej.

- Ti nuk di të flasësh, ke harruar të flasësh?

- Është hidhëruar me ty, tha Gentiana, ti e shite e ai tani është imi, më përket vetëm mua.

- Ah?

- Po, tha Gentiana, ky është imi tani... Unë nuk e lë më tek ty, sepse nuk të kam besim. Më takon mua, tha ajo tani vërtetë e zemëruar.

Kishte të drejtë, tërë atyre ditëve unë isha marrë me tregtimin e shpirtit tim, kisha menduar për Kopilin e Putanën e Madhe, dhe nuk isha shqetësuar fare për Gentianën.

Isha mundur. U dorëzova. Ashtu i trishtuar u çvesha e hyra në shtratin e ngrohët, pranë trupit të dëshiruar të Gentianës.

- Po ç'ka ndodhur? pyeta unë.

- Mbasi ti e kishe shitur, ata e futën shpirtin tënd në një rrjetë teli, së bashku me të tjerët. Atje kishte edhe shpirtakulishë të tjerë, të cilët nisën ta kafshonin, ta plagosnin e ta shqyenin. Nuk e donin dhe nuk e pranonin në shoqërinë e tyre, e shanin dhe e gjakosnin me dhëmbët e tyre. Më të egjër kishin qenë ata, shpirtrat e poetëve të tjerë, të shitur më përpara. "Ky, që na shiste mëndje, thoshnin ata... Ky, nderi i ndereve, dashuria e dashurive, ky hyjnor i hyjnorëve...". Mezi shpëtoi nga kthetrat e tyre. Doli nga kafazi i përgjakur e duke qarë e kujisur nëpër natë, mori udhën e erdhi tek unë. Vetëm tek unë pati besim. Kur e pashë te dera më ra zemra në tokë. E mora shpirtin tënd ndër duar, e lava me kujdes, e mjekova dhe kështu si e sheh e vendosa të qetohet.

Aherë unë iu drejtova shpirtit tim:

- Po ti, nuk kafshove ndonjë nga ata? e pyeta i zemëruar.

Ai më mbështolli me një shikim përçmues përbuzës, u mblodh si një iriq i vogël dhe nuk lëshoi asnjë zë. Ahere Gentiana më tha:

- Ti nuk ke më shpirt, tani ti je njeri pa shpirt. Ky tani është imi. Po ky, sespe nuk kafshonte dot, prandaj dhe e pësoi ashtu.

- Prandaj... murmurita unë nëpër dhëmbë.

Preka Gentianën në kraharorin e bardhë, loza me leshrat e verdhë të saj e krodha kryet nëpër ata flokë që kundërmonin erën diellore të dafinës kur çel.

- Diellorja ime... dhe e ktheva nga vetja.

Aherë ajo pëshpëriti duke më qortuar:

- Ti je i marrë, ti je i çmëndur... po nuk shitet shpirti në tetor...

Në ato çaste hyjnorë të shtratit, Gentiana po më kujtonte po ato fjalë që mi kishte thënë edhe Putana e Madhe. Sigurisht që shpirti im ia kishte treguar asaj të gjitha.

*18 Gusht 2000*

# Dy fjalë për autorin dhe botimet e tij

FATOS ARAPI lindi në qytetin e Vlorës në 1929. Po atje ai kreu shkollën e mesme, ndërsa studimet e larta i ndoqi në Bullgari (Sofje) në Fakultetin e Matematikës dhe të Ekonomisë. Ka punuar shumë vjet si nëpunës, gazetar dhe pedagog në Universitetin e Tiranës.

Disa herë ka fituar çmime kombëtare e ndërkombëtare për poezi.

## *Vepra të tjera të autorit:*

- Shtigje poetike /1962
- Poema e vjersha /1966
- Ritme të hekurta /1968
- Më jepni një emër /1972
- Drejt qindra shekujsh shkojmë /1977
- Duke dalë prej ëndrrës /1968
- Ku shkoni ju statuja /1990
- Dafina nën shi /1991
- Ne, pikëllimi i dritave / 1993
- Më vjen keq për Jagon /1994



- In-tenebris /1966
- Gloria victis /1997
- Më duket një gjysmë ëndrre / 1999
- Vëllezër hamletë / 2001

### *Përmbledhje poezish*

- Fatet / Prishtinë, 1979
- Poezi / Tiranë, 1983
- Antologji personale / 2001

### *Novela:*

- Patat e egra / 1970

### *Vepra të tjera të autorit*

- Dikush më buzëqeshte /1972
- Cipa e dëborës /1985
- Unë vdiqa brigjet të Jonit /1993
- "Gjeniu me kokë të prerë" /2000

### *Romane:*

- Dhjetori i shqetësuar / 1970
- Shokët /1997
- Deti në mes / 1986

### *Drama*

- Partizani pa emër /1962
- Qezari dhe ushtari i mirë Shvjek, në front e diku...” /1995

### *Studime*

- Këngë të moçme shqiptare /1986
- Fjalë për poezinë /1987
- Çështja shqiptare dhe kriza ballkanike / 2001

### *Përkthime*

- Këngë të popujve /1978
- Këngë për njeriun, Nikolla Vapcaov /1981
- Poezi turke të shekullit XX /1992
- Poezi, Pablo Neruda /1989

### *Vepra të tjera të autorit*

- Rrethet e ferrit – Horshe Padron /1995
- Fluturimi shpendit të kuq – Mateja Matevski / 2000
- Providenca – Ante Topovski / 2000

### *Libra me kujtime*

- Kujtohem që jam /1997
- Kush ishte Vllas Arapi /2000